



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Poliçan”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”
TË USHTRUAR NË BASHKINË POLIÇAN

Tiranë, Janar 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtime	1-3
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-10
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-6
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	7-8
II.	HYRJA	9-13
1.	Objekti i auditimit	9-9
2.	Qëllimi i auditimit	9-9
3.	Identifikimi i çështjes	9-10
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10-10
5.	Përgjegjësitë e audituesve	10-10
6.	Kriteret e vlerësimit	10-11
7.	Standardet e auditimit	11-11
8.	Metodat e auditimit	11-13
9.	Dokumentimi i auditimit	13-13
	III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14-91
10	1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	14-14
	2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
11	1. Mbi funksionimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm	14-27
12	2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	27-51
13	3. Mbi vlerësimin e raportimit financiar	51-77
14	4. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla	78-85
15	5. Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit	85-87
16	6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Territorit të Njësisë Vendore	88-90
	IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	91-101
	V. ANEKSE	102-104

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 864/1 prot., datë 10.10.2023 të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 13.10.2023 deri më datë 20.11.2023 në institucionin Bashkia Poliçan u krye në terren auditimi “Financiar dhe i Përputhshmërisë”.

Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.01.2022 deri në 31.12.2022 dhe u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, planifikimi dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit publik me vlera të larta, organizimin dhe funksionimi i planifikimit dhe zhvillimit të territorit, vlerësimi i pasqyrave financiare dhe të ardhurat. Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohej), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit).

Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 8 akt konstatime. Nga subjekti u paraqitën kundërshtitë për aktet e mbajtura. Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe Raportit Përfundimtar, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshti, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë të materialit në projekt raport dhe në raportin përfundimtar të auditimit.

Auditimi në terren ka filluar në datën 13.10.2023 dhe ka përfunduar në datën 20.11.2023. Observacionet e akt konstatimeve janë paraqitur në KLSH në datën 30.11.2023 të cilat janë bërë pjesë e Raportit Përfundimtar të auditimit.

Projekt raporti i auditimit është nisur në subjekt me shkresën nr.864/3 prot., datë 05.12.2023 dhe me shkresën nr. 2724/13 prot., datë 05.01.2024, nga ana e Bashkisë Poliçan është deklaruar njohja me Projekt Raportin e Auditimit

Në vijim nga Bashkia Poliçan me shkresën nr.2724/14 prot., datë 05.01.2024, Bashkia Poliçan ka deklaruar se nuk ka observacione mbi gjetjet në Projekt Raportin e Auditimit.

2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
<p>Nga auditimi i kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore dhe Inproduktive, në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Poliçan, për të cilat nga Bashkia Poliçan, në një rast nuk është vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore me sipërfaqe totale prej 0.033 km² (3.3 hektarë ose 33.000 m²), ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë) me afat 6-10 vjet, ku tarifa vjetore është 440,000 lekë/ha/vit në territor tokë Inproduktive.</p> <p>Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia Poliçan rezulton se subjekti N.P.R shpk, ka certifikatë për vërtetim pronësie në datën 12.02.2002, në zonën kadastrale nr.3930, numri i pasurisë 650/4, volumi 9. Faqe 58, adresa e pasurisë Zhitom i madh, lloji i pasurisë kullotë vetëm për sipërfaqen 10.000 m² (1 hektar) dhe jo për sipërfaqen totale për të cilën ka marrë lejen e shfrytëzimit. Veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr.391, datë 21.06.2006, i ndryshuar “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6/1, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Poliçan, në vlerën (440.000 lekë x 2.3 hektarë) 1,012,000 lekë.</p>	29-52	<i>E lartë</i>	Bashkia Poliçan të marrë masa për arkëtimin e shumës prej 1,012,000 lekë si rezultat i mos aplikimit të tarifave për shfrytëzim të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore për operatorin ekonomik N.R.SH, që është pajisur me leje minerare nga M.I.E.

<p>Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se gjendja e debitorëve në vlerë progresive në fund të vitit 2022 për 79 subjektet fizik/juridik është 26,835,864 lekë, për taksën e tokës bujqësore në vlerën 45,357,282 lekë dhe për taksat dhe tarifatat familjare 2,504,614 lekë, në total borxhi është në vlerën 74,697,760 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të planifikuara por të pa arkëtuara në buxhetin e Bashkisë Poliçan (ku për vitin 2022 të ardhura të planifikuara por të pa arkëtuara janë në shumën 4,289,978 lekë)</p>	29-52	<i>E lartë</i>	<p>Kryetari i Bashkisë Poliçan, Drejtorja Juridike dhe Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masat e duhura ligjore, administrative dhe gjyqësore, për arkëtimin e vlerës 74,697,760 lekë, e cila është borxh ndaj Bashkisë Poliçan, nga debitorët taksapagues privat dhe familjar.</p>
<p>Bashkia Poliçan për vitin 2022 ka zhvilluar gjithsej 3 procedura prokurimi me vlera të larta, në vlerën totale të lidhjes së kontratës prej 51,027,637 lekë. Nga auditimi këto tre procedura u konstatuan me shkelje të kuadrit ligjor në fuqi. Në dy prej tyre kriteret e veçanta të dokumenteve të tenderit nuk kanë lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, veprime në kundërshtim me nenin 39 dhe 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.</p> <p>Gjithashtu në dy procedura operatorët ekonomik janë kualifikuar dhe shpallur fitues në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vendosura në dokumentet e tenderit, veprime në kundërshtim me nenin 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” pika 3, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2023, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.</p>	79-86	<i>E lartë</i>	<p>Kryetari i Bashkisë Poliçan, të marrë masa për eliminimin e vendosjes së kriterëve të veçanta në dokumentet e tenderit, të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, si dhe shmangien e kualifikimit dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik, në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vendosura në dokumentet e tenderit.</p>
<p>Nga auditimi i HEC-eve që operojnë në Bashkinë Poliçan dhe kanë kontratë aktive me A.K.B.N rezulton se H.H.S.E, i cili operon në NJA Vertop, të Bashkisë Poliçan dhe ka kontratë koncesionare aktive me A.K.B.N, nuk ka lidhur kontratë qiraje për përdorimin e fondit pyjor dhe kulloror me bashkinë.</p>	29-52	<i>E lartë</i>	<p>Bashkia Poliçan të marrë masa për lidhjen e kontratës së qirasë për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kulloror me operatorin ekonomik H.S.E dhe të aplikojë tarifatat duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar sipas përcaktimeve ligjore.</p>

3. Konkluzioni dhe opinionin i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2022:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Poliçan, për vitin ushtrimor 2022, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare, fondet neto, investimet e aktivet afatgjata si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i modifikuar me theksim të çështjes:

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një opinion të modifikuar (kualifikuar) për llogaritë vjetore të Bashkisë Poliçan, duke arritur në përfundimin se anomali të e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të vitin 2022, të shprehura në bazën për opinion.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti i audituar në përputhje me kërkesat etike, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se: pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar. Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh. Për këto arsye kemi dhënë opinion të modifikuar me theksim të çështjes, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në gjetjet e raportit Përfundimtar të Auditimit.

Theksim të çështjeve:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë nivelin e materialitetit për shpenzimet, i cili ka vlerën 5,217 mijë lekë, si dhe faktin se disa llogari në pasqyrat financiare nuk paraqesin saktë vlerën e tyre reale, si më poshtë:

-Nga grupi i auditimit u konstatua se nuk ka analiza për llogarinë nr.202 “Studime dhe kërkime” në vlerën 2,704,895 lekë. Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, përbëhet nga vlera e garancisë së punimeve prej 5% e vlerës së kontratës për 37 objekte. Për 17 prej këtyre objekteve vlera e ngurtësuar e garancisë është 4,728,003 lekë dhe afati i garancisë sipas kontratës, edhe pse ka përfunduar në vitin 2020, nga Bashkia Poliçan nuk janë marrë masa për xhirimin e fondeve të kontraktori, apo për verifikimin e investimit nëse ka patur problematika gjatë periudhës së garancisë, me qëllim rakordimin dhe mbajtjen e vlerës që lidhet me problematikën e konstatuar.

II. Opinionin mbi përputhshmërinë:

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Poliçan janë evidentuar devijime nga kuadri

ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar.

Baza për dhënien e opinionit të përputhshmërisë:

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

-Bashkia Poliçan nuk ka ngritur një sistem efektiv të auditit të brendshëm, nuk ka të hartuar dhe të miratuar Kartën e Auditit të Brendshëm, nuk ka kryer planifikimin strategjik dhe vjetor të auditimeve.

-Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, të kenë vlerën 74,697,760 lekë.

- Tre procedura prokurimi me vlera të larta të zhvilluara gjithsej dhe të audituara, dy prej tyre u konstatuan me shkelje në hartimin e kritereve të veçanta të dokumenteve të tenderit , ndërsa dy në kualifikimin dhe shpalljen e fituesit.

-Janë konstatuar anomali në fushën e inspektimit të mbrojtjes së territorit.

1-Në 2 raste kundërvajtje për ndërtime pa leje, nuk është marrë asnjë masë tjetër në vazhdim.

2- Në Bashkinë Poliçan struktura e IMTV-së nuk ka funksionuar për vitin 2022. Kjo vjen si rezultat i mungesës së Kryeinspektorit, si rrjedhojë nga mos funksionimi i plotë i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga Bashkia Poliçan, nuk mund të vendosen gjoha apo të merren masa të tjera për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Poliçan:

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Poliçan.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kritereve të DT, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të japë opinion për këtë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 864/1 Prot, datë 10.10.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 13.10.2023 deri në datë 20.11.2023, në subjektin Bashkia Poliçan u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022.

Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1.A.P, *Përgjegjës Grupi*

2.R.F, *Anëtar*

3.F.Ç, *Anëtar*.

Titulli: Auditim financiar dhe përputhshmërie.

Marrësi: Raporti Përfundimtar i Auditimi i drejtohet subjektit të audituar Bashkia Poliçan.

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Poliçan kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)¹;

- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;

- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Poliçan është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Poliçan dhe përgjegjësisë, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që

¹Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
- Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.
- Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2021-31.12.2022.
- Mbi administrimin e aseteve të Bashkisë Poliçan.
- Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Bashkinë Poliçan.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Poliçan, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Poliçan është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Poliçan. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-^{së} nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- V.K.M nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- V.K.M Nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023".
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Rregullore mbi organizimin e funksionimin e Bashkisë Poliçan, etj.
- Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Poliçan grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Poliçan me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale².

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c)

² ISSAI 1315

funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{ja} aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

³ *Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit*

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin - Bashkia Poliçan

Poliçani kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë Berat, në lindje me Bashkinë Skrapar, ndërsa në jug dhe jug-lindje me Bashkinë Memaliaj. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Poliçanit. Sipas Censurit të vitit 2011 Bashkia Poliçan numëron 10,953 banorë, ndërsa sipas Regjistrit të Gjendjes Civile ajo numëron një popullsi prej 18,341 banorësh. Bashkia ka një sipërfaqe prej 272.02 km² me një densitet prej 67.42 banorë/km². Kjo bashki përbëhet nga 3 njësi administrative të cilat kanë në total 26 fshatra. Bashkia e Poliçanit përbëhet nga Njësia Administrative Poliçan, qyteza ish-industriale e Poliçanit dhe dy njësitë administrative Vërtop dhe Terpan. Nga këto, Njësia Terpan, shtrihet në një terren të thyer malor. Qyteti i Poliçanit ka qenë një qendër e rëndësishme e industrisë ushtarake dhe e industrisë së materialeve të ndërtimit për shkak të burimeve të mëdha të gurit. Industria e nxjerrjes së gurit dekorativ është në ditët e sotme një resurs i konsiderueshëm ekonomik për zonën. Poliçani ka në territorin e tij një pjesë të konsiderueshme të parkut kombëtar të Tomorit. Për rrjedhojë, turizmi malor është një element i rëndësishëm i bashkisë. Të ardhurat në zonat rurale vijnë kryesisht nga kultivimi i ullirit dhe rrushit, por edhe drurëve të tjerë frutorë si gështenjat, arrat dhe fiqtë.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

Pika nr.1. Auditim mbi Funksonimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm

1.1 Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së:

Titulli i gjetjes 1: Mangësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm sipas komponentëve u konstatuan parregullsitë si më poshtë:

a. Në lidhje me komponentin “Mjedisi i kontrollit”:

- Nuk janë hartuar programe trajnimi për ruajtjen dhe ngritjen e nivelit profesional të punonjësve, si dhe njohuritë e tyre në lidhje me kuadrin rregullator ligjor mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin rezultojnë të jenë jo në nivelin e duhur.

- Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar procedura e rekrutimit të tyre.

- Njësia publike nuk ka të përcaktuar në dokumentin e strategjisë një plan konkret për monitorimin dhe arritjen e objektivave.

- Nuk ka përshkrime detyrash individuale e cila do të evidentonte ngarkesën konkrete me punë si dhe kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit.

b. Në lidhje me komponentin “Menaxhimi i riskut”:

- Bashkia Poliçan ka hartuar rregjistër rrisht, por ky rregjistër nuk është përditësuar për të evidentuar rrishtet aktuale që rrëzikojnë realizimin e objektivave të njesisë vendore, si dhe nuk janë përcaktuar persona, apo struktura përgjegjëse për monitorimin e rrishteve me qëllim minimizimin e tyre.

d. Në lidhje me komponentin “Monitorimi”:

-Nuk ka një plan të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, pika 2.2.4, nënpikat 1-5, dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010.

Ndikimi: Mos njohja sa duhet e koncepteve të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Shkaku: Mungesa e trajnimeve të dedikuara për të gjithë stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit financiar.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Poliçan të marrë masa për evidentimin e nevojave të stafit për trajnim, si dhe hartimin e planit vjetor për trajnimin e punonjësve, me qëllim ngritjen e nivelit profesionale të tyre.

Rekomandim: Në rregulloren e brendshme të veprimtarisë së njësisë vendore, të bëhet përshkrimi i detyrave për secilin pozicion pune, sipas strukturës së miratuar nga titullari i institucionit.

Rekomandim: Të merren masa për hartimin e rregjistrimit të ri të riskut, në të cilin të evidentohen të gjitha risqet aktuale që rrëzikojnë realizimin e objektivave, si dhe strukturat përkatëse për monitorimin e riskut.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A.Z me detyrë Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. S.Gj me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Ky auditim u krye në zbatim të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve;

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Poliçan si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK-së nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e MFK-së kuptohen dhe funksionojnë jo mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë pavarësisht përpjekjeve të këtij institucioni për të shkuar drejt konsolidimit.

Konkluzioni në lidhje me vlerësimin e komponentëve të MFK-së në mënyrë të detajuar argumentohet si më poshtë vijim:

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është bazë e menaxhimit të fondeve dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm i cili përmban:

✓ **Njësia publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlera etike.**

-Nëpunësit e Bashkisë Poliçan duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në zbatim të nenit 3, të rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit e institucionit miratuar me Vendimin nr. 8, nr. 141 prot., datë 20.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë është miratuar Kodi i Etikës i cili aplikohet dhe zbatohet nga administrata qendrore dhe njësitë administrative.

-Në nenin 27 të rregullores së brendshme janë përcaktuar veprimet që parandalohen, të gjitha detyrimet dhe normat e sjelljes, ndërsa për ndëshkimin e rasteve konkrete ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në rregulloren e brendshme dhe legjislacionin për Shërbimin Civil dhe Kodin e Punës. Nga bashkia raportohet se nuk ka pasur raste të shkeljes së etikës.

-Për sa i përket programeve të trajnimit dhe përmirësimit të anës profesionale, punonjësit kanë mangësi në njohuritë e tyre në lidhje me kuadrin rregullator ligjor mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, veprime këto në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III, pika 3.1.

-Në lidhje me ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura pranë Bashkisë ato depozitohen në zyrën e mardhënieve me publikun, e cila i adreson tek kryetari i bashkisë dhe përgjigja kthehet nga zyra përkatëse, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”. Kjo procedurë është e përfshirë në nenin 20 të Rregullores së brendshme.

-Referuar Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë”, vlerësimi i punonjësve kryhet në periudha 6 mujore, me këtë procedurë merren burimet njerëzore.

✓ **Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.**

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të saj.

-Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës, drejtuar Titullarit (NA) dhe raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit për KB, analizës së veprimtarisë të Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme përcaktuar mënyra e hartimit, miratimi, ndjekja e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkrjetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë.

- Për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale e protokoll.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Nga ana e bashkisë Poliçan deklarohet se bëhen raportime mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësive publike.

-Nuk specifikohet konkretisht mënyra se si bëhen këto raportime dhe kujt i drejtohen, veprime këto që bien ndesh me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010.Nga njësitet e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Ndërsa nga UK Sh.a Poliçan, bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen këshillit drejtues dhe raporte gjashtëmujore për performancën financiare pasi bashkia është aksioneri kryesor.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm ose i jashtëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë.

✓ **Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.**

-Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Poliçan me Vendimin e Kryetarit nr. 8, datë 20.01.2022.

-Është hartuar dhe miratuar me Vendim Nr.12 dhe Nr.797/1 prot., datë 24.03.2022, *deklarata e misionit* dhe dokumenti i PBA, këto janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimeve të menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

-Referuar të dhënave të paraqitura nga pyetësi, në hartimin e planit strategjik është lëshuar Urdhri i brendshëm Nr.67, datë 09.03.2022 “Për ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Strategjive Buxhetore dhe Integrimin” dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve.

-Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike.

-Njësia publike nuk ka të përcaktuar në dokumentin e strategjisë një plan konkret për monitorimin dhe arritjen e objektivave.

-Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative dhe niveli i pagave në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë, me VKB nr.46 dhe nr.47, datë 24.12.2021.

-Organigrama e Bashkisë Poliçan është e ndërtuar në mënyrë të tillë që, 1 nënkryetar dhe 4 drejtuesit e Drejtorive kryesore bashkë me Administratorët e NJA e Titullarët institucioneve të varësisë varen direkt nga Kryetari, ku dhe llogaridhënia është direkt tek Kryetari i Bashkisë në vijë horizontale. Nga niveli më i ulët specialist, përgjegjës sektori, llogaridhënia është në vijë vertikale.

-Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë së saj. Për çdo drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialisti.

-Nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

-Bashkia Poliçan ka faqen e saj zyrtare në Web në të cilën janë paraqitur të gjitha informacionet e njësisë vendore si dhe dokumentat e rëndësishme.

✓ **Parimi 4. Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.**

-Nëpunësit e Bashkisë Poliçan i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist, me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, dhe aktet nëligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit (inspektor terreni, punonjës bujqësie, topograf, inxhinier pyjesh, inspektor pyje, kullota, punonjës sporti etj..) i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Referuar Kreut II, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, ku përcaktohet:

- Një procedurë transparente për rekrutim;
- Krite dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit;
- Një sistem trajnimi dhe kualifikimi;
- Një sistem për vlerësimin e performancës;

-Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjës të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Punë nuk është përcaktuar plani i rekrutimit të tyre. Nga informacioni i marë nga grupi i auditimit pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore rezultoi se; rekrutimi i punonjësve është kryer në përputhje me ligjin e Shërbimit Civil. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila përmban të dhënat mbi krijimin e marrëdhënies së punës, arsimimin, kualifikimin, masa disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve në punë. Dokumente përkatës që vërtetojnë gjëndjen familjare, diploma e shkollës së lartë, lista e notave, çertifikata për kualifikime të ndryshme, dëshmi e gjuhëve të huaja, etj.

-Nuk ka përshkrime detyrash individuale e cila do të evidentonte ngarkesën konkrete me punë si dhe kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit. Programi vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit bëhet në bashkëpunim me ASPA (shkolla e administratës publike).

-Për bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.

✓ **Parimi 5. Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.**

Çdo titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, si dhe luan një rol kyç për integritetin të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për

performancën e njësisë publike. GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë.

-**Për vitin 2022** për hartimin e PBA 2021-2023 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.67 datë 09.03.2022 “Për ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Strategjive Buxhetore dhe Integrimin”, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pika b, neni 27, pika 2.

-Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Nga ana e Bashkisë Poliçan ekzistojnë rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, veprime këto në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II.

2. Menaxhimi i riskut

✓ Parimi 6. Njësia publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësisë dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij. Analizimin dhe rifreskimin e kontrolleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut. Koordinator i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinator i Riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësisë së tij, nëpunësi autorizues mund të delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinimin e riskut, punonjësve që janë pjesë e strukturës së financës, funksion i cili i është deleguar z.S.Gj drejtor finance.

Menaxhimi i riskut mundëson vendim marrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura. Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë dhe më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të silllet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

-Bashkia Poliçan nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku por ka nevojë për përmirsim. Nuk janë përcaktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin dhe implementimin e kësaj strategjie, veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 21, pika 2, si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II, pika 2.5.2, “Menaxhimi i riskut”.

3. Aktivitet e kontrollit

Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, përfshirë edhe shitjen e pronës, urdhër-shërbimet, dhe kryerja e pagesës, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesa. Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për regjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit. Sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare. Të gjithat angazhimet likuidimet financiare nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Përveç kësaj, gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurmëve të auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Sipas Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, parashikohet se: Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës. Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duhet të përfshijë hapat kryesorë të vlerësuar të rëndësishme për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit: Përgatitja e Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës.

-Për vitin 2022 Bashkia Poliçan ka hartuar, miratuar, arkivuar Gjurmët e Auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale

dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimit, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Që ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet.

Titullarët e njësive kanë përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi.

Procedurat antikorrupsion, përfshijnë:

- Kontrollat parandaluese.
- Një sistem për investigim të brendshëm të paralajmërimeve të hershme për korrupsion, mashtrime dhe parregullsi.
- Një sistem për zbulimin e mashtrimeve dhe parregullsive.
- Një sistem për raportimin e parregullsive të gjetura, që duhet të përshkruajë qartësisht linjën e brendshme dhe të jashtme të raportimit, pa rënë ndesh me të drejtën kushtetuese të individit.
- Procedurat e sinjalizimit.

-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 20.

4. Monitorimi

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura. Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës. Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të brendshëm. Procedura nëpërmjet vetëvlerësimit, një përdorues i buxhetit ka nevojë për të përcaktuar nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me rregullat dhe procedurat që sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit bëhet duke plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit. Çdo nëpunës autorizues për çdo vit duhet të përgatisë një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai do të deklarojë se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës. Në deklaratë, Nëpunësi Autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar. Qëllimi i kësaj deklaratë është për të rritur

llogaridhënien e menaxhimit dhe për të inkurajuar përpjekjet për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm. Raporti vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm. Çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi të nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

Me shkresën nr. 595 prot., datë 28.02.2022, nga Bashkia Poliçan është hartuar dhe dërguar në ministri deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 18, pika 1, dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, pika 15.

Me shkresë nr. 595/1 prot., datë 28.02.2022, Bashkia Poliçan ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësorin e vetëvlerësimit, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon menaxhimi financiar dhe kontrolli, në përputhje me Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 Kapitulli V, Shtojca 2 “Pyetësori i vetë vlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

Gjithashtu konstatohet se, nuk ka raportime të menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakt dhe produkti. ,

-Bashkia Poliçan nga auditimi deklaroi se ka një udhëzim të brendshëm për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, por nuk ka specifikime se kur ka dal ky udhëzim dhe si kryhet monitorimi i MFK.

-Nuk ka një plan të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III.

5. Informimi dhe komunikimi

Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
- Një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.
- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësive që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.
- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Menaxhimit duhet t'i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet. Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përmbushjes së objektivave si në nivel aktiviteti ashtu edhe objektivave të përgjithshme të mbarë njësisë publike. Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin.

Në Bashkinë Poliçan shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

1.2 Auditi i Brendshëm

Titulli i gjetjes 2: Mangësi në organizimin e njësisë së auditit të brendshëm.

Situata: Nga auditimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm u konstatua se kjo strukturë nuk është e plotësuar me numrin e plotë, pasi ka një punonjës, nga tre që kërkon kuadri ligjor në fuqi.

Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si dhe fusha të tjera me risk të lartë në veprimtarinë e institucionit, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike, nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

Nuk është hartuar karta e auditimit të brendshëm dhe plani strategjik. Nuk është hartuar dhe dërguar në NJQHAB të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raporti periodik vjetor i shoqëruar me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM Nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 3, “Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Në strukturën e njësive të auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik”.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015 datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Ndikimi: Mungesë efikasiteti në kryerjen e detyrave të auditit të brendshëm.

Shkaku: Mungesa e një strukture të mirëfilltë të auditit të brendshëm.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Poliçan të merren masa për plotësimin e strukturës së auditit të brendshëm me tre auditues.

NJAB të planifikojë dhe realizojë auditime në fushat kryesore dhe me risk të veprimtarisë së institucionit, si ngritja dhe funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, menaxhimi, inventarizimi dhe rregjistrimi i aseteve, procedurat e prokurimit publik etj.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z.A.Z kryetar i bashkisë.

Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm publik, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet, planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimi, ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi.

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Karta e Auditimit të Njesisë AB të Bashkisë Poliçan.
2. Plani Strategjik i vitit 2022 dhe pasqyrat shoqëruese.
3. Planifikimi vjetor për vitin 2022 dhe pasqyrat shoqëruese.
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitet 2022 dhe pasqyrat shoqëruese.
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara.
6. Dosjet koherente të subjekteve të audituara.
7. Projektraport dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësive publike.
8. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Organizimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm

Në bazë të Vendimit të KM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, nuk është krijuar njësia e auditimit të brendshëm.

Për **vitin 2022** NJAB ka funksionuar me 1 auditues sipas strukturës organizative të konfirmuar nga Titullari i Bashkisë, mbi bazën e miratimit me VKB nr.46 datë 24.12.2021.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, pika 3 “Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik”.

Nga auditimi konstatohet se:

1. NJAB në Bashkinë Poliçan, duke mos qenë një strukturë e mirfilltë nuk ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 12, pika c, neni 14 pika b.
2. Për vitin 2022 nuk është hartuar dhe miratuar plani strategjik, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 12, neni 14.
3. Për veprimtarinë e NJAB në Bashkinë Poliçan për periudhën objekt auditimi, nuk është raportuar në mënyrë sistematike. Nuk është hartuar dhe dërguar në NJQHAB te Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raporti periodik vjetor i shoqëruar me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB në kundërshtim me 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 14 pika d.

4. Struktura e projekt-raporteve dhe e raporteve përfundimtare të auditimit për vitin 2022 nuk është përfunduar ende, *aktualisht të dy auditimet e kryera gjatë këtij viti janë në fazë projekt-raporti, (auditimi i Drejtorisë së Tatim Taksave dhe sektori i Prokurimeve).*

5. Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të Bashkisë Poliçan janë mbajtur të plotësuara e të administruara në përputhje me kërkesat e Kapitullit VI të Manualit të Auditimit të Brendshëm, në to është përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme, por në shumicën e tyre mungon Plani i Veprimit të subjekteve të audituara.

6. Nga auditimi i dokumentacionit të rekrutimit të punonjësve të Njesisë së Auditit të Brendshëm Bashkia Poliçan konstatohet se ka në strukturën e saj vetëm një audites, më konkretisht sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Periudha 2022	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime vijueshme te
1	L.M	Auditues	Ekonomi Finance	40	15	2015	Deri në periudhën e ezaurimit të kontratës

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes të punonjësit të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se ky punonjës është kontraktuar referuar nenit 10, pika ç e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015,” Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” si më poshtë cituar:

ç) kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm me kontraktim, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Punonjësi i strukturës së auditit të brendshëm rezulton i çertifikuar dhe ka kryer trajnime të vijueshme për kualifikimin profesional, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015” Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, “Punësimi i Auditit të Brendshëm” neni 19 “Çertifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20 “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm” deri në periudhën e daljes në pension (viti 2016).

Vlerësimi mbi veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Poliçan

Sipas planit Strategjik të viti 2022 i nënshtrohen auditimit të plotë, drejtoria e Tatim Taksave, Prokurimet, të cilat janë miratuar nga Përgjegjësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm mbi bazën e planit vjetor.

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë, emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për vitin 2022 sipas planifikimit vjetor, janë planifikuar për tu kryer 2 auditime nga të cilat janë realizuar 2 auditime në masën 100% konkretisht është audituar: **1. Drejtoria e Tatim-Taksave dhe 2. Sektori i Prokurimit Publik.** Në mënyrë analitike paraqiten si mëposhtë:

Pasqyra e realizimit të auditimeve të brendshme për vitin 2022

Të dhëna sipas raportimit		
Auditime të	Auditime	Nga të realizuarat, sipas llojit

Nr	Periudha	planifikuar	të realizuar					
				Përputh.	Financë	Kombinuar	Performancë	Tjera
1	2022	2	2	1		1		

Gjetje-Rekomandimet

Një aspekt mjaft i rëndësishëm i aktivitetit auditues është dhënia e rekomandimeve në përfundim të auditimeve, ku:

Për vitin 2022 Nga auditimet janë evidentuar 7 gjetje, për të cilat janë dhënë 7 rekomandime të cilat janë rekomandime të karakterit organizativ dhe për të cilat është përcaktuar niveli i rëndësisë, është adresuar përgjegjësia dhe është vendosur afati i zbatimit.

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Periudha	Të Dhëna Sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura në numër				Rekomandime te shprehura në vlerë			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	Viti 2022	7	3	4					
TOTALI		7	3	4					

Të dhënat e gjetjeve sipas fushave të auditimit dhe subjekteve të auditimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	SUBJEKTI AUDITUAR	Gjetjet Sipas Fushës Ose Sistemeve Në Numër									
		Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komision	Fondet e sig. Shoq, sig. shendetesore, përkujdesje shoqërore	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit pronës, pasurisë	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve, ankandeve	Sistemet e legalizimeve, Urbanistikës, kthim pronash	Sistemet e kreditimit, subvencioneve	Të tjera
1	Bashkia e Poliçan, Auditim në Drejtorinë e Tatim Taksave				6						1 jashtëm
2	Bashkia e Poliçan, Auditim për Prokurimet Publike	1									1 jashtëm

Ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve të manualit të Auditit të Brendshëm. Rekomandimet sipas llojit dhe statusit të realizimit në subjektet e audituara, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2022	Statusi i Rekomandimeve				Rekomandimet Sipas Llojit				
			Rekomandim dhënë	Rekomandim pranuar	Rekomandim zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të përmirësimit	Rekomandime të përmirësimit	Rekomandime të karakterit ligjor	Rekomandime për arkëtime	Rekomandime të tjera
1	Bashkia e Poliqan, Auditim në Drejtorinë e Ardhurave dhe Tatim Taksave	6		6							
2	Bashkia e Poliqan, Auditim për Prokurimet Publike	1		1							

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se nga 7 masa të rekomanduara, janë pranuar 7 (shtatë) rekomandime, nga këto 3(tre) rekomandime janë zbatuar, 4(katër) rekomandime janë në proces zbatimi, ndërsa rekomandime të pa zbatuara nuk ka.

Zbatimi i planeve të Auditimit të Brendshëm. Hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit të auditimit

Për veprimtarinë e Sektorit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2022, është raportuar në mënyrë sistematike Kryetarit të Bashkisë Poliqan. Për veprimtarinë e vitit 2022 nuk janë dërguar evidencat e realizimit të auditimeve, subjekti pretendon se nuk është kërkuar nga ministria e financave për subjektet që nuk kanë njësi auditimi të brendshëm.

Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm

Vlerësojmë se; sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, (Kapitulli VI, “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”), në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve, dhe përmbajnë në mënyrë të qartë fushën e auditimit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet që do të ndiqen, dhe grupin e auditimit. Në përgjithësi referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z.S.Gj me detyrë Drejtor Finance, z.A.Z kryetar i bashkisë.

Pika nr.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022;

Nga ana e Bashkisë Poliqan janë ndjekur dhe zbatuar hapat e mëposhtëm:

- Është nxjerrë urdhër nr. 98, datë 12.03.2021 për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve për hartimin e PBA-së për periudhën 2022-2024;
- Me shkresën nr. 173 Prot, datë 25.01.2022 është depozituar pranë Degës së Thesarit Skrapar rregjistri i parashkimeve publike të vitit 2022;

- Me shkresën nr. 63 Prot, datë 12.01.2022 është dërguar në MFE PBA për periudhën 2022-2024;
- Me VKB nr. 44 datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe të PBA-së 2022-2024”.
- Me shkresën nr. 907/2 Prot, datë 10.01.2022 është konfirmuar nga ana e Prefektit të Qarkut Berat VKB nr. 44 datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe të PBA-së 2022-2024;

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të hartimit të PBA-së për periudhën 2022-2024, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Poliçan nuk janë ndjekur të gjithë hapat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 33,34,35,36,37, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 12, si dhe udhëzimet e MFE për të hartuar PBA-të përkatësisht:

- Kryetari i Bashkisë nuk ka përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33;
- Për hartimin e PBA-së nuk janë përgatitur kërkesat buxhetore referuar nevojave dhe objektivave të Bashkisë Poliçan. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk disponon asnjë dokumentacion lidhur me dëgjesat publike për konsultimin e buxheteve afatmesme me komunitetin dhe grupet e interesit;

Titulli i Gjetjes 3: *Probleme në lidhje me procedurat e diskutimit, planifikimit, miratimit dhe afatet që duhen ndjekur për Projekt Buxhetin Afatmesëm të vitit 2022-2024.*

Situata: Për hartimin e PBA-së për periudhën 2022-2024, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Poliçan nuk janë ndjekur të gjithë hapat e duhura ligjore.

Kryetari i Bashkisë nuk ka përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor.

Për hartimin e PBA-së nuk janë përgatitur kërkesat buxhetore referuar nevojave dhe objektivave të Bashkisë Poliçan. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk disponon asnjë dokumentacion lidhur me dëgjesat publike për konsultimin e buxheteve afatmesme me komunitetin dhe grupet e interesit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33;

Kriteri: Ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 33, 34, 35, 36, 37, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/015, datë 15.10.2015, neni 12, si dhe udhëzimet e MFE nr. 23, datë 22.11.2016, nr. 22, datë 30.07.2018, nr. 7, datë 27.02.2019 dhe nr. 27 datë 10.07.2020; për të hartuar PBA-në 2022-2024.

Ndikimi: Mangësi e menaxhimit për të projektuar, miratuar, realizuar dhe analizuar buxhetet e institucionit që drejton, shkakton mosfunksionim e duhur të njësisë vendore.

Shkaku: Analizat e punës për planifikimin e buxhetit, komunikimin me institucionet përkatëse për realizimin e PBA për 2022-2024 nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë viteve të audituara.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për të dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, të publikohet brenda afatit ligjor PBA-ja si dhe të përgatiten kërkesat buxhetore referuar nevojave dhe objektivave të Bashkisë Poliçan.

Për sa trajtuar më sipër ngarkohen me përgjegjësi, z. A.Z me detyrë Kryetar i Bashkisë Poliçan dhe z. S.Gj me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

Për vitin 2022 në Bashkinë Poliçan buxheti është hartuar kryesisht mbi bazën e 10 programeve, përkatësisht: Aparati, Shërbime të Përgjithshme, Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri, Bujqësia dhe pyjet, Transporti, Shërbimet kulturore, Arsimi bazë, Arsimi i mesëm, Familje dhe fëmijë.

Buxheti i vitit 2022, është miratuar me VKB nr. 44, datë 24.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat, me shkresën nr. 907/2, datë 10.01.2022.

Nga auditimi u konstatua se, buxheti i vitit 2022 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar. Planit të buxhetit i vitit 2022 krahasuar me PBA për periudhën 2022-2024 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.1 Plani i buxhetit i vitit 2022 krahasuar me PBA për periudhën 2022-2024 (000/lekë)

Nr.	Emërtimi	Plani i Buxhetit 2022	Plani vitit 2022 në PBA	Diferenca
1	Shpenzime personeli (600,601)	133,387	120,320	13,067
2	Shpenzime korrente (602,604,606,609)	62,955	61,034	1,921
3	Shpenzimeinvestimi(230/231)	31,900	54,025	- 22,125
	Totali	228,242	235,379	- 7,137

Burimi: Bashkia Poliçan

Për vitin 2022 buxheti është planifikuar në vlerën 228,242 mijë lekë nga të ardhurat vendore, nga të ardhurat e trashëguara nga granditë e pakushtëzuar dhe nga granditë e kushtëzuar. Shpenzimet janë planifikuar të balancuara me të ardhurat. Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2022 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.2 Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2022 (000/lekë)

	Planifikimi i të Ardhurave-2022		Planifikimi i Shpenzimeve-2022
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/lekë
Të ardhura të planifikuara te vitit	60,398	Art.600Paga	124,828
Total të ardhurat e veta te trashëguara	17,737	Art.601Sigurime shoqër dhe shënd.	20,747
Transferte e pakushtëzuar e çelur për llogaritë vitit 2022	124,189	Art.602Shpenzime operative	74,362
Transferte specifike e çelur për llogari të vitit 2022	67,491	Art.604Transferime korrente të brend.	6,637
Transferte specifike e çelur për llogari të viti të përkatës		Art.606Transferime te buxhetit familjar dhe individë	93,847
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit të shtetit	307,179	Art.230-231 Investime	248,897
		Fondi Rezervë+Kontigjencës (609)	7,496
TOTALI TË ARDHURAVE	576,994	TOTALI SHPENZIMEVE	576,994

Burimi: Bashkia Poliçan

Ndryshimet në buxhet për vitin 2022 janë kryer rast pas rasti me kërkesë drejtuar Degës së Thesarit Skrapar bashkëlidhur së cilës disponohen VKB-të përkatëse si dhe shkresat e konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Berat. Plani fillestar i buxhetit të vitit 2022 me ndryshimet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3 Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2022 (000) lekë

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2022				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë, miratuar me VKB	Vleranë 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë miratuar me VKB	Vlerat e buxhetit fillestar +buxheti shtesë (në000/lekë)
	1	2	1+2		3	4	3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022	59,550	848	60,398	Art.600 Paga	115,623	9,205	124,828
Të ardhura te veta trash.. nga viti më parshëm		4,599	4,599	Art.601 Sigurime shoqërore shëndetësore	20,094	653	20,747
Total të ardhurat veta	59,550	5,447	64,997	Art.602 Shpenzime operative	56,421	17,041	73,462
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar		7,345	7,345	Art.604Transferime korrente të brendshme	600	2,386	2,986
Të ardhura të trashëguara nga transferta spec.		5,793	5,793	Art.606Transferime te b. familjar dhe individë nd ek paaftës.,etj.		93,848	93,848
Transferta pakushtëzuar për llogari 2022	102,099	22,090	124,189	Fondi Rezervë+Kontigjencës mb.Civil609	5,934	5,662	11,596
Transferta specifike llogari të 2022	66,893	598	67,491	Art.230-231 Investime	32,200	216,697	248 897
Transferta të tjera	4,583	302,596	307,179				
Total ardhurat nga transfert buxhet shtetit	173,575	338,422	511,997				
TOTALI TË ARDHURAVE	233,125	343,869	576 994	TOTAL SHPENZIMEVE	233,125	343,869	576,994

Burimi: Bashkia Polican

Konkluzion: Nga auditimi i ndryshimeve të bëra në buxhet rezulton se:

-Ndryshimet nuk janë shoqëruar me relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit;
-Nuk ka një analizë se si ndikon ky ndryshim në realizimin e objektivave të synuar të bashkisë;
-Kryetari i Bashkisë Poliçan për vitin 2022 nuk ka paraqitur brenda datës 31 mars të vitit pasardhës raport me shkrim pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë.
Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 444, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c, "...Si rregull ndryshimet duhet të jenë minimale. Ndryshimet duhet të jenë të papranueshme në tremujorin e parë të vitit pasi kjo periudhë është shumë afër kohës së parashikimit fillestar".

Titulli i Gjetjes 4: *Probleme në lidhje me procedurat e diskutimit, planifikimit, miratimit, publikimit dhe analizës së buxheteve.*

Situata: Nga auditimi rezulton se në buxhetin e vitit 2022:

-Ndryshimet nuk janë shoqëruar me relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit;
-Kryetari i Bashkisë Poliçan për vitin 2022 nuk ka paraqitur brenda datës 31 mars të vitit pasardhës raport me shkrim pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47⁴, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44⁵, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c, "...Si rregull ndryshimet duhet të jenë minimale. Ndryshimet duhet të jenë të papranueshme në tremujorin e parë të vitit pasi kjo periudhë është shumë afër kohës së parashikimit fillestar".

Ndikimi: Mangësi e menaxhimit për të projektuar, miratuar, realizuar dhe analizuar buxhetet e institucionit që drejton, shkakton mosfunksionim e duhur të njësisë vendore. Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre, më së shumti për shkak të mosrealizimit të të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Shkaku: Analizat e punës për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetet paraardhëse nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë viteve të audituara.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Poliçan të ndjek hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real dhe objektiv duke paraqitur brenda afateve ligjore raport me shkrim pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare.

⁴ Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse për ndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin e vitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor.

⁵ Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

Për sa trajtuar më sipër ngarkohen me përgjegjësi, z. A.Z me detyrë Kryetar i Bashkisë Poliçan dhe z. S.Gj me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

2.3. Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyri në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2022

Për vitin 2022 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **576,364** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **540,556** mijë lekë, ose në masën **94%**. Zëri që ka vlerën më të ulët të realizimit është zëri fond emergjence dhe mbrojtje civile në masën 33%. Realizimi i buxhetit sipas zërave paraqitet në mënyrë më të detajuar në tabelën në vijim. Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2022 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.4 Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2022

(000) lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Poliçan, për vitin 2022, në mijë lekë						
Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve	Plani2022	Fakti2022	Realizimi në %	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta	Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti
	Bashkia pa njësitë vartëse					
1	Art. 600 Paga	124,828	119,192	96	117,192	2,000
2	Art.601 Sig.shoqërore & shënd	20,747	20,513	99	20,183	330
3	Artikulli-602 Shpenzime operative	73,462	63,445	86	63,064	381
4	Art. 604+606 Transf.korrente të brend.	6,637	5,343	81	5,343	
5	Art.606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë(PAK)	93,848	91,768	98	-	91,768
6	Art.606 Fondi emergj+Mbr.Civile	7,945	2,635	33	139	2,496
7	Art.231 Investime	248,897	237,661	96	31,499	206,161
	TOTAL viti 2022	576,994	540,556	94	237,420	303,136

Burimi: Bashkia Poliçan

Bashkia Poliçan me shkresën nr. 63, datë 12.01.2022 për çeljen e buxhetit të vitit 2022 miratuar me VKB nr. 44, datë 24.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat, me shkresën nr. 907/2, datë 10.01.2022.

Nga Bashkia ndarja e planit të buxhetit dhe detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së pakushtëzuar sektoriale, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar dhe rialokimeve të kryera nga vetë bashkia, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Treguesit e buxhetit për vitin 2022, janë miratuar me VKB, brenda afateve ligjore dhe buxheti është planifikuar në shumën 576,364 mijë lekë prej të cilit janë realizuar 540,556 mijë lekë ose i shprehur në përqindje plani është realizuar në masën 94%. Shpenzimet për investime janë realizuar në shumën 237,661 mijë lekë ose në masën 96% të buxhetit faktik.

Nga Drejtoria e Financës është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktura nga grandet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore.

Hartimi i raporteve të monitorimit.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44⁶ dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48⁷, Bashkia Poliçan ka përgatitur raportet periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit si vijon:

- Raporti i monitorimit për 4-mujorin e parë të vitit 2022, dërguar në MFE me shkresën nr. 1303 Prot, datë 19.05.2022;
- Raporti i monitorimit për 8 mujorin e vitit 2022, dërguar në MFE me shkresën nr. 2322 Prot, datë 20.09.2022.
- Raporti i monitorimit për 12 mujorin e vitit 2022, dërguar në MFE me shkresën nr. 457 Prot, datë 10.02.2023.

Konkluzion: Bashkia Poliçan për vitin 2022 ka hartuar dhe dërguar në MFE, raportet e monitorimit brenda afateve ligjore. Kryetari i Bashkisë Poliçan në asnjë rast nuk i ka paraqitur në këshill raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë Poliçan nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale, që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe Shtojcës 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore”. Raportet e monitorimit nuk janë të plota, pasi nuk janë plotësuar të gjitha anekset sipas kërkesave të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, Aneksi nr. 3 “Raporti i realizimit të produkteve të

⁶ Neni 44 –Raporti vjetor “Kryetari njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës”.

⁷ Neni 48 – Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor “Nëpunësit autorizues të njësisë të vetëqeverisjes vendore i paraqesin këshillit përkatës, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katër mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit... Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit publikohen nga nëpunësi autorizues në faqen zyrtare të njësisë përkatëse, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit, dhe një kopje e tyre i dërgohet Ministrisë së Financave...”

programit”, Aneksi nr. 4 “Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit”. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, pika 10,12,28,29,48.

Titulli i gjetjes 5: *Mos zbatim i plotë i kuadrit ligjor për raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit.*

Situata: Kryetari i Bashkisë Poliçan në asnjë rast nuk i ka paraqitur në këshill raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë Poliçan nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale, që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar sipas shtojcës 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe Shtojcës 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”. Raportet e monitorimit nuk janë të plota, pasi nuk janë plotësuar të gjitha anekset sipas kërkesave të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, Aneksi nr. 3 “Raporti i realizimit të produkteve të programit”, Aneksi nr. 4 “Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit”.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, Shtojca 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe Shtojca 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 48 dhe Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, pika 10, 12, 28, 29, 48.

Ndikimi: Zbatimi jo i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2022.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor për monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan të paraqesë në këshillin bashkiak për njohje dhe miratim, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit.

2.4.&2.5. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

Në dokumentin e PBA-së 2022-2024 nga ana e Bashkisë Poliçan rezulton të jetë plotësuar formati F. 12 "Detyrimet e Prapambetura" si dhe plani i amortizimit të detyrimeve të prapambetura në instrumentet e planifikimit financiar, në të cilin janë pasqyruar stoku i borxhit më 31.12.2022 për PBA-në, si dhe plani i amortizimit të detyrimeve gjatë viteve për të cilat është hartuar PBA.

Nga kryqëzimi i të dhënave të PBA-së që mbulon vitin 2022 me listën e detyrimeve të prapambetura konfirmuar nga Dega e Thesarit Skrapar rezultojnë mospërputhje në shumën e stokut. Më konkretisht:

-Në PBA 2022-2024 Formati (C2) është parashikuar që stoku i borxhit të jetë 42,970,000 lekë, ndërkohë që sipas listës së detyrimeve paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit shuma e stokut në datë 31.12.2022 është 94,217,974 lekë *pra stoku real në fund të vitit 2022 është 51,247,974 lekë më shumë se shuma e planifikuar për këtë vit në PBA.*

Bashkia Poliçan ka raportuar periodikisht në MFE mbi ecurinë e detyrimeve të prapambetura. Për vitin 2022, raportimet janë bërë me shkresën nr. 28 Prot, datë 20.07.2022.

Detyrimet reale të prapambetura të Bashkisë Poliçan referuar listave analitike që administron Drejtoria e Financës dhe Buxhetit më datë **31.12.2022 janë në vlerën totale 94,217,974 lekë**, ku peshën kryesore e zënë detyrimet për investime në vlerën 75,452,358 lekë, detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 7,082,391 lekë, detyrimet për shpronësime në vlerën 6,775,052 lekë.

Informacion më i detajuar rreth detyrimeve të prapambetura për vitin 2022 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.5 Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2022

Në lekë

Tipologjia	Nr.	Emërtimi	Nr.Faturë/Nr. VGJ	Vlera
Vendime gjyqësore	1	M.G	V.Gjyqi nr.364,dt.12.4.2011GJ.Apelit Vlore	951,800
Vendime gjyqësore	2	L.Q	V.Gjyqi nr.941,dt.25.06.2008 GJ.e Shk. P.Berat	204,610
Vendime gjyqësore	3	Q.M	V.Gjyqi nr.941dt.25.06.2011GJ.Apelit Vlore	941,715
Vendime gjyqësore	4	V.A	V.Gjyqi nr.805 dt.13.07.2015GJ.Sh.P. Tirane	343,750
Vendime gjyqësore	5	A.K	V.Gjyqi nr.104 ,dt.05.02.2016 GJ.e Shk. P.Berat	210,507
Vendime gjyqësore	6	G.M	V.Gjyqi nr. 1497 ,dt.22.11.2018 GJ.e Shk. P.Vlore	2,400,902
Vendime gjyqësore	7	H.E	V.Gjyqi nr.318,dt.04.04.2019 GJ.e Shk. P.Vlore	323,620
Vendime gjyqësore	8	P.C	V.Gjyq. nr 3213 ,dt.14.05.2021 ,GJ.e Shk. P.Vlore	1,705,487
O	9	O	Shpenzime per nergjine elektrike	1,298,980
Dety. per sherbime	10	C.C	Sherb. i pastr. gjjelb. Dek Fat. 31(seri 57003638) dt. 31.03.2020	298,929
Dety. per sherbime	11	C.C	Sherb. i pastr. gjjelb. Dek Fat. . 3/2021 , date 01.03.2021	298,931
Dety. per sherbime	12	Sh.A.Ujesjellesi Poliçan	Fatura nr. 7385543 (seri 202074583) ,dt. 30.09.2016	280,089
Dety. per sherbime	13	Sh.A.Ujesjellesi Poliçan	Uji I pijshem Fat. 82,82/1(seri 61807369,70 dt. 31.08 2019	292,998
Dety. per sherbime	14	At	Gjoba e penalitete (fat. 91104471 (seri 227122434 , dt. 31.12.2020	218,246
Investime	15	T.shpk	"Krijimi i qendres Fshati Mbrakull " Fat. 31 (seri 51343881, dt.01.08.2019	13,418,720
Investime	16	T.shpk	"Rikons. Rruga Unaza e Plirezes) ,Fat. 45 (seri 51343846), dt. 11/10/2018	6,130,964
Investime	17	2.a	Invenstimi "Rivit. i 3 lagjeve.." " Fat. 16 (seri 79419016),dt. 31.8.2020	2,263,521
Investime	18	G.C	Investimi" Ndert. Rrjet ujesjelles Poliçan-Pronovik-Mbrakull Fat. 28(seri 83820028)dt. 28.12.2020	47,039,153
Investime	19	N.S	Investimi" Ndert. Rrjet ujesjelles Poliçan-Pronovik-Mbrakull Fat. 16/2021 date 13.04.2021 shpk	6,600,000
Investime	20	S.K	(shpronesim) VKM nr. 596 , date 18.10.2017	749,738
Shpronesime	21	M.Y	(shpronesim) VKM nr. 596 , date 18.10.2017	1,035,367
Shpronesime	22	K.M	(shpronesim) VKM nr. 596 , date 18.10.2017	927,125
Shpronesime	23	H.E	(shpronesim) VKM nr. 596 , date 18.10.2017	323,620
Shpronesime	24	L.S	(shpronesim) VKM nr. 596 , date 18.10.2017	347,048
Shpronesime	25	D.Xj	(shpronesim) VKM nr. 596 , date 18.10.2017	744,950
Shpronesime	26	H.K	(shpronesim) VKM nr. 596 , date 18.10.2017	728,327
Shpronesime	27	Xh.Z	(shpronesim) VKM nr. 596 , date 18.10.2017	70,070
Shpronesime	28	S.K	(shpronesim) VKM nr. 596 , date 18.10.2017	193,430
Shpronesime	29	N.B	(shpronesim) VKM nr. 596 , date 18.10.2017	390,760
Shpronesime	30	K.M	(shpronesim) VKM nr. 484 , date 17.06.2020	1,264,617
Qera ambjentesh	31	K.S	Shpenzime per qira Janar 2006 deri Dhjetor 2019	240,000

Qera ambjentesh	32	K.S	Shpenzime per qira Janar 2006 deri Dhjetor 2019	1,980,000
		Totali		94,217,974

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga auditimi konstatohen pasaktësi në të dhënat e paraqitura në PBA mbi detyrimet e prapambetura. Nga kryqëzimi i të dhënave të PBA-së që mbulon periudhën 2022 me listën e detyrimeve të prapambetura konfirmuar nga Dega e Thesarit Skrapar rezultojnë mospërputhje në shumën e stokut referuar Formatit C2. Më datë 31.12.2022 stoku real është 51,247,974 lekë më shumë se shumën e planifikuar për këtë vit në PBA.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e:

- Ligjit nr.68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, ku përcaktohet se: "Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet përshqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të tëardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore...", neni 40, pika 3, "Projekt buxheti vjetor përfshin...informacion mbi gjendjen/stokun e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore...detyrimet kontingjente dhe mundësinë e shfaqjes së tyre si detyrime në vitin buxhetor pasardhës".

- Udhëzimin e MFE nr.09 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" pika 106, ku përcaktohet se: "Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim", pika 186.

- Udhëzimin plotësues të MFE nr. 1, datë 10.01.2022 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022", pika 126, 127.

Detyrimet nga vendimet gjyqësore

Duke analizuar të dhënat e paraqitura në tabelën si vijon rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore më datë 31.12.2022 është në vlerën 7,082,391 lekë. Për periudhën nën auditim janë krijuar detyrime në vlerën 174,699 lekë, ndërsa janë likuiduar vendime gjyqësore në vlerën 1,764,747 lekë. Krijimi dhe likuidimi i detyrimeve nga vendimet gjyqësore në Bashkinë Poliçan për vitin 2022 paraqitet e detajuar në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.6. Krijimi dhe likuidimi i detyrimeve nga vendimet gjyqësore në Bashkinë Poliçan për vitin 2022 në lekë

Artikull	Debi	DEBI shitesa	KRED Ipakes	Gjendje 31.12.2022	Objekti
	31.12.2021	1.1.22-31.12.22	1.1.22-31.12.22		
4864100	9,048		9,048	0	V.Gj nr.349,dt.24.12.2004 Gj.e Shk. P.Berat (K. G.)
4864100	1,431,800		480,000	951,800	V.Gj nr.364,dt.12.4.2011GJ.Apelit Vlore(M. G.)
4864100	304,610		100,000	204,610	V.Gj nr.941,dt.25.06.2008 Gj.e Shk. P.Berat (L. Q.)
4864100	1,541,715		600,000	941,715	V.Gj nr.941 dt.25.06.2011GJ.Apelit Vlore(Q.M.)
4864100	-			0	V.Gj nr.200,dt.18.02.2010GJ.e Shk. P.Berat (I.B.)
4864100	343,750			343,750	V.Gj nr.805 dt.13.07.2015GJ.Sh.P. TR (V.Albania sh.a.)
4864100	450,507		240,000	210,507	V.Gj nr.104 ,dt.05.02.2016 Gj.e Shk. P.Berat (A.K.)
4864100	2,400,902			2,400,902	V.Gj nr. 1497 ,dt.22.11.2018 Gj.e Shk. P.Vlore (G. F.)
4864100	323,620			323,620	V.Gj nr.318,dt.04.04.2019 Gj.e Shk. P.Vlore (H. E.)
4864100	161,000	26,400	187,400	0	V.Gj nr.486 ,dt.06.4.2016 Gj.e Shk. P.Vlore (K. L.)

4864100	-	148,299	148,299	0	V.Gj. nr 5596 ,dt.09.11.2021 „GJ.e Shk. P.Vlore (Autoriteti Kombetar I Ushqimit)
4864100	1,705,487			1,705,487	V.Gj. nr 3213 ,dt.14.05.2021 „GJ.e Shk. P.Vlore (P. Communitacion) sha))
Totali	8,672,439	174,699	1,764,747	7,082,391	Shp.Periudh te ardhsh.per detyrime te prapamb.V.GJ

Burimi: Bashkia Poliçan

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me likuidimin e vendimeve gjyqësore nga Bashkia Poliçan konstatohet se në fund të vitit 2021 vlera detyrimeve është 8,672,439 lekë për 12 Vendime gjyqësore, gjatë vitit është likujduar vlera prej 1,764,747 lekë, jane shtuar detyrime në vlerën 174,699 lekë dhe në fund të vitit 2022 ka mbetur pa u likujduar vlerë prej 7,082,391 lekë. Gjithashtu, vihet re se nga Kryetari i Bashkisë nuk është miratuar një grafik, që Bashkia duhet të ndjekë në likuidimin e detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, pika 5 “*Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësive shpenzuese, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar*” dhe pika 8 “*Vendimet gjyqësore të Njësive të Qeverisjes Vendore të paraqitura zyrtarisht tek këto njësi, ndjekin të njëjtën procedurë, të përshkruar në këtë Udhëzim*”.

Titulli i gjetjes 6: *Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, pasaktësi në të dhënat e paraqitura në raportimet në MFE dhe dokumentet analitike të Bashkisë Poliçan.*

Situata: Nga auditimi konstatohen pasaktësi në të dhënat e paraqitura në PBA mbi detyrimet e prapambetura. Nga kryqëzimi i të dhënave të PBA-së që mbulon periudhën 2022 me listën e detyrimeve të prapambetura konfirmuar nga Dega e Thesarit Skrapar rezultojnë mospërputhje në shumën e stokut referuar Formatit C2. Në PBA 2022-2024 Formatit (C2) është parashikuar që stoku i borxhit të jetë 42,970,000 lekë, ndërkohë që sipas listës së detyrimeve paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit shuma e stokut në datë 31.12.2022 është 94,217,974 lekë pra stoku real në fund të vitit 2022 është 51,247,974 lekë më shumë se shuma e planifikuar për këtë vit në PBA.

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me likuidimin e vendimeve gjyqësore nga Bashkia Poliçan konstatohet se në fund të vitit 2021 vlera detyrimeve është 8,672,439 lekë për 12 Vendime gjyqësore, gjatë vitit është likujduar vlera prej 1,764,747 lekë, jane shtuar detyrime në vlerën 174,699 lekë dhe në fund të vitit 2022 ka mbetur pa u likujduar vlerë prej 7,082,391 lekë. Gjithashtu, nga shqyrtimi i kohës së likuidimit të vendimeve gjyqësore vihet re se Drejtoria e financës dhe Buxhetit në Bashkinë Poliçan në likuidimin e detyrimeve nuk respekton radhën e paraqitjes së tyre në njësive shpenzuese, si dhe nuk ka të miratuar nga Kryetari i Bashkisë një grafik, që duhet të ndjekë në likuidimin e detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore

Kriteri: Ligji nr.68/2017“Për financat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, neni 40, pika 3, Udhëzimi i MFE nr.09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimi plotësues i MFE nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, pika 126, 127, Udhëzimi i MFE nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, pika 5 dhe pika 8, neni 12, pika (gj), të ligjit 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Ndikimi: Mos shlyerja në kohë të detyrimeve ndaj të tretëve krijon risk për pagesa penalitetesh të panevojshme dhe pasaktësi në vlera dhe mangësi në raportime të detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Moszbatim i kërkesave ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, vlera jo të besueshme në raportimet në MFE për detyrimet e prapambetura.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtorja e Financës dhe Buxhetit gjatë hartimit të PBA-së të plotësojë saktë të dhënat lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, të kryejë verifikimin, regjistrimin dhe përputhjen e vlerës së saktë të detyrimeve të prapambetura që ka Bashkia Poliçan sikurse paraqiten në bilanc dhe raportohen në MFE si dhe të hartojë planin e likuidimit të tyre mbi vlerën reale të detyrimeve të prapambetura.

Për sa trajtuar më sipër ngarkohen me përgjegjësi, z. A.Z me detyrë Kryetar i Bashkisë Poliçan dhe z. S.Gj me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

Vështirësia financiare

Bashkia Poliçan sipas bilancit në pasqyrat financiare në mbyllje të vitit 2021 ka detyrime të prapambetura në vlerën 94.2 milion lekë të cilat përbëjnë rreth 16.6% të shpenzimeve totale të miratuara, pra më shumë se 15% të tyre, duke dëshmuar për një situatë në probleme financiare. Ndërsa në raport me shpenzimet faktike të vitit 2022, detyrimet e prapambetura janë në masën 16.8%. Nga viti i kaluar ku niveli i detyrimeve të prapambetura paraqitej në nivelin mbi 25% të shpenzimeve vjetore të miratuara, situata paraqet një përmirësim. Llogaritja e vështirësisë financiare paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.6. Vështirësia financiare

	Detyrime të Prapambetura	Totali i Shpenzimeve të Planifikuara 2021	% e Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve të Planifikuara	Totali i Shpenzimeve Faktike 2021	% e Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike
Bashkia Poliçan	94,217,974	565,364,000 total	16.6%	559,800,000	16.8%

Burimi: Bashkia Poliçan

Mbi zbatimin e afateve dhe procedurave të aprovimit të faturave nga njësia shpenzuese dhe dërgimit në thesar brenda 60 ditëve nga data e marrjes së faturës nga furnitori.

Referuar UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për minitorimin dhe publikimin periodic të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, në paragrafi II të këtij udhëimi thuhet: Stok i detyrimeve të prapambetura për efekt të këtij udhëzimi konsiderohen detyrimet financiare të transaksioneve të shpenzimeve të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme (përfshirë edhe njësitë ekstra buxhetore në varësi të qeverisjes qendrore dhe vendore), të cilat rezultojnë të pa paguara prej mbi 60 ditëve kalendarike, që nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik (lindjes së detyrimit financiar), si dhe ato pas afatit të pagesës të përcaktuar në marrëveshjen apo legjislacionin përkatës (paga, kontribute shoqërore e shëndetësore, tatim mbi të ardhurat personale, rimbursim TVSH, vendime gjyqësore, etj. ***Nga auditimi u konstatuan 105 fatura në total me vlerë 124,557,804 lekë të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 60 ditor, detajuar në aneksin nr 1.***

Konkluzion: Nga sa trajtuar më sipër, KLSH-ja konstaton se për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa mbi afatin **60 ditor** të faturave për shpenzime/shërbime/investime të mbërritura në institucion në **105** raste në vlerën **124,557 mijë** lekë. Ky fenomen vjen nga mosrealizim i të

ardhurave nga taksat e tarifave vendore, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52.

Titulli i gjetjes 7: Shkelje e afatit 60 ditor të regjistrimit të faturave në SIFQ.

Situata: Nga auditimi u konstatuan 105 fatura në total me vlerë 124,557 mijë lekë të dorëzuara në thesar jashtë afatit 60 ditor, veprim në kundërshtim me UMFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme.

Kriteri: UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

Ndikimi/efekti: Rritja e stokut të detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Regjistrim me vonesë i faturave.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Poliçan të rregjistrojë faturat brenda afateve ligjore të përcaktuara me qëllim evidentimin real të detyrimeve për shpenzime/shërbime/investime ndaj palëve të treta.

Për sa trajtuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. S.Gj me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Menaxhimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Poliçan, kryhet nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, ku për vitin 2022 është miratuar struktura nga Kryetari i Bashkisë me 5 punonjës, nga të cilët 1 (një) Drejtor, 2 (dy) specialist dhe 2 (dy) teknik i mesëm .

Më hollësisht trajtuar te pasqyra si më poshtë:

Tabela nr 7. Struktura e Drejtorisë së Tatim Taksave

Nr	Emri Mbiemri	Funksioni Sipas Strukturës	Lloji i shkollës	Larte ose i mesëm	Urdhri i emërimit Nr, datë	Urdhri largimit Nr, datë	Pozicioni i punës
a	b	1	2	3	4	5	6
1.	A.C	Drejtoresh e Taksave dhe Tarifave Vendore	Administrim Biznesi	I lartë	Nr.197,date 26.10.2015	-	D/T.T-V
2.	K.K	Spç.i tatimeve dhe licensimit të detyrimeve fiskale në NJ.A.Vërtoq	Turizëm	I lartë	Nr.112,date 06.08.2015	-	Spç.i T.L.D.F
3.	S.Q	Spç. e tatimit detyrimeve fiskale dhe mbledhjes së taksës së tokës në A.NJ.Terpan	Administrim Biznesi	I lartë	Nr.30,date 26.02.2021	-	Spç.T.D.F
4.	C.B	Teknik i mesëm i tatim-taksave në B.P	M.Pergjithshme	Mesëm	Nr.110,date 05.08.2015	-	Tek.M.T.T
5.	F.K	Teknik i mesëm i tatim-taksave	A.mesëm	Mesëm	Nr.45,date 28.04.2022	-	Tek.M.T.T

Burimi: Bashkia Poliçan

Për vitin 2022, paketa fiskale është miratuar me VKB-në nr.45, datë 24.12.2021 “Për miratimin e paketës fiskale viti 2022 të Bashkisë Poliçan”.

Të dhëna mbi numrin e subjekteve që kanë ushtruar aktivitet ndaj të cilëve janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

Tabela nr 8. Gjendja e bizneseve për vitin 2022

Nr	Lloji i Biznesit	Gjendja ne fillim	Regjistrime te Reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja ne fund
1	Biznesi i Vogël	160	6	5	161
2	Biznesi i Madh	37	1	0	38
3	Gjithsej	197	7	5	199

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga të dhënat e tabelës konstatohet se:

Për vitin 2022, kanë ushtruar aktivitet 197 subjekte (160 subjekte të biznesit të vogël, 37 subjekte të biznesit të madh) kanë kryer regjistrim si aktivitete të reja 7 biznese, dhe kanë bërë cregjistrim 5 subjekte.

Përsa më sipër konstatohet se:

- Kjo situatë sipas Bashkisë Poliçan tregon nivelin e ulët ekonomik të kësaj Bashkie, por sipas mendimit të Grupit të KLSH-së është edhe puna e pamjafuteshme e strukturave të Sektorit të Tatim Taksave.

- Nuk janë mbajtur regjistra manual për bizneset që ushtrojnë aktivitet tregëtar etj, për të rritur sigurinë e informacionit që disponojnë, nisur nga fakti se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon program kompiuterik të licensuar dhe të mbrojtur, veprim që bie në kundërshtim me pikën 7, neni 4 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku thuhet se;

“Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar”.

- Nga auditimi rezulton se nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashki, nuk janë administruar në dosjet e bizneseve që janë subjekt i Tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, deklarata tatimore vjetore mbi xhiron e parashikuar vjetore, veprim që bie në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

- Nga Zyra e Taksave Vendore nuk është marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, mbi xhiron e subjekteve, ku mbi bazën e këtyre të dhënave aplikohet dhe taksat vendore sipas llojeve të biznesit (fizik/juridik), pasi referuar VKB tarifatat kanë nivele të ndryshme, veprim në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, kjo për të mundësuar evidentimin e subjekteve që kalojnë nga subjekte me status fizik në subjekte me status juridik, për të cilat taksat e tarifatat vendore kanë vlera të ndryshëm.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi znj. A.C me detyrë Drejtor i Tatim Taksave dhe Tarifave Vendore.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2022

Tabela 9. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitim 2022
(në mijë lekë)

Nr	Lloji I Taksës	Viti 2021			Viti 2022		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
a	B	1	2	3	7	8	9
I	Te ardhura nga Tatimet	0	176		-	92	
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	0	176		-	92	
II	Te ardhura nga Taksat	44,629	14,513	33%	37,905	19,039	50%
1	Taksa e Pasurisë, ndërtesë	15,520	4,078	26%	15,733	4,693	30%
2	Taksë mbi truallin	0	0		-	-	
3	Taksë Vendore B.Vogël	0	0		-	-	
4	Taksë Regj.Automjete	200	239	120%	200	75	38%
5	Taksa e ndikimit në Infrastrukturë	1,000	1,130	113%	1,200	2,584	215%
6	Taksë Hoteli	0	0		-	-	
7	Taksë Tabelë dhe Reklame	115	101	88%	114	108	95%
8	Taksë Kontrolli Veterinar	0	0		-	-	
9	Taksë Tap	1,500	3,044	203%	1,500	3,408	227%
10	Renta Minerare	0	4		-	5	
11	Taksa mbi tokën bujqësore	26,292	5,917	23%	19,158	8,166	43%
III	Te ardhura nga Tarifatat	14,440	15,037	104%	15,505	17,707	114%
1	Tarifë Pastrimi	9,350	9,557	102%	10,779	10,930	101%
	Tarifë ndriçimi	615	504	82%	620	579	93%
2	Tarifë gjelberimi	615	502	82%	620	509	82%
3	Tarifë zënje hap.publike	350	290	83%	350	308	88%
4	Tarifë tregu	0	0		-	-	
5	Tarifë parkim automjete	249	214	86%	249	190	76%
6	Tarifë regjistrim biznesi	90	16	18%	75	23	31%
7	Tarifë për leje	84	219	261%	99	543	548%
8	Tarifër shërb. Administr.	75	76	101%	75	109	145%
9	Tarifë kullote+pyjore	0	0		-	-	
10	Tarifë dru zjarri	300	317	106%	400	260	65%
11	Tarifë ujitje kullim	400	500	125%	400	295	74%
12	Tarifë nga çerdhe	250	173	69%	250	284	114%
	Trifë nga MNZ	10	5	50%	10	56	560%
	Tarifë therje	474	6	1%	-	-	
	Të tjera lokale	50	43	86%	50	51	102%
	Tarifë shfrit karburantesh	0	1,000		-	1,200	
13	Hece		0		-	-	
14	Qëra Antene	405	405	100%	405	1,124	278%
15	Toka me qëra	378	465	123%	378	501	133%
16	Fond pyjor me qëra	745	745	100%	745	745	100%
17	Prodhime pyjore		0		-	-	
18	Tarifë shërbimi për mjete	0	0		-	-	
19	Tarifë e përkohshme turizmi	0	0		-	-	
20	Tarifë për linja	0	0		-	-	
21	Taksë prone private kullota	0	0		-	-	
IV	Te ardhura jo tatimore	5,988	5,708	95%	6,140	6,376	104%
	Gjoha nga shkelja e afateve të detyri	1,900	0	0%	1,940	25	1%
	Të ardhura nga dhënia me qëra ase	0	0		-	-	
	Detyrime te pa mbledhura	0	0		-	-	
	Biblotekë, muze	0	0		-	-	

	Të ardhura kultura	0	0		-	-	
	Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura	3,500	4,820	138%	4,000	4,403	110%
	Të ardhura nga donator UNDP	588	888	151%	200	709	355%
	Shitje banese	0	0		-	1,010	
	Zhdemtime	0	0		-	229	
	GJITHSEJ (I+II+III+IV)	65,055	35,434	54%	59,550	43,214	73%

Burimi: Bashkia Poliçan

Bashkia Poliçan sipas VKB si më sipër ka miratuar treguesit e planit të të ardhurave, për vitin 2022.

Në mënyrë të përmbledhur planifikimi dhe realizmi i të ardhurave për taksat dhe tarifatat vendore paraqiten në pasqyrën e më poshtme:

Tabela 10. Planifikimi dhe realizmi i të ardhurave, për vitin 2022 në mijë lekë

Nr	Përshkrimi	Plan 2022	Fakt 2022	%
1	Të ardhura nga taksat	37,905	19,039	50%
2	Të ardhura nga tarifatat	15,505	17,707	114%
3	Të ardhura të tjera	4,200	6,351	151%
4	Të ardhura nga gjobat	1,940	25	1%
5	Tatim i thjeshtuar/fitimin	-	92	
6	Të ardhura kombëtare			
7	Shuma	59,550	43,214	73%

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga analiza e të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin **2022**, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore nga **59,550 mijë** lekë të parashikuara, janë realizuar në shumën **43,214 mijë** lekë ose **73 %** e planit, me një diferencë në vlerën **16,336 mijë** lekë të ardhura të pa realizuara. Nga të cilat të ardhurat nga taksat janë realizuar në vlerën 19,039 mijë lekë, ose 50% të planifikimit, të ardhurat nga gjobat janë realizuar në vlerën 25 mijë lekë, ose vetëm 1% të planifikimit, ndërsa të ardhurat nga tarifatat dhe të ardhurat e tjera janë tejkaluar, përkatësisht 114% dhe 151% nga planifikimi.

Situatë e cila tregon një nivel të ulët dhe punën e pamjaftueshme të kësaj administrate në planifikimin e të ardhurave dhe më kryesorja në arkëtimin e tyre, ku si rezultat i mos arkëtimeve bën që një pjesë e investimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2022 të prokurohen pa fonde në dispozicion, duke rritur në fund të periudhave ushtrimore gjëndjen e faturave të palikujdurara dhe borxhin.

Përsa më sipër konstatohet se:

-*Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin*, për vitin 2022 nuk kemi planifikim. Nga të dhënat konstatohet se nuk ka akt-rakordim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Poliçan për nr. e subjekteve që duhet të paguajnë dhe të ardhurat që ato kanë realizuar brenda një viti ushtrimore.

Gjithashtu dhe në fazën e planifikimit nuk është marrë në konsideratë numri i subjekteve të cilët gjatë vitit ushtrimor mbyllen ose regjistrohen, dhe bazën e të dhënave për subjektet të cilët në bazë të aktivitetit dhe xhiros vjetore do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

-Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos marrë në konsideratë numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen ose regjistrohen, dhe bazën të dhënave për subjektet të cilët në bazë të xhiros do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, etj.

-Për vitin 2022 vlerën më të lartë të mos realizimit të të ardhurave vendore e zenë të ardhura nga Taksat Vendore në shumën 19,039 mijë lekë.

- Të ardhura nga taksat kombëtare për vitin 2022 nuk është planifikuar, kjo tregon për mos njohje të burimeve dhe resurseve që ka Bashkia Poliçan, si dhe mos njohja e kuadrit ligjor që rregullon përfitimin e njësisve vendore nga këto taksa.

-Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike, por nuk ka një databazë të saktë për numrin e mjeteve në përdorim që gjenden në territorin e Bashkisë Poliçan.

- Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për arkëtimin e taksave të popullatës është mjaftuar vetëm duke detyruar familjet që marrin shërbim (vërtetime etj) në Bashkinë Poliçan të paguajnë tarifën familjare, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak. *Nga auditimi rezulton se nuk është kryer rakordim me zyrat e gjendjes civile nga ana e Sekretit të tatim taksave vendore për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Poliçan.*

-Taksa mbi tokën bujqësore, për vitin nuk është realizuar, ku për vitin 2022 realizimi paraqitet në masën 43% ose nga 19,158 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera prej 8,166 mijë lekë. Niveli i arkëtimeve nga viti 2021 në vitin 2022 ka një rritje prej 2,249 mijë lekë.

Titulli i gjetjes 8 : Gjendja e subjekteve për taksat dhe tarifave vendore.

Situata: Nga auditimi rezulton se Bashkia Poliçan, nuk ka hartuar regjistër manual për taksapaguesit e kategorisë privat dhe familjar, për të rritur sigurinë e informacionit që disponojnë, nisur nga fakti se Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon program kompjuterik të licensuar dhe të mbrojtur, veprim që bie në kundërshtim me pikën 7, neni 4 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

- Nga Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashki, nuk janë administruar në dosjet e bizneseve që janë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, deklarata tatimore vjetore mbi xhiron e parashikuar vjetore, veprim që bie në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”

- Nga Zyra e Taksave Vendore nuk është marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, mbi xhiron e subjekteve, ku mbi bazën e këtyre të dhënave aplikohet dhe taksat vendore sipas llojeve të biznesit (fizik/juridik), pasi referuar VKB tarifave kanë nivele të ndryshme, veprim në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, kjo për të mundësuar evidentimin e subjekteve që kalojnë nga subjekte me status fizik në subjekte me status juridik, për të cilat taksat e tarifave vendore kanë vlera të ndryshme.

Rezultoni se për vitin 2022, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga 59,550 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në shumën 43,214 mijë lekë ose 73 % e planit, me një diferencë në vlerën 16,336 mijë lekë të ardhura të pa realizuara, nga të cilat të ardhurat nga taksat janë realizuar në vlerën 19,039 mijë lekë, ose 50% të planifikimit, të ardhurat nga gjobat janë realizuar në vlerën 25 mijë lekë, ose vetëm 1% të planifikimit, ndërsa të ardhurat nga tarifave dhe të ardhurat e tjera janë tejkaluar, përkatësisht 114% dhe 151% nga planifikimi.

Kjo situatë tregon punën e pamjaftueshme të kësaj administrate në planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave, e si pasojë mosarkëtimi bën që një pjesë e investimeve të parashikuara në buxhetin

e vitit 2022 të prokurohen pa fonde në dispozicion, duke rritur në fund të periudhave ushtrimore gjendjen e faturave të palikujduara dhe borxhin.

- Të ardhura nga taksat kombëtare për vitin 2022 nuk është planifikuar. Konkretisht Bashkia Poliçan nuk ka planifikuar arkëtim për taksat kombëtare si vijon.

Kjo tregon për mos njohje të burimeve dhe resurseve që ka Bashkia Poliçan, si dhe mos njohja e kuadrit ligjor që rregullon përfitimin e njësive vendore nga këto taksa.

Kriteri: Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 7, neni 16.

Ndikimi: Mungesa e kontrollit të territorit nga strukturat e zyrës së tatim taksave për evidentimin e subjekteve aktive dhe të ardhurat që realizojnë.

Shkaku: Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi, dhe mos veprim i zyrës së taksave

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa për hartimin e regjistrimit manual për taksapaguesit privat dhe familjar, me të gjithë elementët e tij të nevojshëm.

Rekomandim: Të merren masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, me qëllim që të mos ketë diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të tyre, duke u mbështetur në numrin e taksapaguesve, në realizimin faktik të viteve të fundit, si dhe në bashkëpunimin me Drejtorinë Rajonale Tatimore .

Rekomandim: Të merren masa për planifikimin e të ardhurave nga taksat kombëtare, duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse të cilat mbledhin këtë taksë dhe ndajnë një pjesë të të saj me pushtetin vendor.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi znj. A.C me detyrë Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore

Nga të dhënat e nxjerra nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Poliçan në lidhje me sipërfaqen e tokës gjithsej të ndarë sipas ligjit, paraqitet si vijon:

Tabela nr 11. Sipërfaqe e tokës Bashkia Poliçan

Nr	Bashkia Poliçan dhe NJA	Tokë bujqësore gjithsej	Nga e cila				Familjet që kanë marrë tapi	
			Arë	Pemëtore	Vreshta	Ullishte	Nr.	Ha
1	Bashkia Poliçan	130	83	25	10	12	281	130
2	NJ.A.Vertop	3,163	2,504	473	180	210	1,635	1,716
3	NJ.A.Terpan	3,701	3,088	355	89	169	1,546	3,701
Totali		6,994	5,675	853	279	391	3,462	5,547

Burimi: Të dhënat janë nxjerrë nga zyra e Tatim Taksave

Nga tabela e mëposhtme vihet re se në Bashkinë Poliçan janë posedues të tokës bujqësore sipas ligjit, gjithsej **3,462** familje dhe që duhet ti nënshtrohen taksës për këtë pasuri të paluajshme sipas kuadrit ligjor.

Në bashkinë Poliçan rezulton se toka bujqësore u përket kategorive IV deri VII, sipas përkatësisë, ku specifikohet ndarja e fondit të tokës sipas kategorive dhe nga vlerësimi i kryer nga Instituti Bujqësor.

Tabela nr 12. Vlerësimi i tokës sipas sipërfaqes/kategorisë/cmimit në lekë

Kategoria/tokë	Cmimi/ha/vit	Sipërfaqia/ha	Shuma/lekë	Planifikimi taksës/vit 2022
Kategoria II				
Kategoria III				
Kategoria IV	486	1,350	1,117,800	
Kategoria V	1,651	1,250	3,136,900	
Kategoria VI	1,813	1,200	2,900,800	
Kategoria VII	1,208	1,100	1,691,200	
Totali	5,158		8,790,000	8,790,000

Burimi: Bashkia Poliçan

Për realizimin e të ardhurave nga sipërfaqet e dhëna me qëra nga fondi pyjor dhe kullosor në Bashkinë Poliçan, dokumentet e lejeve minerare të dhëna nga M.I.E, që ndodhen në territorin e Bashkisë Poliçan:

Nga verifikimi i të dhënave në Bashkinë Poliçan Qiramarrësit kanë lidhur 4 kontrata qeraje për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik dhe dhënie me qera antene. Në total sipërfaqja e dhënë me qira për këto 4 kontrata është 86.58 ha dhe vlera vjetore që pritet të arkëtohet nga këto kontrata është 1,517,853 lekë.

Tabela Nr.13: Lista e kontratave të qirasë të fondit pyjor dhe kullosor në lekë

Nr	Qiramarrsi	Nr.Kontrate	DATA KONTRATES	E	Afati/Vjet	Qëllimi	Sip.Ha	Vlera/lekë/vit
1	V.ENERGY	Nr.2600 prot	30.09.2019		2-5	HEC	2.88	633,600
2	Kl. A.	Nr.506 prot	11.11.2013		99	Ullishte	61.7	345,800
3	P.J.	Kol.906,Rep.1534	22.07.2019		99	Ullishte	22	133,453
4	V. Albania	Kol.76.Rep.1603	16.04.2020		9	Qera antene		405,000
	Totali						86.58	1,517,853

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga verifikimi i Dokumentet e Lejeve Minerare të dhëna nga M.I.E, që ndodhen në territorin e Bashkisë Poliçan, rezulton 1 subjekt me kontratë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga ana e Bashkisë Poliçan, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në :

VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar. përsa i përket arkëtimit të të ardhurave nga qiratë për sipërfaqet e tokave pyjore e kullosore dhe Inproduktive që ndodhen në territorin e Bashkisë Poliçan.

Referuar pikës 2; lidhjes nr.2, pika 6/1 dhe pika 9/4 të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, në të përcaktohet që:

Pika 2. Për përdorim sipërfaqesh të fondit pyjor e kullosor publik, zbatohen tarifat dysheme, që llogariten duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar, sipas lidhjes 2 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij."

LIDHJA NR.2 “Tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik për ushtrimin e veprimtarive”.

Pika 6. Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë)

Nr. Përdorimi i territorit Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit

1 vit 2-5 vjet 6-10 vjet

1 Inproduktive 540 000 / 495 000 / 440 000

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore dhe Inproduktive, në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë, për të cilat nuk janë lidhur kontrata qiraje, bazuar në dokumentet e paraqitura nga Sektori i të Ardhurave, Bashkia Poliçan, konstatohet se:

Në territorin e Bashkisë Poliçan ushtrojnë aktivitet privat 1 subjekt i pajisur me leje minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, subjekte të cilat nuk kanë lidhur kontratë qiraje për sipërfaqet pyjore dhe kullosore, por që i shfrytëzojnë këto pasuri për qëllime biznesi nga subjektet private.

Në vijim paraqiten subjektet e pajisur me leje minerare nga MEI dhe statusi i tyre për vitin 2022.

Tabela nr 14. Subjektet e pajisura me leje minerare nga MIE

Nr	Leje	Data e lejes	Emërtimi i Subjektit	Nipt	Bashkia	Emërtimi i vendburimit	Lloji i mineralit	S=km ²	Lloji i lejes	Leja
1	719/1	28.06.2013	N.P.R shpk	K.....71	Poliçan	Zhitom	Gëlqeror pllakor	0.033	Shfrytëzimi	Aktive

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës

U auditua dokumentacioni për periudhën 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022, në lidhje me dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, dhe Inproduktive, nga ku konstatohet se nga Bashkia Poliçan, nuk është vepruar për të dhënë me qira, sipërfaqet pyjore dhe kullosore për të cilat të lidhte kontrata qiraje, të cilat janë miratuar me leje nga M.I.E me subjektet e trajtuara në vijim dhe rezultojnë deri në nëntor 2022 tek rregjistri i lejeve minerare 2022.

Pasqyra e detyrimeve të subjekteve, periudha 01.01.2022-31.12.2022.

Nr	Leje	Data e lejes	Emërtimi i Subjektit	Nipt	Lloji i mineralit	S=km ²	Tarifa lek/ha	Detyrimi
1	719/1	20.08.2003	N.P.R shpk	K.....1	Gëlqeror pllakor	0.033	440,000 lek/ha	1,012,000

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Nga auditimi i kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore dhe Inproduktive, në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Poliçan, për të cilat nga Bashkia Poliçan, nuk është vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore me sipërfaqe totale prej 0.033 km² (3.3 hektarë ose 33.000 m²), ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë) me afat 6-10 vjet ku tarifa vjetore është 440,000 lekë/ha/vit në territor tokë Inproduktive.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia Poliçan rezulton se subjekti ka certifikatë për vërtetim pronësie në datën 12.02.2002, në zonën kadastrale nr.3930, numri i pasurisë 650/4, volumni 9. Faqe 58, adresa e pasurisë Berat, Zhitom i madh, lloji i pasurisë kullotë vetëm për

sipërfaqen 10.000 m2 (1 hektarë) dhe jo për sipërfaqen totale për të cilën ka marrë lejen e shfrytëzimit. Veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr 391, datë 21.06.2006, i ndryshuar “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6/1, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Poliçan, në vlerën (440.000 lekë x 2.3 hektarë) 1,012,000 lekë.

Titulli i gjetjes 9: Mbi realizimin e të ardhurave nga sipërfaqet e dhëna me qëra nga fondi pyjor dhe kullosor në Bashkinë Poliçan.

Situata: Nga auditimi i kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore dhe Inproduktive, në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Poliçan, për të cilat nga Bashkia Poliçan, në një rast nuk është vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore me sipërfaqe totale prej 0.033 km2 (3.3 hektarë ose 33.000 m2), ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë) me afat 6-10 vjet, ku tarifa vjetore është 440,000 lekë/ha/vit në territor tokë Inproduktive.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia Poliçan rezulton se subjekti N.P.R shpk, ka certifikatë për vërtetim pronësie në datën 12.02.2002, në zonën kadastrale nr.3930, numri i pasurisë 650/4, volumi 9. Faqe 58, adresa e pasurisë Zhitom i madh, lloji i pasurisë kullotë vetëm për sipërfaqen 10.000 m2 (1 hektar) dhe jo për sipërfaqen totale për të cilën ka marrë lejen e shfrytëzimit. Veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr.391, datë 21.06.2006, i ndryshuar “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6/1, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Poliçan, në vlerën (440.000 lekë x 2.3 hektarë) 1,012,000 lekë.

Kriteri: Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35.

-VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, pika nr.2, e lidhjes nr.2, pika 6/1 dhe pika 9/4 ku përcaktohet: “Pika 2. Për përdorim sipërfaqesh të fondit pyjor e kullosor publik, zbatohen tarifat dysHEME, që llogariten duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar, sipas lidhjes 2 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”

LIDHJA NR.2 “Tarifat dysHEME për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik për ushtrimin e veprimtarive”.

Pika 6. Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë) Nr. Përdorimi i territorit Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit.

1 vit 2-5 vjet 6-10 vjet

1 Inproduktive 540 000 / 495 000 / 440 000”.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Poliçan, nga mos aplikimi i tarifave për shfrytëzim të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masa për arkëtimin e shumës prej 1,012,000 lekë si rezultat i mos aplikimit të tarifave për shfrytëzim të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore për operatorin ekonomik N.R.SH, që është pajisur me leje minerare nga M.I.E.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi znj. A.C me detyrë Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe z. F.A me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit.

Nga auditimi i kontratave aktive HEC lidhur me A.K.B.N rezultoi se në territorin e Bashkisë Poliçan ushtronë aktivitet 2 Shoqëri Koncesionare sipas tabelës vijuese;

Tabela nr 15.

Nr.	Qarku	HEC-i	" Shoqeria Koncesionare	Kontratat koncesionare
1	Berat	Vertop	H.S shpk	1
2	Berat	Vokopola 1, 2, 3	V.E	3

Burimi: AKBN dhe Bashkia Poliçan

1. Vokopola Energy:

-Kontratë qiraje për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor nr.2600 prot, datë 30.09.20219 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Poliçan z. A.Z dhe qiramarrësi shoqëria "V.E"shpk.

- Afati i kontratës është 2-5 vite, duke filluar nga data e nesërme e nënshkrimit të saj.

-Vlera e kontratës është 543,750 lekë, nga të cilat 522,000 lekë i përket lëndëve drusore, vlerë e llogaritur sipas VKM nr 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave, i ndryshuar.

2. H.S.E. Nga auditimi rezulton se Bashkia Poliçan për këtë HEC nuk ka lidhur kontratë qiraje për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor, veprime në kundërshtim me VKM nr 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave, i ndryshuar.

Titulli i gjetjes 10: *Mbi realizimin e të ardhurave nga sipërfaqet e dhëna me qëra nga fondi pyjor dhe kullor në Bashkinë Poliçan.*

Situata: Nga auditimi i HEC-eve që operojnë në Bashkinë Poliçan dhe kanë kontratë aktive me A.K.B.N rezulton se H.H.S.E, i cili operon në NJA Vertop, të Bashkisë Poliçan dhe ka kontratë koncesionare aktive me A.K.B.N, nuk ka lidhur kontratë qiraje për përdorimin e fondit pyjor dhe kullor me bashkinë, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave, i ndryshuar **Kriteri:** VKM nr 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave, i ndryshuar.

Ndikimi: Mos aplikimi i tarifave për shfrytëzim të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masa për lidhjen e kontratës së qirasë për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor me operatorin ekonomik H.S.E dhe të aplikojë tarifën duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar sipas përcaktimeve ligjore.

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse

Në territorin e Bashkisë Poliçan për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 5 subjekte.

Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022

Tabela nr 16: Përmbledhje mbi subjektet hidrokarbure, pajisja me autorizimin përkatës dhe pagesat e taksave dhe tarifave vendore

NR	SUBJEKTI TREGETUES	Adresa	Autorizime	Detyrime vjetore 2022
1	K	Poliçan	28.02.2022-28.02.2023	Paguar detyrimet vendore për vitin 2022
2	L.2	Poliçan	01.08.2022-31.07.2027	Paguar detyrimet vendore për vitin 2022

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga verifikimi i dosjeve të subjekteve që janë pajisur me autorizim për vitin 2022 nuk u konstatuan parregullsi.

Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2022

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve ndaj Bashkisë Poliçan në vlerën gjithsej **74,697,760** lekë, janë debitorë subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh gjithsej **79** subjekte në vlerën **26,835,864** lekë, debitorë nga toka bujqësore **2,424** familje në vlerën **45,357,282** lekë, si dhe nga taksa e tarifave ndërtesë-ndriçim-pastrim-gjelbërim në vlerën **2,504,614** lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se subjektet janë njoftuar periodikisht për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për çdo vit, si dhe janë rinjoftuar në rastet e vonesave në pagesat e detyrimeve vendore. Gjendja e debitorëve për subjektet fizik/juridik paraqitet për periudhën 2021-2022 paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela nr 17. Gjendja e debitorëve për subjektet fizik/juridik paraqitet për periudhën 2021-2022 në lekë

Nr	Emertimi	Subjektet debitorë 31.12.2021	Debitorë vitit 2022	Paguar	Subjektet debitorë 31.12.2022
1	Bashkia Poliçan	19,197,889	2,791,778	248,340	21,741,327
2	NJA Vertop	4,524,439	614,468	44,370	5,094,537
3	NJA Terpan				-
	Totali	23,722,328	3,406,246	292,710	26,835,864

Burimi: Bashkia Poliçan

Në Bashkinë Poliçan familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, tarifave të pastrimit, ndriçimit dhe të gjelbërimit. Në tabelat në vijim paraqiten në mënyrë të përmbledhur detyrimet e familjeve sipas taksave dhe tarifave.

Tabela nr 18. Detyrimet e familjeve sipas taksave dhe tarifave në lekë

Nr	Emertimi	Biznese		Taksë toke bujqësore		Debitor për taksa e tarifave Ndërtesë-Ndriçim-Pastrim-Gjelbërim	Totali progresiv 31.12.2022
		Nr.	Shuma	Nr.	Shuma		

1	Bashkia Poliçan	50	21,741,327	191	781,312	2,504,614	25,027,253
2	NJA Vertop	29	5,094,537	936	12,476,055		17,570,592
3	NJA Terpan	-		1,297	32,099,915		32,099,915
Total i		79	26,835,864	2,424	45,357,282	2,504,614	74,697,760

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga auditimi rezulton se, vlera totale e debisë (borxhit tatimor) në mënyrë progresive në Bashkinë Poliçan paraqitet:

Debitorët në shuma progressive në fund të vitit 2022

Detyrimet për **taksën e tokës bujqësore** janë në shumën **45,357,282 lekë**;

Detyrimet nga **taksat dhe tarifatat familjare** (ndërtesë-pastrim-gjelbërim-ndricim) janë në shumën **2,504,614 lekë**;

Detyrimet nga **taksat dhe tarifatat e bizneseve** në shumën **26,835,864 lekë** për **79** subjekte;

Në total **borxhi tatimor në fund të vitit 2022** paraqitet në shumën **74,697,760 lekë**.

Për vitin 2022

Detyrimet për **taksën e tokës bujqësore** janë në shumën **3,406,246 lekë**;

Detyrimet nga **taksat dhe tarifatat familjare** (ndërtesë-pastrim-gjelbërim-ndricim) janë në shumën **142,405 lekë**;

Detyrimet nga **taksat dhe tarifatat e bizneseve** në shumën **741,327 lekë** për **79** subjekte;

Në total **borxhi tatimor për vitin 2022** paraqitet në shumën **4,289,978 lekë**.

Titulli i gjetjes 11: *Gjendja e debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore dhe masat e marra nga Bashkia Poliçan për të arkëtuar detyrimet.*

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se gjendja e debitorëve në vlerë progresive në fund të vitit 2022 për 79 subjektet fizik/juridik është 26,835,864 lekë, për taksën e tokës bujqësore në vlerën 45,357,282 lekë dhe për taksat dhe tarifatat familjare 2,504,614 lekë, në total borxhi është në vlerën **74,697,760 lekë**, vlerë e cila përbën **të ardhura të planifikuara por të pa arkëtuara** në buxhetin e Bashkisë Poliçan (ku për vitin 2022 të ardhura të planifikuara por të pa arkëtuara janë në shumën 4,289,978 lekë)

Kriteri: - VKB-në nr. 45, datë 24.12.2021 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre për vitin 2022”, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Poliçan, në vlerën **74,697,760 lekë**.

Shkaku: Mos zbatimi i akteve ligjore e nënligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore nga debitorët.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masat e duhura ligjore, administrative dhe gjyqësore, për arkëtimin

e vlerës 74,697,760 lekë, e cila është borxh ndaj Bashkisë Poliçan, nga debitorët taksapagues privat dhe familjar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi znj. A.C me detyrë Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore

Pika nr.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2022.

Nga auditimi ka rezultuar se:

▪ Bashkia Poliçan ka përgatitur dhe raportuar Pasqyrat Financiare të vitit 2022, mbështetur në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme". Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Skrapar si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

▪ Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2022 janë:

- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
- Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasyrat financiare (F5);

Pasqyrat statistikore:

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);
- Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, ku janë dhënë informacion mbi:
 - Emrin e njesisë ekonomike raportuese, Bashkia Poliçan me NIPT K49312401S;
 - Nëse pasqyrat financiare mbulojnë një njësi ekonomike raportuese individuale apo grup njësisish;
 - Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2022-31.12.2022;
 - Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
 - Data e hartimit të Pasqyrave Financiare, 28.02.2023;
 - Përgatitur nga znj.F.H,
 - Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Skrapar me shkresën nr.610, datë 28.02.2023, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Poliçan z. A.Z, konfirmuar nga Dega e Thesarit Skrapar
 - Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Aktrakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Skrapar të konfirmuara dhe nënshkruara.

Pasqyrat Financiare viti 2022 (Bashkia Poliçan)

Paraqitja dhe raportimi i tyre është kryer në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 03.09.2018, i ndryshuar, Kapitulli V "Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore".

Tabela nr.3.1Aktivi i Bilancit Kontabël 2022 Bashkia Poliçan

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	A K T I V E T	1,429,486,764	1,458,496,962
2		I.Aktivët Afat shkurtër	323,827,274	462,807,909
3		1.Mjete monetare dhe ekujvalent të tyre	16,256,092	17,737,342
4	531	Mjete monetare në Arke	6,740	0
5	512,56	Mjete monetare në Banke		
6	520	Disponibilitete në Thesar	16,249,352	17,737,342
7	50	Letra me vlerë		
8	532	Vlera të tjera		
9	54	Akreditiva dhe parashënime		
10	59	Provizione zhvlersimi letra me vlerë (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	18,818,126	15,493,821
12	31	Materiale	2,588,435	2,417,678
13	32	Inventar i imet	15,828,891	12,675,343
14	33	Prodhim në proces		
15	34	Produkte	400,800	400,800
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe në rritje e majmeri		
18	37	Gjendje të pa mbitura, ose pranë të tretteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provizione për zhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari të Arketushme	194,535,082.00	248,734,748
22	411	Kliente e llogari të ngjashme		
23	423,429	Personeli, parashënime, deficite, gjoha		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore që mbulohe nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqërore		
28	436	Sigurime Shendetësore		
29	437,438,	Organizma të tjera shtetërore		
30	44	Institucione të tjera publike		
31	465	Efekte për tu arketuar nga shitja e letrave me vlerë	0	0
32	468	Debitorë të ndryshëm	88,494,189	79,843,886
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	106,040,893	168,890,862
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma të parashikuara për zhvlersim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	94,217,974	180,841,998
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes të mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime		
41	486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	94,217,974	180,841,998
42		II.Aktivët Afat gjatë	1,105,659,490	995,689,053
43	20	1.Aktive Afatgjatë jo materiale	1,200,014	2,053,501
44	201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave		
45	202	Studime dhe kërkime	1,200,014	2,053,501
46	203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjatë materiale	1,057,420,323	909,396,399
48	210	Toka, T,roje, Terene	1,188,000	1,188,000
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndertesa e Konstruksione	298,458,629	234,925,380
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	723,347,703	650,322,231
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	699,321	1,425,708
53	215	Mjete Transporti	23,981,310	11,672,239
54	216	Rezerva Shtetërore		

55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	9,745,360	9,862,841
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare		
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrije ne kapitalin e vet		
62		4.Investime	47,039,153	84,239,153
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	47,039,153	84,239,153

Burimi: Bashkia Polican

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

- Aktivët neto janë të barabarta me Aktivët-Pasivët= **1,112,679,689** lekë.
- Aktivët 1,429,486,764 lekë
- Pasivët 316,807,075 lekë
- Aktivët neto 1,112,679,689 lekë

Aktivët Afatshkurtra

Aktivët afatshkurtra më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **323,827,274** lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekujvalentët e tyre” në shumën 16,256,092 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 18,818,126 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 194,535,082.00 lekë.
- Llogaritë e Klasës 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 94,217,974 lekë.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre”, përbëhet nga:

-Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së bilancit të vitit 2022 është në shumën 16,256,092 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën 17,737,342 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” në vlerën 17,737,342 lekë dhe rubrikën VI “Teprica e Likujditeve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën 16,256,092 lekë. (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”)

Rakordimi i llogarive me degën e thesarit, llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, llogaria nr.466 “Mjete në ruajtje” dhe llogaritë e të ardhurave

Viti 2022

Llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 16,256,092 lekë. Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit është e analizuar si më poshtë:

Testimi i llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar” për vitin ushtrimor 2022

Tabela 3.2 ANALIZA E PASQYRES SE FLUKSEVE MONETARE (Formatit nr. 3)

Llog 520

VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT		15,114,757
Akordimi i fondeve buxhetore per shpenzime korente viti 2022 :		266,777,395
Plani grantit i pakushtezuar per shpenzime korente		178,128,796
Plani i grantit te kushtezuar per shpenzime korente		100,926,780
Granti i pakushtezuar i paçelur sipas akt-trashegimise		860,001
Granti I pakushtezuar i trasheguar nga viti 2021		-13,138,182
Arketime e te hyra(Cash), gjate vitit ushtrimor		54,109,440
Plani i te ardhurave (05) viti 2022		42,355,122
Te ardhura nga shitja e investimeve 2022		1,098,120
Te ardhura te tjera		-11,786

Garanci e defekteve 5 % per investimet e paguara 2022		10,667,984
Pagesat per detyrime e shpenzime korente :		-305,772,078
nga keto :		
shpenzime per detyrime te vitit te kaluar :		-26,943,843
shpenzime per detyrime te vitit te kaluar :		-275,951,279
Mjete ne ruajte te paguara:		-2,876,956
Pagesa e 5 % :		
Veprimtarite e investimeve :		-12,511,236
Akordim fonde buxhetore per investime :		225,150,094
Fondet buxhetore per investime :		232,941,122
Garanci e defekteve 5 % te hyra		-10,667,984
Garanci e defekteve 5 % te paguara		2,876,956
Shpenzimet per investimet		-237,661,330
Pagesa per detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)		-72,987,721
Per detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)		-164,673,609
Transferata te tjera		-4,084,771
Derdhje te ardhura ne buxhet		-42,210
Derdhje fondesh ne buxhet (te kushtezuara)		-4,042,561
Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare :		-1,481,250
Teprica ne fillim te vitit ushtrimor		17,737,342
Teprica e Likujditeteve ne fund te vitit ushtrimor		16,256,092
Kjo vlere eshte e perbere :		
mjetet monetare ne arke	6,740	
mjetet monetare ne thesar	16,249,352	
Shuma	16,256,092	

Burimi: Bashkia Poliçan

Për vitin 2022 nga verifikimi për cdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës së shpenzimeve e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit duke analizuar dokumentat e nxjerjes së llogarive nga thesari për cdo muaj, për shumat e llogarive në cdo muaj dhe në total për vitin ushtrimor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i vitit 2022 i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (celje) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë nr.520 “Disponibilitete në Thesar” dhe me ditarin e bankës rezultojnë të jenë të rakorduara, veprimet të paraqitura në tabelat e mësipërme.

▪ Tabela 3.3 Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
31	Materiale	2,588,435	2,417,678	170,757
32	Objekte inventari	15,828,891	12,675,343	3,153,548
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces			
34	Produkte	400,800	400,800	0
35	Mallra			
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri			
37	Gjendje te pambritura ose pranë të tretteve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)			
	Totali	18,818,126	15,493,821	3,324,305

Burimi: Bashkia Poliçan

- Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Poliçan në 31.12.2022 paraqitet në shumën 18,818,126 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 2,588,435 lekë, nga llogaria kontabël 32 “Objekte inventari” në vlerën 15,828,891 lekë dhe nga llogaria kontabël 34 “Produkte” në vlerën 400,800 lekë.

- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 3,325,305 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 3,325,305 lekë. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

- Tabela 3.4 Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”&“Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	
431	Tatime e taksa	0	0	
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal	0	0	
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	0	0	
435	Sigurime Shoqërore	0	0	
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	0	0	
44	Institucione te tjera publike	0	0	
465	Efekte per t'u arkëtuar nga shitja letra me vlere vendosjes	0	0	
468	Debitorë te ndryshëm	88,494,189	79,843,886	8,650,303
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	106,040,893	168,890,862	-62,849,969
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0	0	
49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)	0	0	
	Totali	94,217,974	180,841,998	-86,624,024
	Të tjera aktive afatshkurtra	0	0	
409	Furnitore(Debitore),parapagime pagesa pjesore	0	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	94,217,974	180,841,998	-86,624,024
	Totali	94,217,974	180,841,998	-86,624,024

Burimi: Bashkia Poliçan

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 88,494,189 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 79,843,886 lekë. Vlera e debitorëve ne vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka pësuar një rritje prej 8,650,303 lekë, e cila ka ardhur nga rritja e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore. Analiza e gjendjes së llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3.5 Paraqitja e llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” për vitin 2022 në lekë

Nr	Përshkrimi	Dokumentacioni	Gjendje 31.12.2021	Shtesa 2022	Pagesa 2022	Gjendje 31.12.2022
1	Debitorë nga klsh 1998-2021	Raport KLSH	6,062,715	4,674,071	275,910	10,460,876
2	Debitorë nga Prefektura	Prefektura	1,336,635			1,336,635
3	Debitorë nga ISSH	Përfutur me tepër	177,376		36,000	141,376
4	Debitorë nga tatim taksat	Tatim Taksa	70,299,118	16,345,322	11,946,680	74,697,760
	Debitorë për bileta tregu, pulla gj.		510,550	325,000	435,500	400,050
5	Debitorë nga Audit i brendshëm	Audit i brendshem	1,457,492			1,457,492
6	Veprim sistemimi (ndalur më tepër)	ndalesë llog 468	0			0
	TOTALI		79,843,886	21,344,393	12,694,090	88,494,189

Burimi: Bashkia Poliçan, Të dhënat të përpunuar nga audituesi

-Nga analizimi i regjistrave të debitorëve në Bashkinë Poliçan, konstatohet se vlera e debitorëve që rrjedhin nga detyrimet nga taksat dhe tarifat vendore për vitet objekt auditimi deri në 31.12.2022 janë kontabilizuar të plota dhe rakordojnë me vlerat e paraqitura nga Sektori i Taksave dhe të Ardhurave për vitin **2022** në shumën prej **74,697,760 lekë**.

- **Llogaria 4342 “Te tjera operacione me shtetin (debitor)”**, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 106,040,893 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 106,040,893 lekë, në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, Kapitulli III, pika 32. Vlera prej 106,040,893 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Tabela nr.3.6 në lekë

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-409	93,899,952
Paga personeli llog 42	8,717,258
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	419,764
Sigurime shoqërore llog.435	2,599,258
Sigurime shëndetësore llog.436	404,662
Totali	106,040,894

- **Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, vlera e kësaj llogarie përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të financuara në vitin ushtrimor. Kjo llogari ka si kundërparti gjendjen e llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasiv të bilancit në vitin 2022 në vlerën prej 94,217,974 lekë, e analizuar më poshtë.

Tabela nr3.7

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	180,841,998
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	14,642,255
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	101,266,279
Gjendja në 31.12.2022	94,217,974

Burimi: Bashkia Poliçan

- Vlera e kësaj llogarie në shumën 94,217,974 lekë, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të pa financuara në vitin ushtrimor. Gjatë vitit 2022 ka patur një pakësim të kësaj llogarie, pasi janë likuiduar një pjesë e konsiderueshme e këtyre detyrimeve.

Tabela nr.3.8 Detyrime për shpenzime të kryera

në lekë

Artikull	Gjendje 31.12.2022	Objekti
4864100	7,082,391	Det.te prapambetura per Vendimet gjyqesore
4864200	1,389,193	Det.te prapambetura per Sherbimet
4864201	1,298,980	Det.te prapambetura per energjine elektrike
4864300	0	Det.te prapambetura per Miremabjtje
4864400	21,813,205	Det.te prapambetura per Investime
4864400	53,639,153	Det.te prapambetura per Investime
4864600	0	Det.te prapambetura per mallra
4864901	0	Det.te prapambetura per paga
4864902	6,775,052	Det.te prapambetura per shpronësime
4864904	2,220,000	Det.te prapambetura te tjera
4864100	94,217,974	Shp.Periudh te ardhsh.per detyrime te prapamb

Burimi: Bashkia Poliçan

- Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2022, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, pika 42 ku cilësohet: *"Të gjitha Njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera por të pafinancuara"*.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

Aktivitet afatgjatë jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 "Aktivitet Afatgjatë Jo materiale", përbëhen nga llog.202 "Studime dhe kërkime", në vlerën 1,200,014 lekë në fund të vitit 2022 dhe në vitin 2021 në shumën 1,411,781 lekë.

Gjithashtu sipas formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)" në fund të vitit ushtrimor 2022 llogaria nr.202 "Studime dhe kërkime" paraqitet në vlerën 1,200,014 lekë.

Tabela nr.3.9: Llogaria 202

në lekë

Emertimi I aktivitetit	Data e hyrjes	Çmimi	Vlera	Norma e amortizimit	Am.akumuluar deri 31.12.2021	Vlera mbetur deri 31.12.2021	Am. viti 2022	Am.llogaritë për vitin 2022	Kosto historike e AAGJ	Am. akumuluar 31.12.2022	Vlera mbetur 31.12.2022
2	3	5	6	7	8	9=6-8	11	12=(9+10)*7*11	15=6+10-13	16=8+12	17=15-16
Projekte të paidentifikuara	para 2015	2,704,895	2,704,895	%	1,293,114	1,411,781	12	211,767	2,704,895	1,504,881	1,200,014
Shuma			2,704,895		1,293,114	1,411,781		211,767	2,704,895	1,504,881	1,200,014

Burimi: Bashkia Poliçan

-Referuar formatit të mësipërm vihet re së për llogarinë nr.202 "Studime dhe kërkime", nuk kemi patur shtesa dhe pakësime, ku kosto historike paraqitet në vlerën 1,411,781 lekë duke zbritur amortizimin e akumuluar në vlerën 211,767 lekë, teprica neto (vlera kontabël neto) paraqitet në shumën prej 1,200,014 lekë.

Nga auditimi rezulton se nuk ka analiza për vlerën 2,704,895 lekë që vjen nga bashkimi i bilanceve me Komunën Vërtop, në vitin 2015, veprimi është në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 8, i ndryshuar, datë 9.03.2018 *"Për procedural e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme"*, kapitulli II, pika 11.

Ndërsa për vlerat e studimeve e mbetura në këtë llogari dhe vlerat bruto të projekteve e reja të investimeve të cilat do të mbeteshin gjendje në fund të vitit ushtrimor, llogaritja e amortizimit bëhet në masën 15% .

Për këto aktive nuk ka inventar, si dhe nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv, gjithashtu në pjesën më të madhe të llogarisë nr.202 "Studime dhe kërkime", analitiku i kësaj llogarie ka mangësi të theksuara pasi mungojnë përshkrimet e studimeve dhe projekteve, viti i krijimit të tyre, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 26 ku citohet: *"Cdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Rregjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar"*, pika 30 ku citohet: *"Formati i rregjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si*

dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë rregjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”

Titulli i gjetjes 12: Mbi kontabilizimet e aktiveve jo materiale në llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” në aktiv të bilancit dhe analiza e tyre.

Situata: Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se llogaria 202 “Studime dhe kërkime” ka vlerën 2,704,895 lekë, e cila përfshin edhe vlera të kësaj llogarie bashkimi i balanceve me Komunën Vërtop, në vitin 2015..

Për këto aktive nuk ka inventar, si dhe nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv, nuk ka analizë të kësaj llogarie, duke mos analizuar i kësaj llogarie ka mangësi të theksuara pasi mungojnë përshkrimet e studimeve dhe projekteve dhe viti i krijimit të tyre.

Kriteri: Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26, pika 30.

Ndikimi: Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata jomateriale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizimit të aktiveve si dhe nuk janë analizuar një pjesë e aktiveve jo materiale.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa për verifikimin e çdo zëri të llogarisë nr.202 “Studime dhe Kërkime” dhe pas evidentimit të projekteve të finalizuara dhe statusit të çdo zëri, të kryhen regjistrimet kontabël në lidhje me kapitalizimet në aktivet përkatëse apo çregjistrimet sipas rastit.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtori i Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare, zj.F.H

Aktivitet afatgjata materiale (AAM)

▪ **Llogaritë e Klasës 21 “Aktivitet Afatgjata Materiale”,** AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, vlera kontabël neto paraqitet në shumën 1,057,420,323 lekë. Në vitin paraardhës 2021, vlera kontabël neto e AAM-ve paraqitet në shumën 909,396,399 lekë, me një pakësim të AAM-ve në shumën 148,023,924 lekë.

Tabela nr.3.10 AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (AAM)

(Vlera kontabël neto)

Llog.Kontabel	Përshkrimi i llogarive	Çelje 2021	Shtesa 2022	Pakësime 2022	Gjendje në fund 2022
	AAGJM	909,396,399	207,226,171	59,202,247	1,057,420,323
210	Toka ,troje, Terrene	1,188,000	-	0	1,188,000.00
211	Pyje, Kullota Plantacione		-	0	0.00
212	Ndërtesa e Konstruksione	298,458,629	73,215,890	9,682,641	298,458,629.00
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	723,347,703	121,117,716	48,092,244	723,347,703.00
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	699,321	141,280	867,666	699,321.00
215	Mjete transporti	23,981,310	12,309,071	0	23,981,310.00
216	Rezerva shtetërore			0	0.00
217	Kafshe pune e prodhimi		-	0	0.00
218	Inventar ekonomik	9,745,360	442,214	559,696	9,745,360.00

219	Amortizimi i AAGJM (-)	-	-	-	
-----	------------------------	---	---	---	--

Burimi: Bashkia Poliçan

Ndërsa sipas formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbylljen e vitit ushtrimor 2022 në vlerën 1,726,768,308 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 1,504,679,950 lekë. Llogaritë do të analizohen si më poshtë:

-Llogaria nr.210 "Toka, troje, terrene" paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 1,188,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 1,188,000 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2021 paraqiten në vlerën prej 1,188,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në të njëjtën vlerë prej 1,188,000 lekë.

- Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i truallit, shesheve, me komision të ngritur nga titullari i njësisë vendore, veprimi është në kundërshtim me UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kap IV. pika 74,96.

-Llogaria nr.211 "Pyje, Kullota, Plantacione" paraqitet me vlerë neto 0 lekë në fund të vitit 2022. Te analitikët e llogarisë nr.211 përbëhet pemë të llojeve të ndryshme të kontabilizuara nga vitet e mëparshme.

Tabela nr.3.11: Llogaria nr.211 "Pyje, Kullota, Plantacione

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Data e hyrjes	Shtesa	Gjendje 2021	Gjendje 2022
	211	Per sa kontabilizohen Pyll prodhues (geshtenja) Zona kadastrale 3019 ,Nr. pasurise 112a, sipërfaqe 135000 m2, mbi rrugen Unaza e Plirezes Poliçan , dt .leshimi I pronesisë 23.6.2010 , VKM nr. 896,dt. 11.6.2008				
1	211	Per sa kontabilizohen Pyll (pishë e eger) Zona kadastrale 3019 ,Nr. pasurise 112d, sipërfaqe 26000 m2,Anes Rruges Unaza e Plirezes Poliçan , dt .leshimi I pronesisë 23.6.2010 , VKM nr. 896,dt. 11.6.2008	23.06.2010			0
Shuma						0

Burimi: Bashkia Poliçan

Në llogarinë 211 "Pyje, kullota, plantacione", nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Poliçan, të transferuara me VKM nr. 896, datë 11.6.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të Njësisë së Qeverisë Vendore, Bashkisë Poliçan, Qarkut Berat". Sipas këtij vendimi Bashkia Poliçan ka në pronësi gjithsej **161,000** m2 nga të cilat 135,000 m2 pyll prodhues (gështenja), 26,000 m2 pyll (pishë e egër). Veprimi është në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 8, datë 09.03.2018, kapitulli II, pika 11, aneksi I, pika 2 klasa 2.

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit. Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione", nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 08, datë 09.03.2018 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, kap IV. pika 74, pika 96, "Procesi i vlerësimit të aktiveve realizohet nga komisioni i vlerësimit, ndërsa procesi i dhënies në përdorim/tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit kryhet nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi. Këto dy komisione ngrihen me urdhër të titullarit të njësisë publike me propozim të nëpunësit autorizues. Nëpunësi autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit".

-Llogaria nr.212 "Ndërtesa dhe Konstruksione", në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 298,458,629 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën prej 234,925,380 lekë.

Referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në fund të vitit 2021 paraqitet në koston historike prej 314,333,759 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2022, në shumën 401,217,451 lekë, pra me shtesë në shumën 86,883,692 lekë.

Tabela nr 3.12: Llogaria nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksione në lekë

Nr.	Emertitimi I aktivitetit	Data e hyrjes	Sasia	Vlera mbetur 31.12.2022
1	Mur mbajtes i suvatuar	para 1992	1	79,272
2	Mur mbajtes me beton	para 1992	1	8,062
3	Mur mbajtes per prite te zakonshme	para 1992	1	67,180
4	Depo te ish-nd/komunale	para 1992	1	7,211
5	Zyra e ish-ndermarrjes komunale	para 1992	1	6,997
6	Mur mbajtes rruga Plirez	24/06/1905	1	138,842
7	Mur mbajtes ne lagjen mbi Lavdar	29/12/05	1	101,388
8	Repertitori	31/12/05	1	69,972
9	Mur mbajtes tek varrezat e vjetra	27/12/06	1	137,802
10	Zyrat e administrates 1 kat	Para 2015	1	16,149
11	depo e helmeve 1 kat	Para 2015	1	2,352
12	Depo pjese kembimi 1 kat	Para 2015	1	70,840
13	depo e bojrave	Para 2015	1	89,948
14	Zyra e magazines nr 02 1 kat	Para 2015	1	8,498
15	muri rrethues	Para 2015	1	16,513
16	kapanone	Para 2015	1	1,960
17	Tualet shkolla Lybeshe	Para 2015	1	103,434
18	Tualet shkolla Tomorr	Para 2015	1	101,330
19	Kopeshti Bregas	Para 2015	1	137,066
20	Shkolla Tozhar-Mb	2001	1	57,444
21	Shkolla Teman	19780	1	15,461
22	Shkolla Begaj Zhi	1980	1	80,593
23	Shkolla Plashnik	1975	1	13,289
24	Lapidari	2002	1	18,245
25	Zyrat e Vjetra te pyjores Terpan (pa pagese)	5/10/2017	1	20,225
26	Materniteti Rehove	1975	1	6,381

Burimi: Bashkia Poliçan

-Llogaria nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 723,347,703 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën neto prej 650,322,231 lekë. Referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në fund të vitit 2021 paraqitet në koston historike prej 1,092,855,960 lekë, me shtesa në vitin 2022 në shumën 119,603,498 lekë, dhe gjendje në fund në shumën 1,212,459,458 lekë.

Analitiku i llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” përbëhet nga 163 objekte.

Në analizën e gjendjes së llogarisë **213 "Rrugë, mjete, vepra ujore"** është përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 2,459,884 lekë e aktivitetit “Varrezat e reja”, i cili sipas klasifikimit kontabël i përket llogarisë **212 “Ndërtesa e Konstruksione”,** veprim në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 8, datë 9.03.2018, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, ku në pikën 11 përcaktohet se: *Përmbledhja e llogarive në klasa është mbështetur në analizën funksionale të veprimeve, që ato përshkruajnë. Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik është paraqitur në aneksin 1 të udhëzimit” dhe me Nomenklaturën e Llogarive të planit kontabël publik.*

Titulli i gjetjes 13: Mbi kontabilizimet e gabuara në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”

Situata: Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën bruto në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 11,212,459,458 lekë. Nga shqyrtimi i analizës së kësaj llogarije rezulton

se, është përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 2,459,884 lekë e aktivit “Varrezat e reja”, i cili sipas klasifikimit kontabël i përket llogarisë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”.

Kriteri: Udhëzimi i MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, I ndryshaur, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, dhe me Nomenklaturën e Llogarive të planit kontabël publik.

Ndikimi: Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore.

Shkaku: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka përfshirë në llogarinë 213 vlerën e një aktivi që i përket llogarisë 212.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Poliçan të kryejë veprimet e sistemit në kontabilitet në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022, për kalimin e vlerës prej 2,459,884 lekë e aktivit “Varrezat e reja” në debi të llogarisë përkatëse 212 “Ndërtime e konstruksione”, duke kredituar llog. 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, si dhe të bëhen rregullimet e nevojshme në llogaritjen e amortizimit.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtori i Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare, zj.F.H.

-Llogaria nr.214 “Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 699,321 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 1,425,708 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 8,856,123 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 6,110,102 lekë për të cilat ka inventar fizik. Gjatë vitit ushtrimor kemi pakësime nga kjo llogari të materialeve si pasojë e riklasifikimit në vlerën 3,005,071 lekë dhe nxjerrje jashtë përdorimit në vlerën 40,000 lekë.

-Llogaria nr.215 “Mjete transporti”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 23,981,310 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën neto 11,672,239 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në koston historike prej 47,524,550 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 64,140,194 lekë me shtesa në vitin 2022 në shumën 16,903,644 lekë si pasojë e dhurimit të dy mjeteve zjarrfikës. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve nga viti 2021 deri në fund të vitit 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3.12: Llogaria nr.215 “Mjete transporti

në lekë

Nr.	Emertimi I aktivit	Vlera	Shtesat e aktivit 2022	Vlera e AAGJ dale jashte perdorimit 2022	Vlera e mbetur 31.12.2022
1	Kamion benz me 3 akse TRG AA2775BR	2,640,000		0	2,640,000
2	Mercedes Benz AA 007 RU	2,160,000		0	2,160,000
3	Autovetur fuoristrad tip defender AA 139 FN	3,120,000		0	3,120,000
4	Mjeti ambulance AA 659 KR	13,700,625		0	13,700,625
5	Mjeti me targe AA510 BT	1,488,000		0	1,488,000
6	Mjeti fadrome FR6124C	3,480,000		0	3,480,000
7	Rul Ngjeshes	3,600,000		0	3,600,000
8	Eskavator me goma	5,400,000		0	5,400,000
9	Mjeti kamioçine KV 0827 B	985,000			985,000
10	Autozjarrfikse Skoda RT 303011	571,725		0	571,725
11	Mjeti Benz 322	1,000,000		0	1,000,000
12	Tojoto TARG AA172 NK	2,160,000		0	2,160,000

13	Furgon autoveture AA 560 RY	882,000		0	882,000
14	Benz TARG AA 808 MO	600,000		0	600,000
15	MitcubishTAR AA 768	1,668,000		0	1,668,000
16	Kamjon me vinc AA 894 AV	2,112,000		0	2,112,000
17	Autovinc AA 718 GH	1,669,200		0	1,669,200
18	Zjarrfikse e tipit kamioncine Ford Ranger me superstrukture Eëbo		16,903,644		16,903,644
19	Mjeti zjarrefikes RTO 1139	288,000		0	70,374
	Shuma	47,524,550	16,903,644	0	64,210,568

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga analiza e gjendjes së ***llogarisë 215 "Mjete Transporti"*** rezulton se vlera 288,000 lekë i përket 1 mjeti zjarrfikës, i cili është i dëmtuar, pra nuk është në gjendje pune dhe rrjedhimisht është kryer kontabilizimi i gabuar në llogarinë 215 "Mjete Transporti". Në fakt duhet kryer regjistrimi dhe kontabilizimi në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara", për mjetin e zjarrfikësës të dëmtuar, jo në gjendje pune, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 8, datë 9.03.2018, kapitulli II, pika 11, aneksi 1,pika 2/1, germa e, "*Për daljet nga kalimi në aktive afatgjata të dëmtuara, funksionimi i vlerës historike dhe amortizimit është: -Kreditohet llogaria 21 (analizat shtatëshifrore perkatëse;- Debitohet llogaria 24, "Aktive afatgjata të dëmtuara"*".

Titulli i gjetjes 14: *Mbi kontabilizimet e gabuara në llogarinë "Mjete Transporti"*.

Situata: Gjendja e llogarisë 215" Mjete Transporti" në vlerën bruto paraqitet në mbyllje të të vitit 2022 në vlerën 64,210,568 lekë. Nga shqyrtimi i analizës së kësaj llogarije rezulton se, vlera 288,000 lekë i përket 1 mjeti zjarrfikës, i cili është i dëmtuar, pra nuk është në gjendje pune dhe rrjedhimisht është kryer kontabilizimi i gabuar në llogarinë 215 "Mjete Transporti". Në fakt duhet kryer regjistrimi dhe kontabilizimi në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara", për mjetin e zjarrfikësës të dëmtuar, jo në gjendje pune.

Kriteri: Udhëzimi i MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, kapitulli II, pika 11, aneksi 1,pika 2/1, germa e.

Ndikimi: Mos pasqyrim i saktë i Llog.215" Mjete Transporti".

Shkaku: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka përfshirë gabim në llogarinë 215" Mjete Transporti" vlerën e 1 mjeti zjarrfikës, i cili është i dëmtuar,që i përket llogarisë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara".

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Poliçan të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022, për kalimin e vlerës prej 288,000 lekë i përket 1 mjeti zjarrfikës jashtë funksioni në debi të llogarisë perkatëse 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara",duke kredituar llog.215 "Mjete Transporti", si dhe të bëhen rregullimet e nevojshme në llogaritjen e amortizimit.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtori i Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare, zj.F.H.

-Llogaria nr.218 "Inventar ekonomik", në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 9,862,841 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 9,745,360 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 35,987,163 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën kontabël 38,660,208 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 760,600 lekë te

pajisjeve, shitesa pa pagesë në vlerën 1,205,071 lekë, lëvizjet brenda aktiveve në vlerën 3,005,071 lekë dhe pakësimet në vlerën 2,297,697 lekë.

Gjendja e llogarisë 28 “Caktime aktiveve afatgjata” paraqitet si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet per vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

Tabela nr.3.13: Gjendja e aktiveve afatgjata në lekë

Nr. Reference Llogaritje	Teprica ne fillim	Shitesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	3	4	5	6	7	8	9	10
20	2,053,501	0	211,767	1,229,500	587,780	2,704,895	1,504,881	1,200,014
201	0					0	0	0
202	2,053,501		211,767	1,229,500	587,780	2,704,895	1,504,881	1,200,014
203	0					0	0	0
21- 28	909,396,399	115,354	22,889,183	106,797,496	595,249	1,724,063,413	66,643,090	57,420,323
210	1,188,000					1,188,000	0	1,188,000
211	0					0	0	0
212	234,925,380	99,278,709	26,062,819	12,395,017	2,712,376	401,217,451	102,758,822	298,458,629
213	650,322,231	208,663,209	87,545,493	89,059,711	40,967,467	1,212,459,458	489,111,755	723,347,703
214	1,425,707	299,050	157,770	3,045,071	2,177,405	6,110,102	5,410,781	699,321
215	11,672,239	16,903,644	4,594,573			64,428,194	40,446,884	23,981,310
216	0	0		0		0	0	0
217	0	0		0		0	0	0
218	9,862,842	4,970,742	4,528,528	2,297,697	1,738,001	38,660,208	28,914,848	9,745,360
24				0	0	0	0	0
28	0	0		0		0	0	0
	911,449,900	330,115,354	123,100,950	108,026,996	48,183,029	1,726,768,308	668,147,971	1,058,620,337

Burimi: Bashkia Poliçan

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë sipas normave të amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në celje të periudhës ushtrimore për cdo aktiv.

Inventarizimi i aktiveve për vitin ushtrimor 2020, Bashkia Poliçan

Në bazë të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2022 për Bashkinë Poliçan.

Gjatë vitit 2022, me urdhrin e Titullarit të Bashkisë Poliçan, nr.316 datë 21.11.2022, për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata dhe nxjerrjes jashtë përdorimi për të gjitha asetet e Bashkisë për vitin 2022.

Në bazë të këtyre urdhrave është kryer procedura e inventarizimit në zyrat e Bashkisë, magazinave dhe në NJA, në shkolla, kopshte, cerdhe, Bibliotekë, Pallati i Kulturës, Qendrës Kulturore të Fëmijve dhe Qendrës së Zjarrfikëses. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Gjithashtu në fletët e inventarizimit në rubrikën e rezultati i inventarizimit janë bërë shënimet përkatëse në rastet e mungesave dhe tepricave, të cilat kanë rezultuar nga lëvizjet e aktiveve nga njëri objekt në tjetrin. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2022. Është mbajtur relacion përmbledhës për rezultatin e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve datë 05.01.2023. Nga komisioni i ngritur është bërë inventarizimi dhe vlerësimi i aktiveve ku janë mbajtur procesverbale për propozim për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve që kanë humbur funksionin e tyre, në të cilat janë dhënë dhe shpjegimet përkatëse.

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.21 datë 27.05.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr 394/1 prot, datë 01.06.2022 :”Mbi miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të identifikuara për vlerësim dhe të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit në Administrate, Njesitë Administrative, Strukturat dhe Institucionet Arsimore të Bashkisë Poliçan. Sipas këtij miratimi rezulton se janë nxjerrë jashtë përdorimi aktive, ku sipas klasifikimit të llogarive janë:

1. Llog 212 “ Ndërtime dhe konstruksione “ në vlerën 7,566 lekë.
2. Llog.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 40,000 lekë.
3. Llog. 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 2,038,085 lekë.
4. Llog.327 “Inventar i imët” në vlerën 1,297,344 lekë.
5. Llog.219 “Amm i AAGJ” në vlerën 1,638,668 lekë.

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.40 datë 21.10.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr 795/1 prot, datë 26.10.2022 :”Mbi miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të identifikuara për vlerësim dhe të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit në Administrate, Njesitë Administrative, Strukturat dhe Institucionet Arsimore të Bashkisë Poliçan. Sipas këtij miratimi rezulton se janë nxjerrë jashtë përdorimi aktive, ku sipas klasifikimit të llogarive janë:

1. Llog.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 1,146 lekë.
2. Llog. 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 204,217 lekë.
3. Llog.327 “Inventar i imët” në vlerën 203,374 lekë.
4. Llog.219 “Amm i AAGJ” në vlerën 132,225 lekë.

Për asgjësimin e materialeve të nxjerra është ngritur komisioni me Urdher nr 304, datë 10.11.2022 “ Per ngritjen e komisionit të asgjësimit të materialeve të nxjerra jashtë përdorimit nga komisioni i vlerësimit” prej 5 vetësh. Nga nxjerrja jashtë përdorimit aktivet me përmbajtje druri janë copëtuar dhe janë përdorur për dru zjarri. Sasia e aktiveve të kthyera në dru zjarri janë bërë hyrje në magazine me Fletë Hyrjen nr. 2 , datë 14.11.2022 : me masë 3 m3 (i cili është bërë hyrje në magazinë).

Janë hartuar relacionet mbi vlerësimin e inventarëve të Bashkisë Poliçan, si dhe janë firmosur nga Nëpunësi Autorizues. Janë hartuar procesverbalet e vlerësimit për materialet të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, si dhe këto procesverbale janë miratuar dhe janë me firmën e Titullarit të Bashkisë Poliçan.

Te përshkrimi i dhënë në relacionet e vlerësimit thuhet që materialet të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi janë të pa përdorshme, kanë humbur cilësitë e tyre të përdorimit në kushtet teknike si dhe nuk mund të riparohen për tu'a rikthyer vlerën, megjithëse nuk u ka kaluar afati vlefshmërisë. Komisioni në këto kushte ka vlerësuar se këto materiale duhet të nxirren jashtë përdorimit nëpërmjet asgjësimit fizik.

Nga auditimi i rregullshmërisë dhe saktësisë së procedurave dhe dokumentimit të procesit të inventarizimit të pasurisë së Bashkisë Poliçan u konstatua se:

- Në asnjë rast Nëpunësi Zbatues i njësisë nuk ka qenë kryetar i komisionit të vlerësimit të aktiveve, në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 99, *“Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se 3 persona të cilët janë menaxherë ose specialistë të financës si dhe specialistë të fushës përkatëse sipas natyrës së aktiveve që propozohen për dalje nga përdorimi. Kryetar i komisionit të vlerësimit është Nëpunësi Zbatues i Njësisë. Nëpunësi/punonjësi me përgjegjësi materiale të jetë i pranishëm gjatë procesit të vlerësimit, por jo në përbërje të komisionit”*;

- **Gjendja e llogarisë 219 “Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale”** paraqitet në bilanc në vlerën 668,147,971 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

“Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara” është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36. Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje te periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

-**Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet me vlerën prej 84,239,153 lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 47,039,153 lekë për të cilën nuk na u paraqit analizë.

Pasivet (Detyrimet)

Pasivi i Bilancit Kontabël 2022 Bashkia Poliçan

- Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Poliçan më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2020, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2020, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Tabela nr.3.14 Pasivet (Detyrimet)
lekë

në

65	B	PASIVET(DETYRIMET)	316,807,075	449,911,937
66		I.Pasivet Afat shkurtra	316,807,075	449,911,937
67		1. Llogari te Pagushme	316,807,075	449,911,937
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	93,899,952	155,942,450
69	42	Detyrime ndaj personelit	8,717,258	9,774,393
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	419,764	427,276
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		

75	435	Sigurime Shoqerore	2,599,258	2,369,033
76	436	Sigurime Shendetesore	404,662	377,710
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	28,054,019	20,335,191
82	467	Kreditore te ndryshem	94,217,974	260,685,884
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime)	88,494,189	
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0

Burimi: Bashkia Poliçan

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit ushtrimor 2022 është në vlerën 93,899,952 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Poliçan më 31.12.2022. Lëvizja e llogarise 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelën si me poshtë:

Tabela nr.3.15: Llogaria nr. 401-408

në lekë

Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to”	
Celje e vitit 2020	155,942,450
Shtesa (K)	285,901,215
Pakësime (D)	379,801,167
Gjendja në 31.12.2020 (K)	93,899,952

Burimi: Bashkia Poliçan

-Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën 93,899,952 lekë përbëhet nga fatura të palikuiduara për detyrime energjie, uji, postare, internet të muajit dhjetor, për mallra të paraqitura dhe analitikisht si më poshtë:

Tabela nr.3.16: Furnitori

në lekë

Nr	Furnitori	Gjendja 31.12.2022
1	O.s	1,253,765
2	Sha.U	530,907
3	T	17,902,865
4	A.T	23,597
5	K	-403
6	K.S	184,250
7	C.C	1,599,089
8	K.S.S	2,220,000
9	B	29,700
10	E.S	74,400
11	I	15,900
12	G.C	51,318,557
13	Sh	1,235,296
14	N.S	1,235,298
15	A.C	3,000
16	Sh.M	97,833
17	G,2	14,400,000
18	Ll	554,550
19	2.a	0
20	Bshpk	50,000
21	Zshpk	1,171,348
	Totali	93,899,952

Burimi: Bashkia Poliçan

- **Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”**, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Poliçan, paraqitet në vlerën 8,717,258 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të muajit Dhjetor.

- **Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2022 që paguhen në muajin janar 2023 dhe janë përkatsisht në vlerat 2,599,258 lekë dhe 404,662 lekë.
- **Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”,** nga pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2022 kjo llogari paraqitet në vlerën kontabël prej 28,054,019 lekë, nga vlera 20,335,191 lekë në vitin 2021, vlerë kjo e cila është e rakorduar me degën e thesarit, dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.

Tabela nr.3.17: Llogaria nr. 466

në lekë

	Kodi I Projektit	Emri i Projektit	Gjendje 31.12.2022	Viti krijimit I
a	c	d	5=3-4	h
1	0000000	???????	206,900	12-2014
2	0000000	???????	15,900	12-2014
3	0000000	???????	29,700	12-2014
4	1400001	???????	91,000	12-2015
5	1400002	Rikonstrukson i pjeses se brendshme te Bashkise	136,535	12-2016
6	1400009	Rik.Rrug.Lagj Çelaj-Lagjia. Zotkaj (Mekam) Teman	83,951	12-2016
7	1400011	Ndertimi Ures Bejlit Uji i Zi Vokopol	58,476	12-2016
8	1400012	Bregu i Bardhe Lagjia Çelaj Fshati Teman	86,381	12-2016
9	1400014	Kthesa Lamaj Lagjia Shehaj Fshati Çorogjaf	35,928	12-2016
10	1400017	Mirembajtje e rruges Teman - Mekam	57,089	12-2016
11	1400019	Riparime dhe mirembajtje rruges	62,830	12-2016
12	1400024	Blerje Materiale Ndertimi	650,085	12-2016
13	M132799	Shtrim betoni, zgare Mbrakull	6,000	12-2016
14	1400039	Rikonstrukcioni Unazes se Plirzes	212,200	12-2020
15	18BQ373	Linja e derg te Ujesjell Polican Pronovik Mbrakull	1,856,916	12-2020
16	18BQ373	Linja e derg te Ujesjell Polican Pronovik Mbrakull	569,055	12-2020
17	18BQ373	Linja e derg te Ujesjell Polican Pronovik Mbrakull	569,057	12-2020
		Totali	4,728,003	

Burimi: Bashkia Polican

Nga analiza e kësaj llogarie përbëhet nga 37 objekte nga të cilat për **17 objekte** në vlerën prej **4,728,003 lekë**, janë fonde që gjenden të ngurtësuar deri në vitin 2020, për të cilat është tejkualuar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhblllokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive. Drejtoria e Financës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të bërë zhblllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin 28/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10”; Ligji 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme, Kapitulli II, pikat nr.29, 30, 39 dhe 50, si dhe në kundërshtim me UKM nr.3, datë 15.02.2011 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kapitulli II, pika nr.10.

Titulli i gjetjes 15: *Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.*

Situata: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 28,054,019 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve në masën 5% të vlerës së kontratës për 37 objekte. Nga këto objekte për 17 prej tyre vlera e ngurtësuar e garancisë së punimeve është 4,728,003 lekë dhe afati i garancisë sipas kontratës, edhe pse ka përfunduar në vitin 2020, nga Bashkia Polican nuk janë marrë masa për xhirimin e fondeve te kontraktori, apo për verifikimin e investimit nëse ka patur problematika

gjatë periudhës së garancisë, me qëllim rakordimin dhe mbajtjen e vlerës që lidhet me problematikën e konstatuar.

Kriteri: Ligji 28/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10”; Ligji 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” seksioni “Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, UKM nr.3, datë 15.02.2011 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kapitulli II, pika nr.10.

Ndikimi: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2022 të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Poliçan të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, duke rakorduar çdo muaj vlerat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtori i Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare, zj.F.H

- **Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”**, paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën prej 94,217,974 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën prej 260,685,884 lekë, vlera që përfaqësojnë detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera dhe të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve.

Fondi i konsoliduar

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 1,112,679,689 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 1,008,585,025 lekë.

Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve në vlerën 1,429,486,764 lekë me pasivet në vlerën prej 316,807,075 lekë.

Tabela nr.3.18: Fondi i konsoliduar

në lekë

97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,112,679,689	1,008,585,025
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,096,430,337	990,847,683
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	16,249,352	17,737,342
101	111	Rezerva		

Burimi: Bashkia Poliçan

Formati nr.2 “Pasqyra e Performancës Financiare”

Paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022 si më poshtë:

Tabela nr.3.19: Pasqyra e Performancës Financiare
lekë

në

Nr.	Nr. Llogarie	Përshkrimi i operacioneve	Viti 2022	Viti 2021
a	b	c	1	2
1	A	TE ARDHURAT	537,956,880	292,806,866
2	70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	19,578,048	14,871,113
3	700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	91,995	176,002
4	7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
5	7001	Tatim mbi Fitimin		
6	7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	91,995	176,002
7	7009	Te tjera Tatime mbi te ardhurat		
8	702	2.Tatimi mbi Pasurine	13,015,056	9,984,383
9	7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	12,929,880	9,984,383
10	7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshme		
11	7029	Te tjera tatime mbi Pasurine	85,176	
12	703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	6,470,997	4,710,728
13	7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)		
14	7031	Akciza		
15	7032	Takse mbi sherbimet specifike		
16	7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		
17	7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	6,470,997	4,710,728
18	704	4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare	0	0
19	7040	Takse doganore per mallrat e importit		
20	7041	Takse doganore per mallrat e eksportit		
21	7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte		
22	7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombtare		
23	705	5.Takse e rruges		
24	708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare		
25	709	7.Gjoba e Kamat vonesa		
26	75	II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE	0	0
27	750	NGA TE PUNESUARIT		
28	751	NGA PUNEDHENESI		
29	752	NGA TE VETPUNESUARIT		
30	753	NGA FERMERET		
31	754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
32	755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE		
33	756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE		
34	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	14,253,210	11,799,169
35	710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	2,410,319	1,614,713
36	7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
37	7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
38	7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	2,410,319	1,614,713
39	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	11,842,891	10,184,456
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	10,956,140	9,695,075
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	474,310	383,376
42	7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	66,800	5,000
44	7114	Te ardhura nga biletat		
45	7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime	345,641	101,005
46	7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
47	719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		
48	76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE	0	0
49	760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
50	761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
51	765	Nga interesat e depozitave		
52	766	Nga kembimet valutore		
53	72	V.GRANTE KORENTE	504,125,622	266,136,584
54	720	1.Grant korent I Brendshem	504,125,622	266,136,584
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	214,372,217	97,125,540
56	7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	179,590,706	130,642,477
57	7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
58	7203	Nga Buxheti per mbulim deficitit(ISSH E ISKSH)		
59	7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	3,413,288	3,050,572

60	7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
61	7206	Financim I pritshe nga buxheti	106,040,893	34,429,395
62	7207	Sponsorizime te brendshme (nga te trete)	708,518	888,600
63	7209	Te tjera grante korente te brendshme		
64	721	2.Grant korent I Huaj	0	0
65		Nga Qeveri te Huaja		
66		Nga Organizata Nderkombetare		
67		VI.TE ARDHURA TE TJERA	0	0
68	781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
69	782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra		
70	783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata		
71	784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
72	787	Terheqje nga seksioni I investimeve		
73	73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE		
74	B	SHPENZIMET	521,707,528	275,069,524
75	600	IPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	118,154,107	110,478,707
76	6001	Paga, personel I perhershem	118,154,107	110,478,707
77	6002	Paga personel I Perkohshem		
78	6003	Shperblime		
79	6009	Shpenzime te tjera per personelin		
80	601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	20,743,689	19,562,771
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	18,655,483	17,571,349
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	2,088,206	1,991,422
83	602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	48,727,461	49,700,507
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera		
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	4,707,194	7,107,287
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	3,249,111	2,223,856
87	6022	Sherbime nga te trete	23,056,616	25,765,322
88	6023	Shpenzime transporti	7,034,615	6,391,280
89	6024	Shpenzime udhetimi	109,100	52,000
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	2,110,600	1,110,360
91	6026	Shpenzime per qeramarrje	475,159	523,650
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	796,567	337,317
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarjen per hua	10,123	11,000
94	6029	Shpenzime te tjera operative	7,178,376	6,178,435
95	603	IV.SUBVECIONE	0	0
96	6030	Subvecone per diference cmimi		
97	6031	Subvecone per te nxitur punesimin		
98	6032	Subvecone per te mbuluar humbjet		
99	6033	Subvecone per sipermarrjet individuale		
100	6039	Subvecone te tjera		
101		V.TRANSFERIME KORENTE	99,745,246	95,462,263
102	604	1.Transferime korente te brendshme	920	1,760
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	920	1,760
104	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
105	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetesore		
106	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
107	605	2.Transferime korente me jashte	0	0
108	6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare		
109	6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
110	6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurse te huaja		
111	6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
112	606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	99,744,326	95,460,503
113	6060	Transferita Te paguara nga ISSH e ISKSH		0
114	6061	Transferita Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	99,744,326	95,460,503
115		VI.SHPENZIME FINANCIARE	0	0
116	65	1.Shpenzime Financiare te brendshme	0	0
117	650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
118	651	Interesa per huamarje te tj. Brendshme		
119	652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
120	656	Shpenz.nga kembimet valutore		0
121	66	2.Shpenzime Financiare te jashtme	0	0
122	660	Interesa per huamarje nga Qeveri.te Huaja		

123	661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		
124	662	Interesa per huamarje te tjera jashtme		
125		VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	0	0
126	681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
127	682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
128	683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
129	686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		
130	63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	-3,324,305	-134,724
131		IX.SHPENZIME TE TJERA	237,661,330	
132	85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES (Rezultati i Veprimtarise se vititUshtrimor)	16,249,352	17,737,342

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket të ardhurave:

Llogaritë e financimit nga buxheti i shtetit për vitin 2022 (grant) paraqitet në shumën prej 504,125,622 lekë.

Të ardhurat e realizuara nga Bashkia Poliçan për vitin 2022 janë 537,956,880 lekë nga të cilat:

Të ardhurat tatimore në vlerën 19,578,048 lekë dhe të ardhurat jo tatimore në vlerën 14,253,210 lekë, sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit.

-Llogaria nr.7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël” pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 91,995 lekë e cila referuar dhe aktrakordimit me thesarin. Nga viti 2021 ky zë me një rënie prej 84,007 lekë nga viti 2021.

-Llogaria nr.7020 “Tatim mbi pasurinë e palujtshme” pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 12,929,880 lekë me një rritje prej 2,945,497 lekë nga viti 2021, sipas aktrakordimit me thesarin.

-Llogaria nr.7035 “Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie” paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 6,470,997 lekë, me një shtesë prej 1,760,269 lekë nga viti 2021.

-Llogaria nr.7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndermarrjet dhe pronesia” paraqitet në bilancin e vitit 2022 në vlerën 2,410,319 lekë, me një shtesë prej 795,606 lekë, sipas aktrakordimit me thesarin.

-Llogaria nr.7110 “Tarifa administrative dhe rregullatore” paraqitet në bilancin e vitit 2022 në vlerën 10,956,140 lekë, me një shtesë prej 1,261,065 lekë, sipas aktrakordimit me thesarin.

-Llogaria nr.7111 “Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh” paraqitet në bilancin e vitit 2022 në vlerën 474,310 lekë, me një shtesë prej 90,934 lekë, sipas aktrakordimit me thesarin.

-Llogaria nr.7113 “Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve” paraqitet në bilancin e vitit 2022 në vlerën 66,800 lekë, me një shtesë prej 61,800 lekë, sipas aktrakordimit me thesarin.

-Llogaria nr.7115 “Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime” paraqitet në bilancin e vitit 2022 në vlerën 345,641 lekë, me një shtesë prej 244,636 lekë, sipas aktrakordimit me thesarin.

Llogaritë e shpenzimeve të konstatuara sipas Pasqyrës së Performancës Financiare, sipas natyrës dhe klasifikimit të këtij formati rakordojnë me shumatat e rezultuar në llogaritë e shpenzimeve sipas klasifikimit buxhetor me akt rakordimet e thesarit.

Pesha specifike e shpenzimeve pasqyrohet si më poshtë: Shpenzimet për llogarinë nr.600 “Paga shpërblime të tjera personeli”, në vlerën 118,154,107 lekë janë rreth 23% të totalit të shpenzimeve, shpenzimet për llogarinë nr.601 “Kontribute të sigurime shoqërore dhe shëndetsore” në vlerën 20,743,689 lekë rreth 4% të totalit të shpenzimeve, shpenzimet për llogarinë nr.602 “Mallra dhe shërbimet të tjera” në vlerën 48,727,461 lekë rreth 9% e totalit,

shpenzimet në llog. (606) “Transferta për buxhete familjare e individë” në vlerën 99,744,326 lekë zënë 19% të totalit të shpenzimeve, në të cilën përfshihen transferta për ndihmën ekonomike dhe për invaliditetin.

Nga testi kontrollit për vitin 2022 në lidhje me veprimet me bankë:

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkuara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

1.Për sa më sipër nga grupi i auditimit është Akt konstatimi nr. 8, datë 20.11.2023 “*Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.*”.

“Mbi administrimin e aseteve inventarizimi dhe procedurën e dhënies me qira të aseteve të qëndrueshme në varësi të Bashkisë Poliçan”.

1.Hartimi i regjistrit kontabël të aseteve që ka në administrim Bashkia Poliçan.

Titulli i gjetjes 16: Mos kontabilizim i aseteve të Bashkisë Poliçan

Situata: Nga auditimi i kryer dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se në bashkinë Poliçan nuk kanë të hartuar regjistër kontabël të aseteve, veprime që bien në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, Regjistri i aktiveve të njësisë të sektorit publik ku citohet;

26. Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

27. Nëpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit. 28. Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë.

30. *Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.*

31. *Njësia publike e qeverisjes së përgjithshme duhet të mbajë një regjistër të veçante për secilën nga pronat e dhëna me qira, shoqëritë tregtare në të cilat shteti zotëron aksione dhe kontratat e koncesionit dhe enfitozës.*

Kriteri: UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26, pika 27, pika 30 dhe pika 31.

Ndikimi: I lartë

Shkaku: Titullari i Bashkisë Poliçan nuk ka ndërmarrë hapa konkret për të filluar procesin e përditësimit dhe inventarizimit të aseteve të bashkisë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Njësia zbatues e marrë masa për hartimin e regjistrit të aktiveve me të gjithë elementët e nevojshëm të tijë, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit për çdo aktiv të institucionit.

2. Inventari i pronave,

-Lista e pronave të paluajtshme të Bashkisë Poliçan, të transferuara me VKM nr. 207, datë 09.03.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Poliçan, të Qarkut Berat”. Lista me 31 (tridhjetë e një) fletë përfundon me numrin rendor 88 (tetëdhjetë e tetë),

Lista e pronave të paluajtshme të NJ/A Tërpan, të transferuara me VKM nr. 735, datë 01.09.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Komunës Tërpan, të Qarkut Berat”. Lista me 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë përfundon me numrin rendor 798 (shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë),

Lista e pronave të paluajtshme të NJ/A Vërtop, të transferuara me VKM nr. 916, datë 29.12.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të Komunës Vërtop, të Qarkut Berat”. Lista me 346 (treqind e dyzet e gjashtë) fletë përfundon me numrin rendor 2640 dymijë e gjashtëqind e dyzet), të klasifikuara në kategori sikurse janë:

Në përdorim

- Prona të lira dhe hapësira të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji;

Në pronësi,

-Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile,

-Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social,

-Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive,

-Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik,

-Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik,

-Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e programeve arsimore,

-Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike),

-Shërbime funerale,

-Prona që përdoren në fushën e bujqësisë (toka bujqësore joproductive dhe kanale të treta).

-Lista e pyjeve dhe kullotave të transferuara me VKM-në nr. 417, datë 08.04.2008 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike. Lista me 6 (gjashtë) fletë përfundon me numrin rendor 224 (dyqind e njëzet e katër).

Titulli i gjetjes 17: *Mos inventarizim i plotë dhe mos përditësim i pronave të paluajtshme në Bashkinë Poliçan.*

Situata: Nga Bashkia Poliçan gjatë vitit 2022 nuk janë ngritur grupe pune për të bashkëpunuar me DVASHK Berat, në lidhje me regjistrimin e pronave sipas listës së aseteve të miratuara me VKM, për Bashkinë dhe Nj/Administrative.

Gjithashtu, lidhur me listat e pronave të paluajtshme në njësitë administrative nuk janë marrë masa për verifikimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuar dhe dokumentacionit hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentet e pronësisë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” datë 05.03.2020, Neni 37 “Përditësimi nga institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore 1. Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. 2. Procedura e përditësimit mbështetet në: a) verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së; b) verifikimin e gjendjes juridike të pronës. Institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligj. 3. Në përfundim të këtyre verifikimeve, institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i paraqet për shqyrtim ASHK-së listën e pronave shtetërore të përditësuar, pjesë e detyrueshme e së cilës është dokumentacioni hartografik”.

Në zbatim të ligjit nr.8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore” si dhe në mbështetje të Pikave 9, 10, 11 dhe 22 të VKM nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, nuk janë ngritur grupet e punës, kjo e përcaktuar në misionin dhe detyrat e NJQV, administrimi i aseteve, si dhe struktura e ngarkuar për ndjekjen e tyre. Nga auditimi, sipas dokumentacionit që na u vu në dispozicion dhe deklarimeve verbale të punonjësve, u konstatua se: *Bashkia Poliçan nuk ka një regjistër kontabël në nivel bashkie për të gjitha asetet që ajo zotëron.*

Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Poliçan dhe Njësi Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë inventarizuar totalisht si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se; me ndarjen e re territoriale Bashkisë Poliçan i janë shtuar 2 njësi Administrative.

-Njësia/A Vërtop

-Njësia/A Tërpan

Nga auditimi rezultoi se nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.), dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.139/2015, “Për

vetëqeverisjen vendore”, neni 27,28, funksionet e bashkisë në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor. Kjo strukturë duhet të realizonte **marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV**, vënien në evidence të ndërtesave me sipërfaqe dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive të përcaktuara në listat e inventarëve, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira.

Përmbledhëse e pronave sipas listës së inventarit si dhe VKM-ve, përkatëse të njëjësive administrative dhe Bashkisë Poliçan

Tabela Nr.3.20: Numri i pronave të Bashkisë Poliçan dhe i njëjësive administrative pranë kësaj bashkie

Nr.	Bashkia/ Njesite	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara	Nr. Praktikave të Certifikuara 2022	Prona të Rregjistruara
1	Poliçan	88	21		67
2	Vertop	2325			2325
3	Terpan	1046	7		1039
	Total	3459	28		3431

Burimi: Bashkia Poliçan

Siç shihet nga tabela e mësipërme, bashkia Poliçan ka 3459 prona në inventar, nga të cilat vetëm 28 të certifikuar dhe 343 prona të certifikuar ose rreth 99% të totalit. Nga informacioni i marë gjatë auditimit rezulton se ka nisur procedura për regjistrimin e 32 pronave pranë DVASHK Berat, të cilat rezultojnë në proces regjistrimi, të detajuara si më poshtë:

Tabela Nr.3.21: Numri i pronave të Bashkisë Poliçan në proces regjistrimi

Nr	Emërtimi i Pasurisë	Zona kadastrale	Nr Pasurise	Indeksi i hartës	Nr. Rregj.	Sipërfaqe sipas V.K.M.(m ²)	Data e aplikimit Nr. Dt.	Vertetim ose certifikate Hipoteke	Sipërfaqja sipas Faktit (m ²)
1	Ndertesese	3019	12/320	PO-E-04	6	450	23.07.2013	Certifikate	
2	//	3019	12/110	//	7	28	//	//	
3	//	//	12/111-N-5	//	8	38	//	//	
4	Pyll (Gesjtenj)	//	112a	35-B	9	135,000	23.06.2010	Vertetim	
5	Pyll, pish e ege	//	112d	35-B,36-A	10	26,000	23.06.2010	Vertetim	
6	Rruge	//	12/204	PO-E-04	20	700	28.06.2016	Çertifikate	
7	Shesh	//	12/194	//	21	2,321	28.06.2016	//	
8	//	//	12/186	//	22	1,325	//	//	
9.	rruge	//	12/180	//	23	280	//	//	
10.	Shesh	//	12/115	//	24	1,112	//	//	
11.	//	//	12/96	//	25	4,678	//	//	
12.	//	//	12/181	//	26	3,918	//	//	
13.	Rruge	//	12/95	//	27	98	//	//	
14.	Xhade	//	12/65	PO-D-04	28	518	//	//	
15.	Shesh	//	12/35	//	29	3,185	//	//	
16.	//	//	12/17	PO-E-04	30	1,170	//	//	
17.	Xhade	//	12/114	//	31	1,740	//	//	
18.	Shesh	//	12/319	PO-D-04	32	4,318	//	//	
19.	Shesh	//	12/135	PO-E-04	33	768	02.2017	//	
20.	Truall+ndertes	//	15/4	PO- 35-D	34	12,400	23.07.2018		
21.	//	//	15/5	//	35	87,600	//	//	
22.	//	//	13/77	PO-F-05	36	3,110	31.09.2019	//	
23.	//	//	13/102	PO-E-05	37	700	4.5.2023		
24.	Are	2632	346	19-D, 35-B	38	101,070	12.04.2019	//	101,070
25.	//	//	356		39	121,353	//	//	121,353

26.	Kullote	3584	974	65-D, 81-B	40	866,342	20.06.2023	//	866,342
27.	//	//	958	65-B	41	1,011,091	//	//	1,011,091
28.	//	//	957	65-B	42	417,082	//	//	417,082
29.	//	3572	1890	65-B	43	658,003	//	//	658,003
30.	//	//	1889	49-D	44	2,168,039	//	//	2,168,039
31.	//	//	1888	49-D	45	222,668	//	//	222,668
32.	//	3619	1378	66-C	46	1,466,414	//	//	1,466,414

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga drejtoria e financës, në lidhje me trojet, ndërtesat dhe sheshet publike, nuk kemi raste të zaptimit të trojeve në administrim të Bashkisë Poliçan.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga strukturat e bashkisë Poliçan rezulton se; në strukturën aktuale organizative të bashkisë Poliçan nuk ka drejtori të Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, detyrat e të cilës i kryen drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave. Kjo strukturë duhet të realizonte **marrjen në dorëzim të asetëve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV**, vënien në evidence të ndërtesave me sipërfaqe dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive të përcaktuara në listat e inventarëve, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira.

Përsa i përket këtyre pronave nga bashkia Poliçan pretendohet se problematikat e mos regjistrimit janë të natyrave të ndryshme. Pjesa më e madhe e këtyre praktikave janë të pa trajtuara nga ana e DVASHK Berat, mungesë të ardhurash për të bërë aplikim në kadastër.

-Rezulton se bashkia Poliçan nuk ka kryer veprimet, Ligjit nr.10296 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim dhe regjistrimin për një numër të madh të pronave sipas tabelës së mësipërme, çka bën të paqartë numrin e tyre sipas listave të inventarëve. Përsa i përket verifikimit në terren nëse këto prona janë të lira apo të zaptuara ose dhe të tjetërsuara nga palë të treta, nuk janë kryer verifikime.

Për periudhën e audituar nga informacionet e mara nga subjekti nuk rezulton të këtë shitje të asetëve.

Kriteri: Ligji 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” datë 05.03.2020, neni 37.

Ligji nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 27, 28.

Ndikimi: I lartë

Shkaku: Titullari i Bashkisë Poliçan nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të filluar procesin e përditësimit dhe inventarizimit të asetëve të bashkisë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë masat për hartimin e rregjistrimit kontabël të pronave që administron Bashkisë Poliçan dhe që janë transferuar me VKM të posaxme në këtë njësi vendore. Bazuar në rregjistrimin kontabël, të bëhet inventarizimi i pronave në teren. Nëpërmjet këtij procesi të evidentohet statusi faktik i pronave në teren, si ekzistenca fizike e pronës, përputhja në fakt e elentëve të pronës në teren, si sipërfaqja e pronës etj., me elementët që pasyron gjendja kontabël.

Rekomandim: Për të gjitha pronat të cilat i përkasin inventarit përfundimtar të Bashkisë Poliçan, të merren masa për regjistrimin e tyre në ASHK. Sektori i Financës të përllogarisë në buxhet kostot e nevojshme për kryerjen e rregjistrimeve të nevojshme, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

3. Administrimi i sipërfaqeve kullimore dhe inventarizimi Pyje/kullota

Referuar listës së pyjeve dhe kullotave të transferuara me VKM-në nr. 417, datë 08.04.2008 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike. Lista me 6 (gjashtë) fletë përfundon me numrin rendor 224 (dyqind e njëzet e katër).

Këto kullota administrohen nga strukturat e Bashkisë Poliçan dhe sipërfaqe të caktuara të tyre jepen me qira në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi si, Ligji Nr.9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullor”, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 2 datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”.

-Nga auditimi rezulton se, bashkia Poliçan që nga transferimi i këtyre sipërfaqeve me VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016, nuk është pajisur me certifikatë pronësie për sipërfaqet pyjore, kullimore dhe shkëmbore që administrohen.

-Nga auditimi rezultoi se bashkia Poliçan gjatë vitit 2022 **nuk ka të certifikuar asnjë sipërfaqe pyjore dhe kullimore.**

Tokat e lira bujqësore

Referuar të dhënave që administrohen Bashkia Poliçan rezulton se kjo Bashki ka gjithsej 7,678 ha tokë bujqësore, nga të cilat 4,636 ha është marrë nga banorët me ligjin 7501 dhe 3,024 ha është tokë e pa ndarë në pronësi të bashkisë.

Tabela nr.3.22 Sipërfaqja e tokës bujqësore në Bashkinë Poliçan,

Nr.	Njësia Administrative	Tokë gjithsej	Tokë e marrë me AMTP (ha)	Sipërfaqe e pandarë në pronësi të bashkisë (ha)
1	NjA Vertop	3,265	2,127	1,138
2	NjA . Terpan	4,046	2,376	1,670
3.	Nj.A.poliçan	367	133	234
Shuma		7,678	4,636	3,042

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2022 ka lidhur Bashkia Poliçan nuk ka lidhur asnjë kontratë për dhënie me qira të tokës bujqësore për mbjellje me ullinj apo arrorë, veprimtari turizmi, përpunim uji të pijshëm, depozitim materialeve etj.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Z. A.Z, me detyrë Kryetar i Bashkisë Poliçan;

Z. F.A, me detyrë Drejtor i Planifikimit të Territorit, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Administrimit të Pyjeve

Znj. B.K, me detyrë përgjegjës i sektorit të menaxhimit financiar dhe asetëve

Pika nr.4. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.

Për periudhën 01/01/2022 – 31/12/2022, Bashkia Poliçan ka kryer gjithsej 3 procedura prokurimi me vlerë të lartë, me vlerë të fondit limit **51,232,007** lekë pa tvsh dhe vlerë kontrate të lidhur prej **51,027,637** lekë pa tvsh, me një vlerë ulje nga fondi limit prej **204,370** lekë pa tvsh.

Kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit gjithsej 4 (katër) OE dhe BOE, nga të cilët ka 1(një) BOE të skualifikuar.

-Blerje me vlerë të vogël”, 56 procedura, me fondin limit në total prej 15,183,595 lekë pa tvsh, vlerë të lidhjes së kontratës 13,722,713 lekë pa tvsh, diferencë midis tyre në vlerën 1,460,882 lekë pa tvsh

Titulli i gjetjes 18: Grupi i auditimit të KLSH, konstatoi se në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2022- 31.12.2022, janë konstatuar kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE/BOE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga AK-ja.

Situata: Nga auditimi i **3** procedurave me vlerë kontrate **51,027,637** mijë lekë, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **3** procedura, nga të cilat: në **2** procedurakriteret nuk janë në përputhje me llojin e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në mospjesëmarrjen e OE në procedura, në **2** procedura OE/BOE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DT të miratuara nga AK, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 4, 36, 92, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”: Neni 4, “Përkufizime”; Neni 36, “Specifikimet teknike”, Neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik: Neni 78, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, Neni 88, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”.

Shkaku: Mos vlerësimi i drejtë i kriterëve dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe aplikimi i kriterëve të rënduara të cilat çojnë direkt ose indirekt në mospjesëmarrjen e OE.

Ndikimi: Aplikimi i kriterëve jo në mënyrë të argumentuar dhe në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE/BOE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DT, janë veprime në kundërshtim me LPP dhe VKM përkatëse, për të cilat ngarkohen me përgjegjësi; anëtarët e NJHDT dhe KVO, sipas procedurave ku ato janë pjesëmarrës, ku rast pas rasti do trajtohen më poshtë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Poliçan, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e NJHDT dhe KVO, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës dhe të trajnuar, të cilët në hartimin e kriterëve të aplikojnë kritere të cilat i përshtaten procedurës së zhvilluar, ndërsa në shpalljen fitues të OE të vlerësohen me korrektesë kriteret e DT të miratuara nga AK.

Procedurat e prokurimit me vlera të larta, të periudhës 01.01.2022 – 31.12.2022 Bashkia Poliçan

Nr	Objekte të prokuruar	Operatori Fitues	Fondi Limit Në Lekë	Vlera Fituese Në Lekë
1	Riparimi i rrugëve të fshatrave Peshtan, Drenovë , Lybesh, Tomor i Madh, Tomor i Vogël"	B	2,473,000 lekë	2,457,696 lekë
2	Shpenzime për rikonstruksionin e Shkollës "Muhamet Kondi" Poliçan	Z	45,125,675 lekë	44,936,609 lekë
3	Shpenzime për blerje karburant dhe vaj për mjetet e bashkisë, karburant për mjetet e Mzsh-së dhe kaldajën e shkollës Refat Keli	K	3,633,332 lekë	3,633,332 lekë

	Totali		51,232,007 lekë	51,027,637 lekë
--	---------------	--	------------------------	------------------------

Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve buxhetore.

Për periudhën 01/01/2022 – 31/12/2022, nga Bashkia Poliçan referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej 3 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 66,454,078 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 64,750,350.66 lekë, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 1,703,727.34 lekë ose 2.6 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01/01/2022 - 31/12/2022	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
-Të hapura	3	51,232,007	51,027,637
<i>Sipas objekteve</i>			
-Objekte në fushën e investimeve	2	47,598,675	47,394,305
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	1	3,633,332	3,633,332

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **4** OE/BOE, nga të cilët ka një BOE të skualifikuar. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **2** dhe **1** procedurë është me 2 (dy) BOE. Rezulton se; 67 % e procedurave të zhvilluara me prokurim të hapur janë kryer pa konkurrencë, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuar nga AK Bashkia Poliçan kanë ndikuar direkt ose indirekt në uljen e numrit të pjesëmarrësve në procedura.

- Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit nga 3 procedura prokurimi me vlerë të lartë të zhvilluara me vlerë kontrate 51,027 mijë lekë, vlerësoj për auditimin e 3 procedurave me vlerë të lartë me vlerë kontrate 51,027 mijë lekë ose 100% e vlerës së kontratave të lidhura.

- Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit përzgjedhi 2 procedura prokurimi me vlerë të vogël të zhvilluara me vlerë kontrate 1,208 mijë lekë.

- Nga auditimi i 3 procedurave me vlerë të lartë kontratë prej 51,027 mijë lekë, u konstatua se janë në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, gjithsej 2 procedura me vlerë kontratë 47,394 mijë lekë ose 100 % e vlerës së kontratave të audituara, ku në 2 raste kriteret e aplikuar nga AK nuk janë të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese dhe natyrën e kontratës referuar nenit 87, të LPP 162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura. Në 2 raste OE/BOE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DT të miratuara nga AK Bashkia Poliçan, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, veprime në kundërshtim me nenet 4, 36, 92, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 78, 88, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT dhe KVO sipas procedurave, si më poshtë vijon:**

1. Tenderi me objekt: “Riparimi i rrugëve të fshatrave Peshtan, Drenovë, Lybesh, Tomor i Madh, Tomor i Vogël” VITI 2022, me këto të dhëna:

1.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: **“Riparimi i rrugëve të fshatrave Peshtan, Drenovë, Lybesh, Tomor i Madh, Tomor i Vogël” VITI 2022**

1. Urdhër Prokurimi: Nr.57 Nr.2236 Prot Datë, 12.09.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. F.A 2. S.S 3. K.R	3. Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr.243, datë 12.09.2022 1.O.N(Kryetar) 2.G.F(Anëtar) 3.Xh.M (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E Hapur		
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 2,473,000 lekë pa TVSH	6.Oferta fituese: B 2,457,696 lekë, me lidhje kontrate 06.12.2022 me afat 1 muaj.	7. Diferenca me fondin limit: 15,304 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 18.11.2022	9.Burimi Financimit: Nga buxheti i bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar Nuk ka, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes 19: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve.

Situata: Në lidhje me kriteret e vendosura në procedurën e tenderit me objekt: “Riparimi i rrugëve të fshatrave Peshtan, Drenovë, Lybesh, Tomor i Madh, Tomor i Vogël”, u konstatuan kriteret të ekzagjeruara.

Kërkesa e pikës 2.3.5 e DT e cila kërkon nga OE të ketë pjesë të stafit 1 mjek të përgjithshëm ose të ketë kontraktuar nga jashtë këtë shërbim, është kërkesë jo në përputhje me rregullat e prokurimit publik. Kjo kërkesë është e pa argumentuar teknikisht dhe ligjërisht. Autoriteti kontraktor nuk ka të drejtë të hartojë kriteret e cilat nuk lidhen ngushtë me natyrën e kontratës që do të zbatohet, sipas preventivit dhe projektit të hartuar për këtë qëllim.

Në preventiv nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete, për zbatimin e së cilës do të ishte e nevojshme mjeku.

Kjo kërkesë mund të jetë kusht përjashtues për OE e tjerë.

Kriteri: Neni 77 i ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 dhe nenin 39 të pika 4 të VKM 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJP: z. F.A, znj. S.S dhe znj. K.R.

Ndikimi: Paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, veprime në kundërshtim me LPP 162/2020 dhe VKM 285/2021.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Autoriteti Kontraktor të marrë masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, të mos vendosë kriteret që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokurimit publik.

- 1. Tenderi me objekt: Rikonstrukcion i shkollës së mesme “Muhamet Kondi” në qytetin Poliçan, me këto të dhëna:**

2.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i shkollës së mesme “Muhamet Kondi” Poliçan Viti 2022		
1.Urdhër Prokurimi Nr.48,Prot.2064/1, datë22.08.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. S.S 2. L.Xh 3. A.C	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.227, datë 22.08.2022 1.O.D (Kryetar) 2.D.Z (Anëtar) 3.A.S (Anëtar) 4.K.R (Anëtar) 5.F.H (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e hapur	4. O.N 5. F.A	
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 45,125,675 lekë	6.Oferta fituese B "Z "Shpk dhe "B.N " shpk 44,936,609 lekë	7.Diferenca me fondin limit 189,066 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 22.08.2022	9.Burimi Financimit: Buxheti i shtetit shkresa Nr.12451/2 prot. datë 12.7.2022 shkresa e MAS nr.4254/1 prot. datë 23.06.2022 dhe 15% nga Bashkia sipas VKB nr.27 datë 20.7.2022 ligjëruar nga prefekti i Beratit me shkresën nr.561/1 prot. datë 01.8.2022	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 BOE b) Skualifikuar 1 BOE, c) Kualifikuar 1 BOE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes 19: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: Në lidhje me kriteret e vendosura në tenderin me objekt: Rikonstruksion i shkollës së mesme “Muhamet Kondi” në qytetin Poliçan, referuar pikës 4 të nenit 39 të VKM 285, thuhet: Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

1. Kërkesa e pikës **2.3.10 e DT**, e cila kërkon ndër të tjera që OE të disponojë ose të marrë me qira 2 kamioncina 3-5 ton dhe 1 kamioncinë 1-3 ton. Referuar grafikut dhe volumit të punimeve nuk duket të jetë e domosdoshme një kamioncinë 1-3-ton duke pasur parasysh që nevojat specifike mund të kryhen me 2 të tjerat. Bazuar në LPP Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 36, pika 2.

2. Është kërkuar që OE të ketë pjesë të stafit 1 mjek të përgjithshëm, e vërtetuar kjo me listë pagesat e paraqitura nga operatori ekonomik. Kontratë pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, licensë ushtrimi profesioni si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për tre muajt e fundit. Kjo kërkesë është e pa argumentuar teknikisht dhe ligjërish. Autoriteti kontraktor nuk ka të drejtë të hartojë kriteret të cilat nuk lidhen ngushtë me natyrën e kontratës që do të zbatohet, sipas preventivit dhe projektit të hartuar për këtë qëllim. Në preventiv nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete, për zbatimin e së cilës do të ishte e nevojshme mjeku.

Kriteri: Neni 77 i ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 dhe nenin 39 të pika 4 të VKM 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJP: znj. S.S, znj. L.Xh, znj. A.C, znj. O.N. z. F.A, si dhe anëtarët e KVO: z. O.D, znj. D.Z, z. A.S, znj. K.R, znj. F.H.

Ndikimi: Paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, veprime në kundërshtim me LPP 162/2020 dhe VKM 285/2021.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Autoriteti Kontraktor Bashkia Polican, të marrë masa që kriteret e veçanta të dokumenteve të tenderit lidhur me kapacitetin teknik, të hartohen të argumentuara teknikisht dhe në përputhje me vlerën e kontratës, volumin e punimeve sipas zërave përkatës të preventivit, grafikun e punimeve dhe kohëzgjatjen e kontratës.

Vlerësimi i ofertave: Në këtë procedurë kanë marrë pjesë dy BOE, konkretisht BOE “I & I” me ofertë **40,286,550** lekë (pa tvsh), BOE “Z.B shpk” me ofertë **44,936,609** lekë (pa tvsh). Në këtë procedurë është shpallur fitues BOE “Z” shpk & “b N” shpk. BOE “I & I” është skualifikuar për arsyet: **1.**Gabim aritmetik në përlllogaritjen e vlerës së tvsh-së të ofertës ekonomike të paraqitur, mungesë e vlerës totale e preventivave të sistemeve në zërin 8. **2.** Fillimi i kontratës së qerasë të mjeteve në shtojcën 8 pas datës së zhvillimit të procedurës së tenderit. **3.** Në tabelën e shtojcës 8 pika C të formularit të vetdeklarimit, nuk ka deklaruar sasi në faturë, për pompë suvatimi dhe gjenerator.

Janë mbajtur Procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave me Nr.2064/11 prot., datë 22.09.2022, si dhe raporti përmbledhës me nr. 2064/19 prot., datë 20.10.2022, në përputhje me LLP nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me vendimin nr. 64/11 prot., datë 04.03.2020 të titullarit, është shpallur fitues BOE “Z” shpk & “Bajrami N” shpk.

A. Nga shqyrtimi i ofertës fituese, u konstatua se BOE nuk përmbush të gjitha kriteret dhe konkretisht:

1. OE “Z” shpk, nuk përmbush kriteret e pikës **2.3.10 të DT** për mjetet dhe pajisjet. Ky OE ka marrë përsipër sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit datë 21.09.2022 kryerjen e punimeve në masën 95% dhe 5% të punimeve do të kryhen nga OE “B. N”, dhe në këto kushte duhet të përmbushte disponimin e kategorisë së caktuar për kryerjen e punimeve. Referuar dokumenteve të dorëzuara nga OE “B. N” ka ofruar 10 mjete për këtë procedurë,

2. Certifikata ISO 50001:2011 për “Sistemin e Menaxhimit të Energjisë” e OE “Z” rezulton e skaduar në datën 31.01.2022.

3. OE “Z” ka marrë me qira 7 kamiona nga kompania “D. K.” për një periudhë 5 vjeçare. Në pikën 1 të kontratës së qirasë, tek detyrimet e qiradhënësit thuhet se këto kamiona do të përdoren **brenda bashkisë Lushnje**, dmth OE “Z” nuk mund ti përdorë ato në zbatimin e procedurës së fituar në bashkinë Poliçan.

3. Tenderi me objekt: “Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Poliçan” Viti 2022, me këto të dhëna:

3.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shpenzime për blerje karburanti dhe vaji për mjetet e Bashkisë Poliçan, mjete e MZSH-së dhe kaldajën e shkollës Refat Keli”, Viti 2022		
1.Urdhër Prokurimi: NR.20 NR.718 PROT Datë, 10.03.20222	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1-S.S 2-A.S 3-K.R	3. Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr.76, nr 806 prot, datë 16.03.2022 1.O.N(Kryetar)

4.Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e hapur		2 M.K(Anëtar) 3.Xh.M(Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh): 3,633,332 lekë	6.Oferta fituese: K Shpk me vlere fituese 3,633,332 lekë, marzh fitimi 18% pa tvsh, me lidhje kontrate datë 04.05.2022	7.Diferenca me fondin limit 0 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit : 05.04.2022	9.Burimi Financimit: nga buxheti i bashkisë granti + të ardhurat 80% dhe buxheti i shtetit 20%	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender: 1-K Shpk
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes 21: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, për vlerësimin e ofertave.

Situata: Nga auditimi u konstatua se gjate procedurës së Prokurimit me objekt: “Shpenzime për blerje karburanti dhe vaji për mjetet e Bashkisë Poliçan, mjete e MZSH-së dhe kaldajën e shkollës Refat Keli”, janë mbajtur Procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave me nr. 718/6 prot., datë 08.04.2022, si dhe raporti përmbledhës me nr. 718/8 prot., datë 20.04.2022, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me Vendimin nr.1, nr.718/9 prot., datë 20.04.2022 të titullarit, është shpallur fitues OE “**K**” shpk.

A. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të OE “**K**” shpk të kualifikuar dhe shpallur fitues, rezulton se **nuk** i përmbush të gjitha kriteret e vendosura në **DT** në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

1. Në certifikatën e testimit mungon informacioni për “**Mbetjen e Karbonit**”. Ky informacion është kërkuar nga Njësia e Prokurimit.

Kriteri: Neni 77 i ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 dhe nenin 39 të pika 4 të VKM 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO: znj. O.N, znj. M.K, znj. Xh.M.

Ndikimi: Parregullësi në procesin e kualifikimit të OE dhe shpalljen e fituesit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: AK të marrë masqë kualifikimi i OE të bëhet vetëm në kushtet kur ata plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në dokumente e tenderit.

Blerjet me vlere të vogla

1. Tenderi me objekt: “Shërbime riparimi makinash, shërbime riparimi për kamionë të Bashkisë Poliçan”, Viti 2022

4.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbime riparimi makinash, shërbime riparimi për kamionë të Bashkisë Poliçan”, Viti 2022		
1.Urdhër Prokurimi NR.55 datë 12.09.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. S.S Xh.M 2. 3. K.R	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: 1. S.S (Kryetar) 2. Xh.M (Anëtar) 3. K.R (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E thjeshtuar		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 833,333 lekë	6.Oferta fituese "G.S" në vlerën 790,000 lekë,	7.Diferenca me fondin limit 43,333 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 13.09.2022	9.Burimi Financimit: Nga buxheti i bashkisë 2022, në zbatim të VKB nr.33, datë 26.08.2022	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 12 OE b) Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 9 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes 22: *Specifikimet teknike të materialeve që do të prokurohen nuk janë hartuar në përputhje me LPP.*

Situata: Nga auditimi u konstatua se gjatë procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbime riparimi makinash, shërbime riparimi për kamionë të Bashkisë Poliçan”, në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuan kriteret të pranueshme por, specifikimet teknike të materialeve që do të prokurohen nuk janë hartuar në përputhje me nenin 4, pika 38, b), “Në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrimi i të gjitha kushteve, kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” të LPP 162/2020.

Kriteri: Neni 36 për specifikimet teknike i LPP 162/2020, i ndryshuar.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në lidhje me specifikimet teknike të materialeve, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJP për blerjet e vogla: znj. S.S, znj. K.R, znj. Xh.M.

Ndikimi: Mos hartimi i saktë i specifikimeve teknike sjell si pasojë mos realizimin e plotë të qëllimit të procedurës së prokurimit dhe mungesë efëcence në përdorimin e fondeve publike.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Njësia e Prokurimit për blerjet e vogla duhet të veprojë në përputhje me LPP duke hartuar specifikime teknike të materialeve që do të prokurohen.

2. Tenderi me objekt: “Shpenzime për blerje uniformash për sektorin e MZSH-së të Bashkisë Poliçan”, Viti 2022

5.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shpenzime për blerje uniformash për sektorin e MZSH-së të Bashkisë Poliçan”, Viti 2022		
1.Urdhër Prokurimi NR.42 datë 04.08.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1.S.S 2.	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: 1. S.S (Kryetar)

4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E thjeshtuar	Xh.M 3. K.R	2. Xh.M (Anëtar) 3. K.R (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 375,000 lekë	6.Oferta fituese "B. S." në vlerën 344,000 lekë,	7.Diferenca me fondin limit 31,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 15.08.2022	9.Burimi Financimit: Nga buxheti i bashkisë 2022	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 12 OE b) Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 9 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

-Procedura e mësipërme rezulton në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. F.A me detyrë Drejtor i Planifikimit të Territorit, Bujqësisë dhe Pyjeve, znj. L.Xh me detyrë ish-Sekretare e Përgjithshme e bashkisë Poliçan, znj. A.C me detyrë Drejtoreshë e Tatim-Taksave, znj. S.S me detyrë ish-N/Kryetare e bashkisë Poliçan, znj. O.N me detyrë Inxhinierë Mjedisi, znj. K.R me detyrë Specialiste Sektori i Shërbimit Social, z. O.D me detyrë ish-N/Kryetar i bashkisë Poliçan, znj. F.H me detyrë Specialiste Finance, z. A.S me detyrë Specialist i Transportit dhe Emergjencave Civile, znj. Xh.M me detyrë Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore, znj. D.Z me detyrë Drejtoreshë Juridike.

Pika nr.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Zyra e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Poliçan ka ushtruar funksionet dhe detyrat e saj bazuar në ligjin Nr.107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar si dhe V.K.M.-së Nr.408, Datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar me V.K.M.-në Nr.271 Datë 06.04.2016 "Për një ndryshim në V.K.M.-në Nr. 408 Datë 13.05.2015".

Nga auditimi u konstatua se, gjatë viteve 2021-2022 në Bashkinë Poliçan nuk janë miratuar Leje Ndërtimi për subjekte private në pronë shtetërore. Të gjitha Lejet e miratuara kanë qënë në truall privat të personave apo subjekteve që kanë aplikuar dhe janë pajisur me leje ndërtimi.

Aplikimi për lloj leje "Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m²" , me nr. regjistri/protokolli 1528 prot., për objektin "Godinë banimi 1 kat", Fush-Peshtan, Bashkia Poliçan.

Dokumente të aplikimit për leje.

Për aplikimin me numër AN150620220040, **protokolluar me nr. 1528, datë 15.06.2022** "Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m²", dorëzuar elektronikisht nga aplikanti D.T dhe projektuesi shoqëria "A.M" shpk me NUIS L.....Q për objektin "Godinë banimi 2 kat", Fushë-Peshtan, Bashkia Poliçan **me zhvillues A.A**

Për sa i përket procedurës së kryer për zbardhjen e lejes ndërtimit me dokumentacionit përkatës: Lista e dokumenteve të ngarkuara elektronikisht:

- certifikatë pronësie.pdf;
- projekti arkitektonik.pdf ; relacion arkitektonik.pdf

- projekti konstruktiv.pdf ; relacion konstruktiv.pdf;
- projekti elektrik.pdf ; relacion elektrik.pdf
- projekti i mbrojtjes nga zjarri;
- preventivi.pdf
- planvendosja.pdf; - deklaratë përgjegjësie - topografi.pdf
- licencat firme dhe individuale.pdf ;
- siguracioni geoprosjekt.pdf ; - planvendosja-model.pdf;
- grafiku i punimeve.pdf
- leje zhvillimi_ ppv.... (1).pdf
- projekti mkz.pdf; - relacion mkz.pdf; - deklarata eksperti zjarrfikës.pdf;
- deklarata arkitekti.pdf; deklarata eksperti zjarrfikës.pdf; deklarata inxh. elektrik.pdf;
- licence projektimi "A.M" 4.pdf; licenca e mk zjarrit_.pdf
- licensa_inxh_elektrik_.pdf; licensa_inxh_konstruktor_.pdf, Licencë_arkitekt_.pdf;
- qkl_mkz.pdf; polica e sigurimit A.M shpk, datë 22.05.2022 deri 22.05.2023.pdf

Mbi Lejen e zhvillimit

- Në aplikimin me numër AN170520220037, **protokolluar me nr. 1294, datë 17.05.2022** "Leje zhvillimi", dorëzuar elektronikisht nga aplikanti dhe projektuesi shoqëria "A.M" shpk me NUIS L.....Q është miratuar leje zhvillimi me nr. 2724, datë 08.11.2022. Leja e zhvillimit për objektin: për objektin "Godinë banimi", me adresë Fushë-Peshtan, Bashkia Poliçan dhe zhvillues **A.A**, në pasurinë me nr. pasurie 141/5, ZK 1678, në pronësi të zhvilluesit, me kufij (V; pasuria nr.368/55, J; pasuria nr. 368/70, L; pasuria nr. 368/24, P; pasuria nr.337), sipërfaqe 2850 m² kushtet zhvillimore janë:

Kategoria/të e përdorimit të tokës: Banim

Përdorimi i lejuar: **Shërbime (S), Institucione (IS), Industri dhe ekonomi (IE), Aktivitete sociale dhe rekreative (AR), Arsim (AS), Shëndetësi (SH), Infrastruktura teknike (IN)**

Sipërfaqja minimale sipas ppv e tokës : 350 m²

Koeficienti maksimal i shfrytëzimit të tokës (%): 60 %

Intensiteti maksimal i ndërtimit të pasurisë: 1

Lartësia maksimale në kate: 3 kate + çati

Në aplikimin me numër AN170520220037, **protokolluar me nr. 1294, datë 22.12.2020** "Leje zhvillimi", dorëzuar elektronikisht nga aplikanti dhe projektuesi shoqëria "A.M" shpk. Nga Bashkia Poliçan është kërkuar në institucione për mendim me datë 29.12.2020, në:

- Drejtoria Vendore e ASHK Berat.

Ka shprehur dakordësinë Drejtoria Vendore e ASHK Berat me datë 03.11.2022 dhe OSSH me datë 27.10.2022

Aplikimi për lloj leje "Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m²" , me nr. regjistri/protokoll 2704 prot., për objektin "Godinë banimi 1 kat", Vodicë, Bashkia Poliçan.

Dokumente të aplikimit për leje.

Për aplikimin me numër AN061120220015, **protokolluar me nr. 2704, datë 06.11.2022** "Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m²", dorëzuar elektronikisht nga aplikanti D.T dhe projektuesi shoqëria "A.M" shpk me NUIS L.....Q për objektin "Godinë banimi 1 kat", Vodicë, Bashkia Poliçan **me zhvillues A.Zh.**

Për sa i përket procedurës së kryer për zbardhjen e lejes ndërtimit me dokumentacionit përkatës:

Lista e dokumenteve të ngarkuara elektronikisht:

- certifikatë pronësie.pdf;
- projekti arkitektonik.pdf ; relacion arkitektonik.pdf
- projekti konstruktiv.pdf ; relacion konstruktiv.pdf;
- projekti elektrik.pdf ; relacion elektrik.pdf
- projekti i mbrojtjes nga zjarri;
- preventivi.pdf
- planvendosja.pdf; - deklaratë përgjegjësie - topografi.pdf
- licencat firme dhe individuale.pdf ;
- siguracioni geopproject.pdf ; - planvendosja-model.pdf;
- grafiku i punimeve.pdf
- leje zhvillimi_ ppv.... (1).pdf
- projekti mkz.pdf; - relacion mkz.pdf; - deklarata eksperti zjarrfikës.pdf;
- deklarata arkitekti.pdf; deklarata eksperti zjarrfikës.pdf; deklarata inxh. elektrik.pdf;
- licence projektimi “A.M” 4.pdf; licenca e mk zjarrit_.pdf
- licensa_inxh_elektrik_.pdf; licensa_inxh_konstruktor_.pdf, Licencë_arkitekt_.pdf;
- qkl_mkz.pdf; polica e sigurimit A.M shpk, datë 22.05.2022 deri 22.05.2023.pdf

Mbi Lejen e zhvillimit

- Në aplikimin me numër AN231020220001, **protokolluar me nr. 2573, datë 23.10.2022** "Leje zhvillimi", dorëzuar elektronikisht nga aplikanti dhe projektuesi shoqëria “A.M” shpk me NUIS L.....Q është miratuar leje zhvillimi me nr. 2724, datë 08.11.2022. Leja e zhvillimit për objektin: për objektin “Godinë banimi”, me adresë Vodicë, Bashkia Poliçan dhe zhvillues **I. Zh.**, në pasurinë me nr. pasurie 368/69, ZK 3808, në pronësi të zhvilluesit, me kufij (V; pasuria nr.368/55, J; pasuria nr. 368/70, L; pasuria nr. 368/24, P; pasuria nr.337), sipërfaqe 1465 m² kushtet zhvillimore janë:

Kategoria/të e përdorimit të tokës: Banim

Përdorimi i lejuar: **Shërbime (S), Institucione (IS), Industri dhe ekonomi (IE), Aktivitete sociale dhe rekreative (AR), Arsim (AS), Shëndetësi (SH), Infrastruktura teknike (IN)**

Sipërfaqja minimale sipas ppv e tokës : 350 m²

Koeficienti maksimal i shfrytëzimit të tokës (%): 60 %

Intensiteti maksimal i ndërtimit të pasurisë: 1

Lartësia maksimale në kate: 3 kate + çati

Në aplikimin me numër AN221220200012, **protokolluar me nr. 2572, datë 22.12.2020** "Leje zhvillimi", dorëzuar elektronikisht nga aplikanti dhe projektuesi shoqëria “A.M” shpk.

Pika nr.6. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit.

Në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 3, kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga:

- a) Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i Njësisë Vendore përkatëse;
- b) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron

përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.

Struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë Poliçan (IMTV) për vitin 2022 është miratuar me VKB nr. 46, datë 24.12.2021, i ndryshuar “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkisë Poliçan, Njësive administrative dhe institucioneve në varësi për vitin 2022”, e cila përbëhet nga 1(një) punonjës me detyrë inspektor, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9780, datë 06.07. 2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4 “Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë vendore përkatëse”, neni 13 “Brenda 10 ditëve nga mbajtja e procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori”, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”, pika 1/b/ii ...kryen kontrole në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga kryeinspektori, pika 1/c/i Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore realizon kontrole nëpërmjet ... një grupi inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë; pika 4...Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori. Bashkia Poliçan nuk ka respektuar përcaktimet e ligjit nr. 9780, datë 06.07. 2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 11 në rekrutimin e stafit të IMTV-së. Gjithashtu, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Poliçan nëpërmjet strukturës së Burimeve Njerëzore nuk janë marrë masa për të bërë shpalljen e vendit vakant të Kryeinspektorit me qëllim fillimin e procedurave të rekrutimit. Si përfundim, nga mos funksionimi i plotë i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga Bashkia Poliçan nuk mund të vendosen gjoba apo të merren masa të tjera për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit. Gjatë vitit 2022, inspektori i IMTV Poliçan ka kryer inspektime në terren ku kanë rezultuar 2(dy) ndërtime pa leje për të cilat nuk është marrë asnjë vendim, për arsye të mungesës së Kryeinspektorit në strukturën e Bashkisë Poliçan, veprime të cilat sjellin të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë.

Titulli i gjetjes : Mos funksionimi i IMTV, si rezultat i mungesës së kryeinspektorit duke sjellë mosvendosjen e masës së gjobës sipas llojit të kundërvajtjes së mbajtur në proces verbalit e konstatimit.

Situata 1: Nga mos funksionimi i plotë i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga Bashkia Poliçan, nuk mund të vendosen gjoba apo të merren masa të tjera për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit.

Situata 2: Konstatohet dy kundërvajtje për ndërtime pa leje, nuk është marrë asnjë masë tjetër në vazhdim. Në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin

dhe zhvillimin e territorit”, shkeljet e kryera në zhvillimin e territorit pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale, ato përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjoba sipas nenit nr. 52 të ligjit të sipër cituar. Grupi i auditimit shqyrtoi proces verbalin e konstatimit të kundërvajtjes dhe masën e gjobave që është aplikuar sipas llojit të shkeljes. Nga ana e IMTV-së nuk janë marrë masa në vijim pas konstatimit të kundërvajtjes.

Kriteri: Ligjit nr. 9780, datë 06.07. 2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4 “Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë vendore përkatëse”, neni 13 “Brenda 10 ditëve nga mbajtja e procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori”, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”, pika 1/b/ii ...kryen kontrole në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga kryeinspektori, pika 1/c/i Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore realizon kontrole nëpërmjet një grupi inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë; pika 4...Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e 101 masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori. Bashkia Poliçan nuk ka respektuar përcaktimet e ligjit nr. 9780, datë 06.07. 2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 11 në rekrutimin e stafit të IMTV-së, Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 52. 9 Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative” neni 30-Arkëtimi i shumave të detyrimeve pika 4,“ Kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga: b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative. 10 Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative”, neni 9 -Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative “Vendimi për kundërvajtjen administrative, sipas këtij ligji, bëhet i ekzekutueshëm nga organi administrativ që e ka nxjerrë atë. Kur organi administrativ që ka nxjerrë vendimin e kundërvajtjes administrative, i cili është bërë i ekzekutueshëm, nuk ka në përbërjen e tij struktura të ekzekutimit me forcë të detyrimeve, për ekzekutimin e vendimit të kundërvajtjes administrative ngarkohet shërbimi përbarimor, sipas këtij ligji”, neni 22, pika 1, “Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga organet administrative të përmendura në nenin 20 të këtij ligji, si dhe vendimet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji, përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përbarimor ose/dhe organet e përcaktuara në kreun V të këtij ligji”, neni 3, pika 5 “Kur gjoba dhe detyrimet e tjera të parashikuara në vendimin për kundërvajtjen administrative nuk paguhen ose nuk nxirren dot nga paga, ato nxirren duke vënë sekuestro mbi pasurinë e të dënuarit për kundërvajtje administrative, qoftë edhe sikur ajo të ndodhet në dorën e personave të tjerë”.

Ndikimi: Mos marrja e vendimeve në lidhje me shkeljet e konstatuara gjatë inspektimeve të kryera duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Poliçan.

Shkaku: Mos zbatim korrekt i ligjit nga inspektorët e IMTV-së.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim 1: Kryetari i Bashkisë Poliçan nëpërmjet strukturës së Burimeve Njerëzore të marrë masa për të bërë shpalljen e vendit vakant të Kryeinspektorit me qëllim fillimin e procedurave të rekrutimit.

Rekomandim 2: IMTV të vlerësojë me saktësi kundërvajtjet e konstatuara gjatë kontrolleve në terren dhe të sigurohet që në vazhdimësi të aplikojë masën e duhur të gjobës në përputhje me llojin e kundërvajtjes së identifikuar.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm sipas komponentëve u konstatuan parregullsitë si më poshtë:

a. Në lidhje me komponentin “Mjedisi i kontrollit”:

- Nuk janë hartuar programe trajnimi për ruajtjen dhe ngritjen e nivelit profesional të punonjësve, si dhe njohuritë e tyre në lidhje me kuadrin rregullator ligjor mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin rezultojnë të jenë jo në nivelin e duhur.

-Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar procedura e rekrutimit të tyre.

-Njësia publike nuk ka të përcaktuar në dokumentin e strategjisë një plan konkret për monitorimin dhe arritjen e objektivave.

-Nuk ka përshkrime detyrash individuale e cila do të evidentonte ngarkesën konkrete me punë si dhe kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit.

b. Në lidhje me komponentin “Menaxhimi i riskut”:

- Bashkia Poliçan ka hartuar regjistër risku, por ky regjistër nuk është përditësuar për të evidentuar risqet aktuale që rrezikojnë realizimin e objektivave të njësisë vendore, si dhe nuk janë përcaktuar persona, apo struktura përgjegjëse për monitorimin e rrisqeve me qëllim minimizimin e tyre.

d. Në lidhje me komponentin “Monitorimi”:

-Nuk ka një plan të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III (*Trajtuar më hollësisht në pikën 1, faqe 8-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan të marrë masa për:

- Evidentimin e nevojave të stafit për trajnim, si dhe hartimin e planit vjetor për trajnimin e punonjësve, me qëllim ngritjen e nivelit profesional të tyre.

- Përshkrimin e detyrave për secilin pozicion pune, sipas strukturës së miratuar nga titullari i institucionit në rregulloren e brendshme të veprimitarisë së njësisë vendore.

- Hartimin e regjistrimit të ri të riskut, në të cilin të evidentohen të gjitha risqet aktuale që rrezikojnë realizimin e objektivave, si dhe strukturat përkatëse për monitorimin e riskut.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm u konstatua se kjo strukturë nuk është e plotësuar me numrin e plotë, pasi ka një punonjës, nga tre që kërkon kuadri ligjor në fuqi.

Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si dhe fusha të tjera me risk të lartë në veprimtarinë e institucionit, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njesisë publike, nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

Nuk është hartuar karta e auditimit të brendshëm dhe plani strategjik. Nuk është hartuar dhe dërguar në NJQHAB të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raporti periodik vjetor i shoqëruar me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmblyës për veprimtarinë e NJAB. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM Nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 3, “Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njesisë. Në strukturën e njesisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik”. (*Trajtuar më hollësisht në pikën 1, faqe 8-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e strukturës së auditit të brendshëm me tre auditues.

2.2 Rekomandimi: NJAB të planifikojë dhe realizojë auditime në fushat kryesore dhe me risk të veprimtarisë së institucionit, si ngritja dhe funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, menaxhimi, inventarizimi dhe regjistrimi i aseteve, procedurat e prokurimit publik etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Për hartimin e PBA-së për periudhën 2022-2024, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Poliçan nuk janë ndjekur të gjithë hapat e duhura ligjore, si më poshtë vijon:

- Kryetari i Bashkisë nuk ka përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor.

- Nuk janë përgatitur kërkesat buxhetore referuar nevojave dhe objektivave të Bashkisë Poliçan.

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk disponon asnjë dokumentacion lidhur me dëgjuesat publike për konsultimin e buxheteve afatmesme me komunitetin dhe grupet e interesit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33. (*Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Poliçan, të marrë masa për të dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, dhe të publikohet brenda afatit ligjor PBA-ja.

Të përgatiten kërkesat buxhetore referuar nevojave dhe objektivave të Bashkisë Poliçan.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan në asnjë rast nuk i ka paraqitur në këshill raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë Poliçan nuk ka miratuar rregullat specifike dhe proceduriale, që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar sipas shtojcës 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe Shtojcës 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”. Raportet e monitorimit nuk janë të plota, pasi nuk janë plotësuar të gjitha anekset sipas kërkesave të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, Aneksi nr. 3 “Raporti i realizimit të produkteve të programit”, Aneksi nr. 4 “Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan të paraqesë në këshillin bashkiak për njohje dhe miratim, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Bashkia Poliçan nuk ka marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi brenda vitit buxhetor konstatohet fenomeni i pagesës së një pjesë të këtij detyrimi, por njëkohësisht edhe krijimi i detyrimeve të reja të prapambetura. Konkretisht në datën 01.01.2022 vlera e detyrimeve të prapambetura progresive, është 180,841,998 lekë. Gjatë vitit buxhetor 2022 nga detyrimi i mësipërm është likuiduar vlera 101,266,279 lekë, por njëkohësisht gjatë këtij viti janë krijuar edhe detyrime të reja të prapambetura në vlerën 14,642,255 lekë. Kjo ka bërë që vlera e detyrimeve të prapambetura në 31.12.2022 të jetë 94,217,974 lekë, ku peshën kryesore e zënë detyrimet për investime në vlerën 75,452,358 lekë, detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 7,082,391 lekë, detyrimet për shpronësime në vlerën 6,775,052 lekë. Nga vlera e mësipërme e stokut të detyrimeve të prapambetura prej 94,217,974 lekë, detyrimi 40,578,821 lekë ka si burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë, ndërsa detyrimi 53,639,153 lekë ka si burim financimi grantin e Qeverisë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 12, pika (gj), të ligjit 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,

UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91, Udhëzimin e MFE nr.09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe nëpunësi zbatues të marrin masa që në hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor, prioritet të kenë detyrimet e prapambetura nga vitet e mëparshme, duke mbuluar më parë me fonde këto detyrime.

Të eliminohet fenomeni i krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura gjatë vitit buxhetor.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan 105 fatura në total me vlerë 124,557 mijë lekë të dorëzuara në thesar jashtë afatit 60 ditor, veprim në kundërshtim me UMFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të marrin masa për likuidimin në kohë të detyrimeve kontraktuale me të tretë, me qëllim eliminimin e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Bashkia Poliçan, nuk ka hartuar regjistër manual për taksapaguesit e kategorisë privat dhe familjar, për të rritur sigurinë e informacionit që disponojnë, nisur nga fakti se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon program kompjuterik të licencuar dhe të mbrojtur, veprim që bie në kundërshtim me pikën 7, neni 4 të Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

- Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashki, nuk janë administruar në dosjet e bizneseve që janë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, deklarata tatimore vjetore mbi xhiron e parashikuar vjetore, veprim që bie në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”

- Nga Zyra e Taksave Vendore nuk është marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, mbi xhiron e subjekteve, ku mbi bazën e këtyre të dhënave aplikohet dhe taksat vendore sipas llojeve të biznesit (fizik/juridik), pasi referuar VKB tarifatat kanë nivele të ndryshme, veprim në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, kjo për të mundësuar evidentimin e subjekteve që kalojnë nga subjekte me status fizik në subjekte me status juridik, për të cilat taksat e tarifatat vendore kanë vlera të ndryshme.

Rezulton se për vitin 2022, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore nga 59,550 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në shumën 43,214 mijë lekë ose 73 % e planit, me një diferencë në vlerën 16,336 mijë lekë të ardhura të pa realizuara, nga të cilat të ardhurat nga taksat janë realizuar në vlerën 19,039 mijë lekë, ose 50% të planifikimit, të ardhurat nga gjobat janë realizuar në vlerën 25 mijë lekë, ose vetëm 1% të planifikimit, ndërsa të ardhurat nga tarifatat dhe të ardhurat e tjera janë tejkaluar, përkatësisht 114% dhe 151% nga planifikimi.

Kjo situatë tregon punën e pamjaftueshme të kësaj administrate në planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave, e si pasojë mosarkëtimi bën që një pjesë e investimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2022 të prokurohen pa fonde në dispozicion, duke rritur në fund të periudhave ushtrimore gjendjen e faturave të palikujduara dhe borxhin.

- Të ardhura nga taksat kombëtare për vitin 2022 nuk është planifikuar. Konkretisht Bashkia Poliçan nuk ka planifikuar arkëtim për taksat kombëtare si vijon: taksa e mjeteve të përdorura të transportit, taksa e licensimit të subjekteve që tregtojnë naftë dhe gas. Kjo tregon për mos njohje të burimeve dhe resurseve që ka Bashkia Poliçan, si dhe mos njohja e kuadrit ligjor që rregullon përfitimin e njësive vendore nga këto taksa. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Poliçan, të marrin masa për:

- Hartimin e regjistrit manual për taksapaguesit privat dhe familjar, me të gjithë elementët e tij të nevojshëm.

- Planifikim të studiuar të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, me qëllim që të mos ketë diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të tyre, duke u mbështetur në numrin e taksapaguesve, në realizimin faktik të viteve të fundit, si dhe në bashkëpunimin me Drejtorinë Rajonale Tatimore.

- Planifikimin e të ardhurave nga taksat kombëtare, si vijon: taksa e mjeteve të përdorura të transportit, taksa e licensimit të subjekteve që tregtojnë naftë dhe gaz, duke bashkëpunuar me

institucionet përkatëse të cilat mbledhin këtë taksë dhe ndajnë një pjesë të saj me pushtetin vendor (agjentë tatimorë).

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i HEC-eve që operojnë në Bashkinë Poliçan dhe kanë kontratë aktive me A.K.B.N rezulton se H.H.S.E, i cili operon në NJA Vertop, të Bashkisë Poliçan dhe ka kontratë koncesionare aktive me A.K.B.N, nuk ka lidhur kontratë qiraje për përdorimin e fondit pyjor dhe kulloror me bashkinë, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave, i ndryshuar. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masa për lidhjen e kontratës së qirasë për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kulloror me operatorin ekonomik H.S.E dhe të aplikojë tarifën duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se llogaria 202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në vlerën 2,704,895 lekë, në të cilën janë të përfshira dhe të dhënat e bilancit viti 2015 nga ish- Komuna Vërtop nga bashkimi i bilanceve nga reforma territoriale.

Për këto aktive nuk ka inventar, si dhe nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv, nuk ka analizë të kësaj llogarie, pasi mungojnë përshkrimet e studimeve dhe projekteve dhe viti i krijimit të tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26, pika 30. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa për verifikimin e çdo zëri të llogarisë nr.202 “Studime dhe Kërkime” dhe pas evidentimit të projekteve të finalizuara në investime dhe statusit të çdo zëri, të kryhen regjistrimet kontabël në lidhje me kapitalizimet në aktivet përkatëse apo çregjistrimet sipas rastit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023

10. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në mbyllje të vitit 2022 ka vlerën bruto 11,212,459,458 lekë. Nga shqyrtimi i analizës së kësaj llogarie rezulton se është përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 2,459,884 lekë e aktivit “Varrezat e reja”, i cili sipas klasifikimit kontabël i përket llogarisë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, dhe me Nomenklaturën e Llogarive të planit kontabël publik. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Poliçan të kryejë veprimet e sistemit në kontabilitet në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023 për kalimin e vlerës prej 2,459,884 lekë e aktivit “Varrezat e reja”, në debi të llogarisë përkatëse 212 "Ndërtime e konstruksione", duke kredituar llog. 213 "Rrugë, rrjete vepra ujore".

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023

11. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti” në mbyllje të vitit 2022-ka vlerën bruto 64,210,568 lekë. Sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr.384 prot., datë

04.12.2021 është kryer inventarizimi i aktiveve në pronësi të Bashkisë, ku nga procesverbali i datës 28.12.2021 rezulton se vlera 288,000 lekë i përket një mjeti zjarrfikës, i cili është i dëmtuar, pra nuk është në gjendje pune dhe rrjedhimisht është kryer kontabilizimi i gabuar në llogarinë 215 "Mjete Transporti". Në fakt duhet kryer regjistrimi dhe kontabilizimi në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara", për mjetin e zjarrfikëses të dëmtuar, jo në gjendje pune. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 8, datë 9.03.2018, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2/1, germa e. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Poliçan të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023, për kalimin e vlerës prej 288,000 lekë i përket 1 mjeti zjarrfikës jashtë funksioni në debi të llogarisë përkatëse 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara", duke kredituar llog.215 "Mjete Transporti", si dhe të bëhen rregullimet e nevojshme në llogaritjen e amortizimit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023

12. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 28,054,019 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve në masën 5% të vlerës së kontratës për 37 objekte. Nga këto objekte për 17 prej tyre vlera e ngurtësuar e garancisë së punimeve është 4,728,003 lekë dhe afati i garancisë sipas kontratës, edhe pse ka përfunduar në vitin 2020, nga Bashkia Poliçan nuk janë marrë masa për xhirimin e fondeve të kontraktori, apo për verifikimin e investimit nëse ka patur problematika gjatë periudhës së garancisë, me qëllim rakordimin dhe mbajtjen e vlerës që lidhet me problematikën e konstatuar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin i MF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Poliçan të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", duke rakorduar çdo muaj vlerat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se Bashkia Poliçan nuk ka hartuar regjistër kontabël të aseteve, duke mos pasur informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, etj.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26-30 dhe pika 74. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Poliçan të marrë masa për hartimin e regjistrit të aktiveve me të gjithë elementët e nevojshëm të tij, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit për çdo aktiv të institucionit.

Deri më 30.04.2024

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se, lidhur me listat e pronave të paluajtshme në njësitë administrative nuk janë marrë masa për verifikimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentet e pronësisë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se me ndarjen e re territoriale Bashkisë Poliçan i janë shtuar 2 njësi Administrative.

-Njësia/A Vërtop

-Njësia/A Tërpan

Nga auditimi rezultoi se nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve, inventarizimin dhe verifikimin për ekzistencën në teren të pronës për sipas inventarit paraprak, apo atij përfundimtar (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.) dhe, për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 27,28, funksionet e bashkisë në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor. Kjo strukturë duhet të realizonte **marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV**, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira. Bashkia Poliçan ka 3459 prona në inventar, nga të cilat vetëm 28 të certifikuar dhe 343 prona të certifikuar ose rreth 99% të totalit. Nga informacioni i marrë gjatë auditimit rezulton se ka nisur procedura për regjistrimin e **32** pronave pranë DVASHK Berat, të cilat rezultojnë në proces regjistrimi. *Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga drejtoria e financës*, në lidhje me trojet, ndërtesat dhe sheshet publike, nuk kemi raste të zaptimit të trojeve në administrim të Bashkisë Poliçan.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga strukturat e bashkisë Poliçan, rezulton se në strukturën aktuale organizative të bashkisë Poliçan nuk ka drejtori të Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, detyrat e të cilës i kryen drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave. Kjo strukturë duhet të realizonte **marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV**, vënien në evidence të ndërtesave me sipërfaqe dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive të përcaktuara në listat e inventarëve, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira.

Përsa i përket këtyre pronave nga bashkia Poliçan pretendohet se problematikat e mos regjistrimit janë të natyrave të ndryshme. Pjesa më e madhe e këtyre praktikave janë të pa trajtuara nga ana e DVASHK Berat, mungesë të ardhurash për të bërë aplikim në kadastër. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse Bashkia Poliçan, të marrë masat për:

- Krijimin dhe miratimin e strukturës përgjegjëse për menaxhimin e pronave të Bashkisë Poliçan.
- Hartimin e regjistrit kontabël të pronave që administron Bashkisë Poliçan dhe që janë transferuar me VKM të posaçme në këtë njësi vendore.
- Të evidentohet statusi faktik i pronave në terren, si ekzistenca fizike e pronës, përputhja në fakt e elementëve të pronës në terren, si sipërfaqja e pronës etj., me elementët që pasqyrojnë gjendja kontabël.
- Për të gjitha pronat të cilat i përkasin inventarit përfundimtar të Bashkisë Poliçan, të merren masa për regjistrimin e tyre në ASHK.

Spektori i Financës të përllogarisë në buxhet kostot e nevojshme për kryerjen e regjistrimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Bashkia Poliçan për vitin 2022 ka zhvilluar gjithsej 3 procedura prokurimi me vlerë të lartë, me fond limit prej 51,270,483 dhe vlerë kontrate të lidhur prej 51,027,637 lekë, konkretisht:

1.Tenderi me objekt: “Riparimi i rrugëve të fshatrave Peshtan, Drenovë, Lybesh, Tomor i Madh, Tomor i Vogël” VITI 2022, me fond limit 2,473,000 lekë, oferta fituese: B shpk 2,457,696 lekë.

2.Tenderi me objekt: Rikonstruksion i shkollës së mesme “Muhamet Kondi” në qytetin Poliçan, me fond limit 45,125,675 lekë, oferta fituese: BOE "Z "Shpk dhe "B. N " shpk 44,936,609 lekë.

3.Tenderi me objekt: “Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Poliçan” Viti 2022, me fond limit 3,633,332 lekë, oferta fituese: K SHPK 3,633,332 lekë, marzhë fitimi 18% pa tvsh.

Nga auditimi i tre procedurave, rezulton se:

- Në dy procedura kriteret e aplikuara nuk janë në përputhje me llojin e procedurave të zhvilluara dhe jo të mirë argumentuara, veprime në kundërshtim me nenin 39 dhe 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

- Në dy procedura operatorët ekonomik janë kualifikuar dhe shpallur fitues në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vendosura në dokumentet e tenderit, veprime në kundërshtim me nenin 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” pika 3, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2023, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 4, faqe 83-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan, të marrë masa për eliminimin e vendosjes së kriterëve të veçanta në dokumentet e tenderit, të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, si dhe shmangien e kualifikimit dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik, në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vendosura në dokumentet e tenderit.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet mos funksionimi i plotë i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga Bashkia Poliçan, ku si rezultat i mungesës së emërimit të Kryeinspektorit nuk mund të vendosen gjopa apo të merren masa të tjera për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit. Gjithashtu konstatohen dy kundërvajtje për ndërtime pa leje, ku nga ana e Bashkisë nuk është marrë asnjë masë tjetër në vazhdim.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim të përcaktimeve të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, shkeljet e kryera në zhvillimin e territorit pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale, ato përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjopa sipas nenit nr. 52 të Ligjit të sipër cituar. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 4, faqe 83-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan nëpërmjet strukturës së Burimeve Njerëzore të marrë masa për të bërë shpalljen e vendit vakant të Kryeinspektorit me qëllim fillimin e procedurave të rekrutimit.

16.2 Rekomandimi: IMTV të vlerësojë me saktësi kundërvajtjet e konstatuara gjatë kontrolleve në terren dhe të sigurohet që në vazhdimësi të aplikojë masën e duhur të gjobës në përputhje me llojin e kundërvajtjes së identifikuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore dhe Inproduktive, në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Poliçan, për të cilat nga Bashkia Poliçan, në një rast nuk është vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore me sipërfaqe totale prej 0.033 km² (3.3 hektarë ose 33.000 m²), ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë) me afat 6-10 vjet, ku tarifa vjetore është 440,000 lekë/ha/vit në territor tokë Inproduktive.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia Poliçan rezulton se subjekti N.P.R SHPK, ka certifikatë për vërtetim pronësie në datën 12.02.2002, në zonën kadastrale nr.3930, numri i pasurisë 650/4, volumi 9. Faqe 58, adresa e pasurisë Zhitom i madh, lloji i pasurisë kullotë vetëm për sipërfaqen 10.000 m² (1 hektar) dhe jo për sipërfaqen totale për të cilën ka marrë lejen e shfrytëzimit. Veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave, Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor” i ndryshuar, neni 17, pika 1, Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1.2, VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Poliçan, në vlerën (440.000 lekë x 2.3 hektarë) **1,012,000 lekë.** *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masa për arkëtimin e shumës prej **1,012,000** lekë si rezultat i mos aplikimit të tarifave për shfrytëzim të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore për operatorin ekonomik N.R.SH, që është pajisur me leje minerare nga M.I.E.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se gjendja e debitorëve në vlerë progresive në fund të vitit 2022 për 79 subjektet fizik/juridik është në vlerën 26,835,864 lekë, për taksën e tokës bujqësore në vlerën 45,357,282 lekë dhe për taksat dhe tarifat familjare 2,504,614 lekë, në total borxhi është në vlerën **74,697,760 lekë**, vlerë e cila përbën **të ardhura të planifikuara por të pa arkëtuara** në buxhetin e Bashkisë Poliçan (ku për vitin 2022 të ardhura të planifikuara por të pa arkëtuara janë në shumën 4,289,978 lekë). Veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKB-në nr. 45, datë 24.12.2021 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre për vitin 2022”, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan, Drejtorja Juridike dhe Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masat e duhura ligjore, administrative dhe gjyqësore, për arkëtimin e vlerës **74,697,760 lekë**, e cila është borxh ndaj Bashkisë Poliçan, nga debitorët taksapagues privat dhe familjar.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me likuidimin e vendimeve gjyqësore nga Bashkia Poliçan konstatohet se në fund të vitit 2021 vlera detyrimeve është 8,672,439 lekë për 12 vendime gjyqësore, gjatë vitit 2022 është shtuar detyrime në vlerën 174,699 lekë dhe është likuiduar vlera prej 1,764,747 lekë. Në fund të vitit 2022 ka mbetur pa u likuiduar vlera prej 7,082,391 lekë. Vlera prej 1,764,747 lekë e likuiduar gjatë vitit 2022 për zbatimin e vendimeve gjyqësore konsiderohet si efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Poliçan. Nga vlera e mësipërme, vlera prej 1,616,448 lekë është paguar për likuidimin e vendimeve me objekt dëmshpërblim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës me punonjës, ndërsa vlera prej 148,299 lekë është paguar për likuidimin e vendimeve gjyqësore me objekt të natyrave të ndryshme.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i kohës së likuidimit të vendimeve gjyqësore vihet re se Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në likuidimin e detyrimeve nuk respekton radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese, si dhe nuk ka të miratuar nga Kryetari i Bashkisë një grafik, që duhet të ndjekë në likuidimin e detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, pika 5 (*Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 29-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e tyre, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë administrative për humbjet e këtyre proceseve. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, apo çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 “*Llojet e masave disiplinore*” të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i **rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Poliçan** të vlerësojë shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, si dhe të fillojnë procedurat për dhënie e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga shërbimi civil/ Largim nga puna**”, për **10 (dhjetë)** punonjësit, si më poshtë:

a. “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga shërbimi civil/ Largim nga puna**”, sipas shkeljeve të konstatuara për punonjësit si më poshtë:

1. **Znj. L.Xh** me detyrë, Sekretare e Përgjithshme e bashkisë Poliçan anëtar NJPP.
2. **Znj. S.S** me detyrë, N/Kryetare e bashkisë Poliçan, anëtare e NJPP.

3. **Znj. O.N**me detyrë, Inxhinierë Mjedisi, anëtar NJPP.
4. **Znj. K.R** me detyrë, Specialiste Sektori i Shërbimit Social, anëtar KVO.
5. **Z. O.D** me detyrë, ish-N/Kryetar i bashkisë Poliçan, specialist, anëtar KVO.
6. **Z. A.S** me detyrë, Specialist i Transportit dhe Emergjencave Civile, anëtar NJPP.
7. **Znj. Xh.M** me detyrë, Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore, anëtar KVO.
8. **Znj. D.Z** me detyrë, Drejtoreshë Juridike, anëtar KVO.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Parregullësi në procedurat e prokurimit publik me vlera të larta sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe në përcaktimin e kriterëve të veçanta të vendosura në dokumentet e tenderit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2023, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të prokurimit publik". *(Më hollësisht trajtuar në faqet 80-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9. **Z. F.A** me detyrë, Drejtor i Planifikimit të Territorit, Bujqësisë dhe Pyjeve, Kryetar i NJPP dhe anëtar i KVO.

10. **Znj. A.C** me detyrë, Drejtoreshë e Tatim-Taksave, anëtar NJPP dhe KVO.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Parregullësi në procedurat e prokurimit publik me vlera të larta sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe në përcaktimin e kriterëve të veçanta të vendosura në dokumentet e tenderit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2023, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të prokurimit publik".

-VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar, pika nr.2, e lidhjes nr.2, pika 6/1 dhe pika 9/4

-VKB-në nr. 45, datë 24.12.2021 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre për vitin 2022", Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar dhe me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 29-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Kryetari i Bashkisë Poliçan, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Publike, pasi të zbatojnë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Shënim: Gjatë auditimit të ushtruar në Bashkinë Poliçan, nga ana e grupit të auditimit të KLSH nuk janë kontrolluar procedurat e zbatimit të kontratave, të cilat do të jenë objekt i auditimit të radhës.

V. ANEKSE

Aneksi nr.1 Faturat e dorëzuara në thesar jashtë afatit ligjor

në lekë

Nr.	Furnitori	Pershkrimi	Numri I Fatures	Data e Fatures	Data e Urdher Shpenzimit	Shuma	Diferenca (dite)
1	A.Z	Shpenzime gjyqesore	12421400012022	24-12-04	09-03-22	9,048	6284
2	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	61021400012022	25-06-08	24-10-22	60,000	5234
3	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	73421400012022	12-04-11	20-12-22	40,000	4270
4	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	66621400012022	12-04-11	22-11-22	40,000	4242
5	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	60621400012022	12-04-11	24-10-22	40,000	4213
6	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	52221400012022	12-04-11	16-09-22	40,000	4175
7	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	46121400012022	12-04-11	09-08-22	40,000	4137
8	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	41321400012022	12-04-11	21-07-22	40,000	4118
9	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	73321400012022	06-12-11	20-12-22	50,000	4032
10	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	19521400012022	12-04-11	19-04-22	40,000	4025
11	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	66521400012022	06-12-11	22-11-22	50,000	4004
12	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	12121400012022	12-04-11	09-03-22	40,000	3984
13	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	60721400012022	06-12-11	24-10-22	50,000	3975
14	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	7821400012022	12-04-11	24-02-22	80,000	3971
15	FILIP I	Shpenz. per rritjen e AQT - rrugeve	13121400012022	31-05-11	18-03-22	1,297,721	3944
16	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	52121400012022	06-12-11	16-09-22	50,000	3937
17	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	73621400012022	02-04-12	20-12-22	20,000	3914
18	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	46221400012022	06-12-11	09-08-22	50,000	3899
19	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	66821400012022	02-04-12	22-11-22	20,000	3886
20	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	41421400012022	06-12-11	21-07-22	50,000	3880
21	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	19421400012022	06-12-11	19-04-22	50,000	3787
22	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	12221400012022	06-12-11	09-03-22	50,000	3746
23	Z.P.B	Shpenzime gjyqesore	7721400012022	06-12-11	24-02-22	100,000	3733
24	A.GJ	Shpenzime gjyqesore	66921400012022	06-04-16	22-11-22	26,400	2421
25	A.GJ	Shpenzime gjyqesore	60921400012022	06-04-16	24-10-22	61,000	2392
26	B.K.T	Shpenzime komp per shpronësim ne te kaluaren	61321400012022	18-10-17	27-10-22	296,567	1835
27	FSHU	Elektricitet	73221400012022	12-07-18	20-12-22	48,215	1622
28	FSHU	Elektricitet	66421400012022	12-07-18	22-11-22	48,215	1594
29	T	Shpenz. per rritjen e AQT-kon te rrugeve	74621400012022	11-10-18	21-12-22	4,000,000	1532
30	F.SH.U	Elektricitet	53521400012022	12-07-18	20-09-22	48,215	1531
31	T	Shpenz. per rritjen e AQT-kon te rrugeve	65821400012022	11-10-18	11-11-22	2,000,000	1492
32	F.SH.U	Elektricitet	42221400012022	12-07-18	27-07-22	48,215	1476
33	N.S	Shpenz. per rritjen e AQT, nder shkollore	74721400012022	03-01-19	21-12-22	2,449,322	1448
34	FSHU	Elektricitet	26321400012022	12-07-18	31-05-22	48,215	1419
35	FSHU	Elektricitet	21021400012022	12-07-18	22-04-22	48,215	1380
36	FSHU	Elektricitet	14221400012022	12-07-18	23-03-22	48,215	1350
37	T	Shpenz. per rritjen e AQT - k. rrugeve	33421400012022	11-10-18	21-06-22	2,850,000	1349
38	U.B	Shpenzime kompensimi per shpronësim ne te kaluaren	58721400012022	20-02-19	12-10-22	400,000	1330
39	F.SH.U	Elektricitet	7521400012022	12-07-18	24-02-22	48,215	1323
40	F.SH.U	Elektricitet	3621400012022	12-07-18	25-01-22	48,215	1293
41	N.S	Shpenz. per rritjen e AQT - ndertesa shkollore	31121400012022	03-01-19	10-06-22	2,000,000	1254

42	T	Shpenz. per rritjen e AQT - te tjera ndertimore	59721400012022	01-08-19	24-10-22	1,000,000	1180
43	Z.P	Shpenzime gjyqesore	73521400012022	01-10-19	20-12-22	20,000	1176
44	Z.P	Shpenzime gjyqesore	66721400012022	01-10-19	22-11-22	20,000	1148
45	Z.P	Shpenzime gjyqesore	60821400012022	01-10-19	24-10-22	20,000	1119
46	Z.P	Shpenzime gjyqesore	52321400012022	01-10-19	16-09-22	20,000	1081
47	T	Shpenz. per rritjen e AQT - te tjera ndertimore	33521400012022	01-08-19	21-06-22	3,000,000	1055
48	Z.P	Shpenzime gjyqesore	46321400012022	01-10-19	09-08-22	20,000	1043
49	Z.P	Shpenzime gjyqesore	41521400012022	01-10-19	21-07-22	20,000	1024
50	Z.P	Shpenzime gjyqesore	19321400012022	01-10-19	19-04-22	20,000	931
51	Z.P	Shpenzime gjyqesore	12321400012022	01-10-19	09-03-22	20,000	890
52	Z.P	Shpenzime gjyqesore	7921400012022	01-10-19	24-02-22	40,000	877
53	G.C	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te veprave ujore	41621400012022	28-12-20	25-07-22	35,340,000	574
54	C.C	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	65921400012022	30-04-21	15-11-22	1,703,964	564
55	A.GJ	Shpenzime gjyqesore	52421400012022	06-04-21	16-09-22	50,000	528
56	A.GJ	Shpenzime gjyqesore	51021400012022	06-04-21	12-09-22	50,000	524
57	C.C	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	27021400012022	17-03-21	31-05-22	1,355,156	440
58	C.C	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	13221400012022	30-06-21	18-03-22	1,483,322	261
59	Sh	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te veprave ujore	41821400012022	15-11-21	25-07-22	10,830,000	252
60	N.S	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te veprave ujore	41721400012022	21-11-21	25-07-22	10,830,000	246
61	SH.M	Sherbime te tjera	12021400012022	22-07-21	09-03-22	32,000	230
62	C.C	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	13321400012022	31-07-21	18-03-22	2,065,152	230
63	C.C	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	14421400012022	31-08-21	23-03-22	1,579,993	204
64	A.SH.A	Sherbime telefonike	54921400012022	31-03-22	23-09-22	34,999	176
65	C.C	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	14521400012022	30-09-21	23-03-22	1,349,871	174
66	B.D	Shpenzime gjyqesore	19721400012022	09-11-21	19-04-22	148,299	161
67	B.C	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te veprave ujore	75921400012022	25-07-22	29-12-22	253,774	157
68	U.B	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te veprave ujore	75821400012022	25-07-22	29-12-22	253,774	157
69	2AF	Shpenz.per miremb.e rugeve, veprave ujore, rrjeteve	65221400012022	06-06-22	09-11-22	92,000	156
70	C.C	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	66021400012022	14-06-22	15-11-22	1,304,304	154
71	C.C	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	66021400012022	14-06-22	15-11-22	2,000	154
72	E.L	Kancelari	7292140012022	20-07-22	21-12-22	887,520	154
73	C.C	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	15021400012022	01-11-21	29-03-22	1,445,651	148
74	C.C	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	15121400012022	02-12-21	29-03-22	2,027,222	117
75	2AF	Shpenz. per rritjen e AQT - te tjera ndertimore	74821400012022	31-08-22	21-12-22	5,640,677	112
76	C.C	Sherbime te pastrimit	47821400012022	03-05-22	23-08-22	1,873,935	112
77	C.C	Sherbime te pastrimit	54021400012022	01-06-22	20-09-22	349,434	111
78	C.C	Sherbime te pastrimit	31721400012022	28-02-22	15-06-22	1,434,718	107
79	C.C	Sherbime te pastrimit	21121400012022	10-01-22	27-04-22	1,561,109	107

80	C.C	Sherbime te pastrimit	50921400012022	31-05-22	07-09-22	1,645,752	99
81	C.C	Sherbime te pastrimit	36421400012022	31-03-22	04-07-22	1,780,954	95
82	B.K.T	Shpenzime per honorare	29421400012022	03-03-22	06-06-22	13,515	95
83	K.T	Shpenzime per te tjera materiale	14821400012022	22-12-21	24-03-22	118,272	92
84	B.A	Furnizime dhe materiale te tjera	14721400012022	22-12-21	24-03-22	99,500	92
85	C.C	Sherbime te pastrimit	54121400012022	30-06-22	20-09-22	1,381,051	82
86	C.C	Sherbime te pastrimit	27121400012022	17-03-22	31-05-22	345,423	75
87	U.P	Uje	46421400012022	31-05-22	10-08-22	204,270	71
88	K.S	ushqim per mencent	9021400012022	31-12-21	02-03-22	160,960	61
89	C.C	Sherbime te pastrimit	55121400012022	01-08-22	26-09-22	1,538,237	56
90	4.C	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjishme	66221400012022	26-09-22	21-11-22	297,600	56
91	E.H	Shpenz. per rritjen e AQT - paisje kompjuteri	48221400012022	05-07-22	29-08-22	556,800	55
92	SH.M	Sherbime te tjera	8921400012022	05-01-22	01-03-22	32,000	55
93	S.U.G	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	20121400012022	25-02-22	20-04-22	104,500	54
94	K	Karburant dhe vaj	8721400012022	10-01-22	01-03-22	438,672	50
95	E.L	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndricim	20221400012022	07-03-22	20-04-22	586,800	44
96	S.A	Pjese kembimi, goma dhe bateri	24621400012022	28-03-22	11-05-22	1,001,280	44
97	C.C	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	70921400012022	01-11-22	13-12-22	724,664	42
98	B.S	Uniforma dhe veshje te tjera speciale	58821400012022	02-09-22	13-10-22	412,800	41
99	LL/	Shpenz. per rritjen e AQT - te tjera ndertimore	19221400012022	10-03-22	19-04-22	194,600	40
100	LL/	Shpenz. per rritjen e AQT - te tjera ndertimore	19121400012022	10-03-22	19-04-22	5,441,484	40
101	A.K	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	20321400012022	11-03-22	20-04-22	137,868	40
102	C.C	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	58521400012022	02-09-22	12-10-22	1,669,487	40
103	BOA S.	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime operative	51321400012022	05-08-22	14-09-22	88,800	40
104	E.L	Kancelari	20421400012022	16-03-22	20-04-22	537,468	35
105	U.P	Uje	40721400012022	17-06-22	20-07-22	42,180	33
Totali						124,557,804	

Burimi: Bashkia Poliçan

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

